




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR' S OFFICE - BAŞKAN OFISI

RAPORTI GJASHTËMUJORË I PUNËS

Janar – Qershor 2021

Gjilan, 2021

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës, z. Lutfi Haziri	1
I. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	5
II. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	9
III. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim.....	15
IV. Drejtoria për	24
V. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	39
VI. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	41
VII. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	67
VIII. Drejtoria e Inspeksionit	
73 IX. Drejtoria për Buxhet dhe Financa	
78	
X. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	80
XI. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	86
XII. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	
88 Raportet e punës së Zyrave dhe Njësive	
91	
I. Zyra e Prokurimit	91

II.	Njësia	e	Kuvendit
		96	
III.	Njësia	e	Personelit
		97	
	Drejtat e Njeriut	98	IV. Njësia për të
V.	Njësia e Auditimit të Brendshëm		
100			
VI.	Zyra Ligjore.....		
102			
VII.	Zyra për Informim		
103			
VIII.	Zyra për Integritet Evropian		
104	IX. Zyra për Komunitete dhe Kthim		
105			
X.	Zyra e Avokatit të Komunes	107	
XI.	Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje	108	

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS, Z. LUTFI HAZIRI

E nderuar zonja kryesuese e Kuvendit, të nderuar anëtarë të Kuvendit, drejtorë, përfaqësues të Institucioneve të Komunës, Shoqëri Civile dhe Media;

Edhe këtë gjashtë mujor e karakterizon pandemia COVID-19, veçanërisht katër muajt e parë të vitit 2021.

Por, fatmirësisht kemi rënie drastike të të infektuarve dhe në këtë moment që po flasim janë vetëm 25 raste aktive me COVID-19, por ajo që neve na ka shqetësuar dhe prekur thellësisht është humbja e 147 bashkëqytetarëve tanë nga ky virus dhe me këtë rast iu shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjeve të cilët kanë humbur më të dashurit e tyre!

Lajmi i mirë është se më 15 qershor, kemi filluar me vaksinim masiv dhe deri tani kemi arritur në mbi 17 mijë të vaksinuar. Kjo, pra, sipas ekspertëve, është e vetmja mënyrë e imunizimit kundër COVID-19.

Brenda gjashtë muajve të qeverisjes së këtij viti, përveç tjerash, të hyrat nga tatimi në pronë shënojnë rekord të bardhë prej 240 për qind, që përfshihet edhe pagesa nga viti i kaluar – 1.1 milion euro. I falënderoj shumë qytetarët për lojalitetin në kryerjen e obligimeve ndaj shtetit, të cilët gjithmonë kanë qenë shembulli më i mirë në nivel vendi!

Buxheti në total për këtë vit është afro 28 milionë euro dhe i shpenzuar deri tani është mbi 12 milionë euro ose 43.3 për qind. Të hyrat e planifikuara për këtë vit janë katër milionë euro, ndërsa të realizuara afro dy milionë euro.

Në bujqësi, në gjashtë muajt e parë të këtij viti janë subvecionuar mbjelljet pranverore, (402 fermerë përfitues), 360 fermerë kanë përfituar foli plastike, 37 ekonomi familjare janë përfitues të lopëve të racës simental, 50 familje me gjendje të rëndë kanë përfituar pula dhe ushqim për to, sikurse që edhe 40 familje janë përfituese të serrave komerciale.

Te aspekti social, jam i lumtur që pas dinamikës së jashtëzakonshme të punimeve në ndërtimin e Fshatit të Lumtur, këtë projekt në vlerë prej 2.3 milionë dollarë, do ta inaugurojmë në shtator. Falënderim i madh shkon për Qeverinë e Kuvajtit, e cila e ka financuar këtë projekt kaq të madh dhe të rëndësishëm për të moshuarit, nënat pa përkujdesje e personat me nevoja të veçanta!

Te banimi social për 60 familje kemi vazhduar me pagesën e qirave për familjet me probleme të banimit, ndërkaq në dy vitet e fundit janë ndërtuar 30 shtëpi, derisa numri i shtëpive të ndërtuara brenda 7 vjetëve për familjet në nevojë shkon në 163.

Sa i përket rrjetit të ujësjellësit, jam i lumtur që shumica e fshatrave janë bërë me ujësjellës, ndërsa më 29 qershor e kemi nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit CDC dhe Hidromorava për përfundimin e rrjetit edhe në fshatrat e mbetura: Bresalc, Ponesh, Zhegoc, Muhaxherët e Livoqit, Lladovë, Vrapçiq, Verbicë e Kmetocit dhe ana e djathtë e Rugës Qarkore dhe funksionalizimi i tyre do të bëhet në tetor. Pra, në tetor asnjë fshat i Gjilanit nuk do të jetë pa rrjet të ujësjellësit.

Sa i përket Administratës, në këtë periudhë gjashtëmujore, përmes QSHQ-së, janë pranuar: 69,297 kërkesa nga palët, adresuar organeve komunale për shqyrtim dhe vendosje, ndërsa të miratuara (duke përfshirë lëndët e përfunduara në DAP) janë: 60.662. Në proces janë : 8.334. Pra, përkthyer në përqindje, del se janë realizuar mbi 87 për qind të lëndëve, të tjerat janë në proces, por që do të përfundojnë brenda afateve ligjore. Ndërkohë, në aplikim të dietës buxhetore në shpenzime, në shërbimet e autoparkut, veturave të Komunës, brenda gjashtë muajve kemi rënie të shpenzimeve – mbi 10 mijë kilometra më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Shërbimet Publike kanë bërë një punë të jashtëzakonshme, ani pse me mungesë të stafit, dhe projektet që janë realizuar e që janë në realizim janë:

Ndërtimi i trotuareve në lagjen Dardania, rekunstruimi i rrugëve në lagjen Dardania, ndërtimi i rrugës 7 Shtatori, rekonstruimi i rrugës “Hasan Mekuli” dhe “Kadri Osmani”, kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik në rrugën “Vëllezërit Gërvalla”, kanalizimi atmosferik në rrugën “Lot Vaku”, rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe parkingjeve mbrapa Soliterit dhe Teatrit, rregullimi i hapësirës publike (parkingjet në lagjen “Iliria”), rekonstruimi i rrugës “Haqif Tetova”, rehabilitimi i rrugës në fshatin Pogragjë, krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe rregullimi i platos mbi lumin Mirusha – veri, rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotuareve e ndriçimi publik në Fshatin e Lumtur – Zabel, Rruga e Kumanovës, faza 1 dhe 2 janë duke vazhduar sipas buxhetit të planifikuar për këtë vit, zgjerimi i rrugës në drejtim të Bujanocit, Zgjerimi i rrugës me katër korsi në drejtim të Prishtinës (revidim dhe plotësim i projektit), vazhdimi i punimeve në urën e Dobërçanit, vazhdimi i punimeve në rrugën Dobërçan-Pogragjë dhe rrugicave në Dobërçan, rregullimi i platosë së lumit Mirusha - Jugu 2 (inicimi për shpallje), rikonstruimi i rrugës “Adem Jashari” dhe “Zija Shemsiu” (inicim për shpallje), asfaltimi i rrugëve në fshatin Kravaricë të MOEA etj.

Në sektorin e arsimit, po ashtu kemi pasur aktivitetet të ndryshme, projekte, investime dhe donacione nga partnerët tonë mbështetës me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe avancimit profesional të vazhdueshëm, kështu duke funksionalizuar kabinete siç është ai i informatikës, mbështetur nga Qeveria Britanike, inaugurimi i Inkubatorit të Agrobiznesit - Rajonal – Lindje në Shkollën e Mesme të Lartë ‘Arbëria’ në Gjilan, i financuar nga Bashkimi Evropian deri tek projektet dhe programet e tjera që priten të realizohen deri në fund të këtij viti.

Edhe kultura, rinia e sporti, kanë qenë storie e suksesit gjatë kësaj periudhë. Kemi filluar me manifestimin kulturor mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2021”, i cili u realizua me sukses, ani pse gjendje jo e mirë e pandemisë. Gjatë gjysmës së këtij viti, janë realizuar dhjetëra aktivitete kulturore, sportive e të rinisë, ndërkohë që jam shumë i lumtur që e kemi hapur Muzeun Etnologjik, derisa jemi në prag të hapjes së Galerisë së Qytetit.

Teatri vazhdon të jetë storie e suksesit, i cili përkundër gjendjes pandemike, e ka ruajtur me fanatizëm kalendarin kulturor, duke realizuar dhjetëra shfaqje për publikun. Kemi qenë të parët në Kosovë që e kemi rihapur Bibliotekën “Fan S. Noli” në vitin e kaluar në kushte të limituara, derisa në këtë gjashtë mujor, ka qenë funksionale plotësisht.

Në këtë raportim para jush, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, më lejoni që të shpreh mirënjohje të thellë për donatorët e mëdhenj, pa ndihmën e të cilëve nuk do t'ia dilnim në realizimin e projekteve të mëdha, kryesisht infrastrukturore, e që janë: BERZH, Banka Investive Evropiane, USAID, Qeveria e Zvicrës (CDI, DEMOS), Qeveria e Suedisë, Qeveria e Norvegjisë, Qeveria e Kuvajtit, Qeveria e Kosovës e partnerë të tjerë të Gjilanit.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, më lejoni që me këtë rast t'i përmend projektet e mëdha që janë realizuar dhe që janë në realizim gjatë viteve të fundit të qeverisjes:

- Vazhdimi i zgjerimit të rrugës Gjilan-Bujanoc (937 mijë euro),
- Rruga e Kumanovës (2.7 milionë euro), Rruga nacionale Prishtinë-Gjilan-Konçul, (49 milionë euro);
- Impianti për trajtimin e ujërave të zeza (24 milionë euro);
- Ndërtimi i rrugës Verbicë-Sillovi (1.7 milionë euro);
- Rruga hyrëse e dalëse me katër korsi Gjilan-Livoq i Ulët (1.8 milionë euro);
- Ndërtimi i rrugëve në fshatra e qytet (13 milionë euro);
- QKMF (1.4 milionë euro);
- Çarshia e Gjilanit (1.2 milionë euro);
- Vazhdimi i punimeve mbi lumin Mirusha (2.4 milionë euro);
- Stadiumi i qytetit (1.6 milionë euro);
- Tregu i Gjellbër (961 mijë euro);
- Çerdhja në lagjen Arbëria (800 mijë euro);
- Fshati i Lumtur në Zabel (2.2 milionë euro);
- Rikonstruimi i rrugëve dhe trotuareve në lagjen Dardania (638 mijë euro);
- Tregu i kafshëve (392 mijë euro);
- Modernizimi i Tregut dhe parkut në Zhegër (137 mijë euro);
- Rregullimi i hapësirave publike në lagjen Iliria (84 mijë euro), etj.

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara në këtë gjysmë vit (2021), janë të paraqitura në këtë raport ku ndërmjet tjerash, ju të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal dhe qytetarë të nderuar, keni mundësinë për t'u informuar më në hollësi përkritazi me çështjet e raportuara në këtë dokument.

Raporti në fjalë përfshinë punën e secilës drejtori, zyre dhe njësi organizative të Komunës. Përmbushja e objektivave dhe aktivitetëve është rezultat i punës ekipore të personelit të Komunës dhe shfrytëzoi rastin t'i shprehi mirënjohje të gjithëve për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, për më gjerësisht mund t'i referoheni raportit në fjalë. Unë si kryetar i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Administratës Komunale, jemi të gatshëm që t'iu përgjigjemi pyetjeve, komenteve dhe interesimeve tuaja për çdo çështje që janë të përmbledhura në këtë dokument.

Ju falënderoj të gjithëve për punën, angazhimin dhe kontributin tuaj në të mirë të Komunës sonë dhe qytetarëve tanë!

I. DREJTORIA E ADMINISTRAËS SË PËRGJITHSHME

Ajo çka është elementare dhe objektiv kryesor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme dhe si i tillë do të vazhdojë të mbetet komponentë e përhershme është efikasiteti dhe ana profesionale e saj:

- Pranimi me kohë dhe i shpejtë i të gjithave parashtresave;

- Shqyrtimi dhe vendosja e tyre brenda afateve ligjore për të gjitha ato lëndë për të cilat zhvillohet procedurë administrative dhe ato për të cilat nuk zhvillohet procedurë administrative;
- Si dhe disiplina në profesionalizëm gjatë ofrimit të shërbimeve në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi dhe dhjetë parimet bazë të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Duke u mbështetur në legjislacionin adekuat në fuqi dhe në zbatim të planit të punës për vitin 2021 të Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme, gjatë periudhës Janar – Qershor, kemi ofruar këto shërbime juridike administrative dhe në mënyrë statistikore, në tri sektorët e kësaj drejtorie si vijon:

-I- Sektori i Gjendjes Civile

Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2021	30.06.2021
Lloji i dokumentit :			
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile			23549
Certifikatë lindje			9714
Certifikatë martese			5138
Certifikatë vdekje			2072
Aktvdekje			103
Certifikatë vendbanimi			986
Certifikatë të bashkësisë familjare			3039
Certifikatë të gjendje martesore			1457
Certifikatë shtetësie			460
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi			1506
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës			195
Aplikim për fitim të shtetësisë			55
Aplikim për lirim të shtetësisë			24
Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile:			2427

Totali:	50,725
---------	--------

Veprimet – Procedurat e zhvilluara administrative: lindjet, martesat ,vdekjet dhe vendime			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2021	30.06.2021
Lloji i dokumentit :			
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda dhe jashtë vendit :			827
Martesat e lidhura dhe rishkrim martese:			474
Shkurorëzimet :			54
Martesat me element të huaj :			114
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit :			456
Vendime për korrigjime dhe ndërrime në emra personal :			520
Totali			2445

-II-Qendra për Shërbime me Qytetarë

Raporti sipas drejtorive dhe statusit të zgjidhjes së lëndëve

01/01/2021 – 30/06/2021

Drejtoritë	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
DAP	41	1.593	3.050	1	0	0	0	2	34,458	39,135
DKA	2	75	937	1	0	0	0	0	0	1,015
DGJKP	13	257	9,149	9	0	0	0	3	0	9,431
DBF	0	69	6	1	1	0	0	0	0	77
DMSH	0	179	7	0	0	0	0	1	0	187
DUPMM	9	432	268	1	0	0	0	1	0	711
DSHPIB	37	191	10,689	0	0	0	0	4	0	10,921

DSHMS	11	1,298	1,524	129	0	0	0	1	0	2,963
DBP	0	1,616	9	1	0	0	0	0	0	1,626
DZHE	0	0	16	1	0	0	0	0	0	57
Kuvendi i Komunës	0	37	20	0	0	0	0	0	0	57
Kryetari i Komunës	25	2,413	116	0	0	0	0	2	0	2,556
DI	0	41	377	3	0	0	0	0	0	421
DKRS	1	133	36	0	0	0	0	0	0	170
Institucionet Qendrore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali	139	8,334	26,204	147	1	0	0	14	34,458	69,297

Duke marrë parasysh natyrën e punës së kësaj drejtorie, kryesisht në lëshimin e dokumenteve të ndryshme të gjendjes civile, zhvillimin e procedurave administrative si dhe pranimin dhe bartjen e lëndëve drejtorive sipas kërkesave së palëve, statistikën në fjalë pasqyrojnë se Drejtoria për Administratë e Përgjithshme, gjatë kësaj periudhe kohore, nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetarë, ka realizuar si të miratuara dhe të përfunduara me kohë dhe brenda afateve ligjore prej: 37,508 parashtresa.

Gjithashtu, raporti në fjalë pasqyron kryerjen e lëndëve dhe shërbimeve ndaj qytetarëve edhe në Drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve.

Sipas raportit të intranetit, ku edhe MAPL-ja, raporton për Komunitetin, në këtë periudhë gjashtëmujore, përmes QSHQ-së, janë pranuar: 69,297 kërkesa nga palët, adresuar organeve komunale për shqyrtim dhe vendosje, ndërsa të miratuara (duke përfshirë lëndët e përfunduara në DAP) janë: 60.662. Në proces janë : 8.334.

Shikuar në përqindje del se Komuna e Gjilanit, i ka kryer lëndët sipas Ligjit të Procedurës Administrative me një përqindje të kënaqshme prej : 87.53 %.

Konsiderojmë se kemi arritur progres të dukshëm në këtë aspekt nga viti në vit, falë punës dhe angazhimit ekipor dhe individual të secilit zyrtar të kësaj Drejtorie.

Shërbimi i Autoparkut - Veturave të Komunës

Gjashtë muji i vitit	Numri i automjeteve që posedon Komuna	Kilometra të kaluara	Sasia e derivateve të shpenzuara	%
2020	31	102458	9441.39	9.22
2021	30	91645	8385.85	9.15
		-10813	-1055.54	-07

Pra shihet se kemi rënie të kilometrave dhe shpenzimeve me derivate.

Gjatë kësaj periudhe, kemi bërë ndërrimin e rripave dhëmbëzore (set) që përfshijnë ndërrimin e vajit e të filterave për të gjitha automjetet Pezho dhe Golf. Kjo është bërë për shkak të numrit të kilometrave të kaluara, në mënyrë që t'i parandalojmë defektet më të mëdha.

Gjithashtu, kemi pasur në shitje shtatë (7) automjete përmes ankandit publik që kemi vlerësuar se duhet hequr nga përdorimi zyrtar për shkak të defekteve të vazhdueshme dhe të kushtueshme, por nuk ka pas të interesuar për blerjen e tyre. Prapë të njëjtin proces e kemi kërkuar nga Zyra e Prokurimit të zhvillohen procedurat ligjore për shitjen e tyre.

Pasqyrat financiare: Të

hyrat.....54,782.5

0€

Shpenzimet

-Pagat 127,743.48

-Mallra dhe shërbime 125,525.33€

-Shpenzime komunale 7.574.67€

-Shpenzime kapitale

76,847.50€ Gjithsej shpenzimet:

337,6.90,98€

Aktivitete të tjera :

- Burimet njerëzore dhe infrastruktura - mund të themi se jemi të plotësuar mirë me burime njerëzore e po ashtu edhe infrastrukturë të plotë teknologjike për të ofruar shërbime sa më të shpejta dhe cilësore ndaj qytetarëve. Kemi bërë furnizime me kompjuterë të rinj për secilin zyrtar në kuadër të DAP-it e, ndërrimin e të gjithë printereve, po ashtu edhe me pajisje të tjera teknologjike të nevojshme.
- Nga data: 13.06.2021, i kemi hapur dyert për qytetarët për t'iu ofruar shërbime edhe gjatë kohës së pauzës, që do të thotë se puna me palë do të jetë pandërprerë nga ora 8.00 deri 16.00, dhe sipas nevojës edhe jashtë orarit të rregullt të punës për ato shërbime të cilat janë të mundshme t'i ofrojmë.
- Vazhdimisht kemi bërë vizita në të gjitha Drejtoritë e Administratës Komunale për të parë më për së afërmi si po shkon procedimi i lendeve nga personat e autorizuar.
- Në QSHQ kemi hartuar dhe lanësuar 700 copë broshura sensibilizuese për qytetarët me qëllim që të krijojmë lehtësira për qasje në procedurat administrative që ofron Komuna.
- I kemi iniciuar po thuajse të gjitha aktivitetet e prokurimit sipas planit vjetor të DAP-it 2021.

Sfidë aktuale mbetet çështja e kërkesave të shumta dhe disa të pa realizueshme të qytetarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, por çështja e trajtimit dhe vendosjes së këtyre kërkesave në masë të madhe është nën juridiksionin e autoriteteve qendrore, përderisa bashkëpunimi, ndihma dhe këshillat profesionale administrative nuk kanë munguar asnjëherë nga ana e Menaxhmentit dhe Zyrtarët e DAP-it.

Shërbimet e TI-së

Kjo periudhë e vitit 2021 karakterizohet me aktivitete të shumta në fushën e teknologjisë informative si rrjedhojë e furnizimit të institucioneve komunale me pajisje të reja teknologjike. Mosfunksionimi i mirë i sistemit të Intranetit, posaçërisht në muajt e parë të vitit ka qenë një sfidë në vete edhe pse ky sistem mirëmbahet nga ASHI. Sa i përket pandemisë, gjatë kësaj periudhe kohore shumica dërmuese e zyrtarëve kanë punuar në zyrat e tyre dhe kemi dhënë përkrahje teknike nëpër zyrat e tyre.

Furnizimi me kompjuterë të ri : gjatë kësaj periudhe, institucionet komunale janë furnizuar me mbi njëqind (100) kompjuterë, laptopë dhe monitorë të ri. Ne kemi bërë instalimin e këtyre pajisjeve nëpër drejtori të ndryshme dhe atë duke përfshirë: montimin, formatimin me sistemin operativ Windows 10, instalimin e të gjitha programeve përcjellëse, përditësimin e programeve si dhe kemi bërë bartjen e të dhënave nga kompjuterët e vjetër te kompjuterët e ri.

Marrja në shërbim të fotokopjuesve dhe printerëve: gjatë kësaj periudhe, institucionet komunale kanë marrë në shfrytëzim mbi 30 fotokopjues dhe mbi 50 printerë. Të gjitha këto pajisje është dashtë t'i lidhim dhe konfigurojmë-instalojmë nëpër kompjuterët e drejtorive dhe institucionet tjera (si p.sh. QKMF).

Punët tjera të përditshme:

Rrjeti qeveritarë dhe mikrovalorë: në kohë të vazhdueshme kemi bërë monitorimin e rrjetit dhe kemi bërë evitimin e prishjeve eventuale që janë paraqitur. Gjithashtu kemi monitoruar dhe mirëmbajtur rrjetin mikrovalorë në 5.x GHz duke përfshirë këtu edhe riparimet e defekteve.

Përkrahja teknike: në kohë të vazhdueshme kemi dhënë përkrahjen zyrtarëve/shërbyesve civilë për të gjitha çështjet e Teknologjisë Informative (instalime të kompjuterëve, printerëve, tonerëve, antiviruseve, kabllimeve të ndryshme, ndërrimin e lokacioneve, përdorimin e softwereve të ndryshëm etj.), këtu përfshihen të gjitha objektet komunale pra edhe ato nëpër fshatra

WEB faqja komunale: në kohë të vazhdueshme kemi bërë mirëmbajtjen e WEB faqes zyrtare komunale dhe bëjmë përkrahje direkt zyrtarëve përgjegjës për furnizimin me shënime në WEB faqen zyrtare.

Rrjetet dhe sistemet telefonike: të gjitha nevojat që paraqiten në rrjetin telefonik dhe centralet telefonike mirëmbahen nga ne e gjithashtu edhe të rrjetit të telefonave VoIP. Po ashtu zyra jonë ka komunikim sipas nevojës me PTK për intervenimet në rrjetin telefonik dhe lidhjet ADSL.

Domain dhe e-mailat zyrtar: aty ku kemi pasur mundësi, kemi futur kompjuterët në 'Domain' me çka fitohet siguria e shënimeve, mbrojtja nga viruset, përdorimi i kompjuterëve për punët zyrtare, instalohen vetëm programet e licencuara dhe nuk do të ketë vend për programe 'pirate' etj. Po ashtu sipas mundësive kemi aktivizuar email adresat zyrtare.

Sistemet operative: aty ku kanë lejuar mundësitë teknike të pajisjeve, është instaluar sistemi operativ Windows 10. Sistemet operative Windows 7 dhe ato më të vjetra në princip nuk do të instalohen më (përveç në rastet kur pajisja nuk e pranon sistemin operativ Windows 10).

Zyra e prokurimit: në vazhdimësi kemi qenë në kontakt me zyrën e prokurimit. Kemi marrë pjesë në përpilimin e përshkrimeve teknike lidhur me furnizimet për fushën e TI'së (p.sh. furnizim me shërbime për nevojat e e-kioskave) dhe po ashtu i këshillojmë rreth këtyre

çështjeve. Po ashtu kemi qenë edhe pjesë e komisioneve të ndryshme si dhe kemi ndihmuar në pranimin e pajisjeve.

MPB-ASHI: Në kohë të vazhdueshme kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme – ASHI të cilët e bëjnë mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e serverëve dhe rrjetit qeveritar në përgjithësi.

Organizatat tjera: Kemi dhënë përkrahje teknike edhe organizatave tjera si p.sh: QKMF, ambulancave, çerdheve, shollave fillore dhe të mesme.

Gjendja Civile dhe Intraneti:

Në vazhdimësi ndihmojmë ofiqarët dhe zyrtarët e GJC'së në shfrytëzimin e sistemit të GJC'së duke mos kursyer fare kohën dhe dijen tonë.

Në kohë të vazhdueshme kemi pasur kontakte me ASHI mbi mirëmbajtjen dhe informim mbi problemet e 'Intranet-it' (sa për informatë, sistemi i 'Intranetit' përdoret nga të gjitha Drejtoritë Komunale).

II. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

Në harmoni me planin e punës për vitin 2021, si dhe në harmoni me prioritetet strategjike të sektorëve i kemi ndërtuar partneritetet me organizata vendore e ndërkombëtare si: MBPZHR, Islamic Relief Kosova, OZHR Mëshqerra, IADK, Shkollën e mesme e agrobiznesit ARBËRIA, si dhe kemi vazhdu me përmbylljen e projektit të Komisionin Evropian.

Nga data 01 janar deri me 31 mars, kemi pranuar **361** kërkesa për prerjen e masës drusore në pyje private. Këto kërkesa i kemi dorëzuar në Agjencionin Pyjor të Kosovës – zyra regionale për procedim të mëtejme.

Me datë: 11 janar 2021, kemi pasur vërshime dhe nga vizita në terren kemi konstatuar se në shumicën e fshatrave dëmet kanë qenë të riparueshme. Dëme më të theksuara janë konstatuar në fshatrat: Uglar, Pogragjë, Livoq i ulët, Livoq i epërm dhe Malishevë. Në kuadër të komisionit komunal kemi vlerësuar dëmet e shkaktuara në kultura bujqësore, vlera e të cilave është **79,530.00 €**.

Me vendim të shtabit emergjent, dhe në bashkëpunim me drejtorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale kemi shpërnda **30 m³** dru të konfiskuara për familjet në nevojë.

Menaxhimi i vendgjuetive në komunën e Gjilanit bëhet nga shoqatat e gjahtarëve me të cilët kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm. Sipas obligimeve ligjore ky menaxhment ka

dorëzuar planet vjetore të menaxhimit si dhe ka kryer obligimet financiare që i ka ndaj komunës.

Me datë: 26 shkurt 2021, kemi nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me organizatën **Islamic Relief Kosova** për realizimin e 4 programeve në bujqësi. Furnizimi i blegtorëve me **37** krerë mëshqerra barëse të racës Simental, Furnizimin e **40** perimtarëve me Serra alumini, hapjen e **12** puseve si dhe furnizimin e **50** familjeve skamnore me nga **30** pula vojse. Vlera e këtij projekti që është me bashkëfinancim është **157,264.11 €**.

Gjatë muajit mars kemi pranuar **460** aplikacione të fermerëve për farë misri dhe **361** aplikacione për foli plastike.

Me datë: 7 prill 2021, është bërë shpërndarja e kontingjentit të tretë me koncentrat për të gjithë përfituesit nga OZHR Mëshqerra. Janë shpërndarë **10.560** kg koncentrat për 66 blegtorë dhe me këtë kjo organizatë i ka përmbushur obligimet e veta ndaj fermerëve.

Me datë: 12 prill 2021, kemi organizuar një seminar praktik në fshatin Bresalc për t'i përgatitur kultivuesit e arrës (përfitues nga komuna) për formimin e drejtë të kurorës.

Subvencionimi i mbjelljeve pranverore me farë misri, si masë e përhershme është implementuar me datë: 16 prill 2021, ku kanë përfituar **402** fermerë. Janë shpërndarë **800** thasë farë hibride FAO 400 dhe FAO 500. Me qëllim të shmangies së tollovisë kemi organizuar shpërndarjen me orar duke i ftuar bujqit në kohë të caktuar dhe kemi punuar pa ndërprerje edhe gjatë vikendit. Janë trajtuar fermerët që nuk përfitojnë subvencione nga MBPZHR dhe vlera e këtij projekti kap shumën prej **15,600.00 €**.

Me datë: 7 maj 2021, kemi implementuar projektin e furnizimit të **261** fermerëve me foli plastike. Në këtë projekt janë përfshirë perimtarët e vegjël, ata që kanë serra familjare dhe me gjendje ekonomike më të rënduar. Vlera e këtij projekti **11,250.00 €**.

E kemi vazhduar bashkëpunimin me IADK në mbështetje të prodhuesve të bimëve mjekuese dhe aromatike. Kemi pasur një sesion informues dhe aktivitetet tjera i presim në vazhdim të këtij projekti.

Kemi përmbyllur projektin e BE -së „ **Të rinjtë në agrobiznes** “ kemi përfunduar pagesën e të gjitha granteve. Janë financuar **37** biznese fillestare dhe **7** ekzistuese.

Me datë: 27 maj 2021, komuna e Gjilanit u përfshi nga një stuhi e pazakontë e rrebeshit të shiut dhe breshrit ku u shkaktoan dëme të konsiderueshme në kulturat bujqësore. Fshatrat më të goditura ishin: fshatrat Sllubicë dhe Pogradjë ku shkalla e dëmeve në kultura bujqësore është 100 %, pastaj dëme të konsiderueshme u gjetën në fshatrat: Nasalë, Lladovë, Zhegër, Demiraj, Muqibabë, Llovçë, Kokaj, Kravaricë, Gumnishtë etj.

Komisioni komunal, pjesë e të cilit është edhe një përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe raportin final i është dorëzuar Ministrisë së Bujqësisë me kërkesë për kompensim të dëmeve. Vlera e dëmit të konstatuar është **228,716.10 €**, të vlerësuara në 106 ekonomi familjare.

Dëmet nga breshëri i datës: 27 dhe 28.05.2021										
1	Ruzhdi Selimi	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.5	40%	3550	710	0.18	127.80
				Mollë	0.04	80%	11250	360	0.39	140.40
				Kumbulla	0.04	80%	6080	195	0.51	99.20
				Arra	0.02	80%	2290	36.6	2.16	79.10
									Totali	446.50
2	Qamil Selimi	Nasalë	Breshëri	Grurë	2	40%	3550	2840	0.18	511.20
				Kumbulla	0.04	80%	6080	194.5	0.51	99.20
				Mollë	0.03	80%	11250	270	0.39	105.30
				Qepë	0.04	70%	14680	411	0.46	189.00
									Totali	904.70
3	Imer Aliu	Nasalë	Breshëri	Kunguj misiri	0.04	40%	24010	384	0.81	311.20
				Mollë	0.03	80%	11250	270	0.39	105.30
									Totali	416.50
4	Milaime Selimi	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.03	80%	6080	145	0.51	74.40
				Mollë	0.01	80%	11250	90	0.39	35.10
									Totali	109.50
5	Naser Aliu	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.03	80%	6080	145	0.51	74.40
6	Naip Ukshini	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.03	80%	6080	145	0.51	74.40
7	Nezir Selimi	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.015	80%	6080	73	0.51	37.20
				Molla	0.015	80%	11250	135	0.39	52.60
									Totali	89.80
8	Nexhat Selimi	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.02	80%	6080	97	0.51	49.60
				Molla	0.015	80%	11250	134	0.39	52.60
									Totali	102.20
9	Rexhep Selimi	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.03	80%	6080	145.9	0.51	74.40

10	Xhevdet Velu	Nasalë	Breshëri	Grurë	3.9	40%	3550	5538	0.18	996.80
----	--------------	--------	----------	-------	-----	-----	------	------	------	---------------

11	Afrim Emini	Nasalë	Breshëri	Grurë	2.4	40%	3550	3408	0.18	613.40
12	Xhelal Rashiti	Nasalë	Breshëri	Grurë	1.4	40%	3550	1988	0.18	357.80
13	Hajrush Emini	Nasalë	Breshëri	Grurë	3.2	40%	3550	4544	0.18	817.90
14	Belgin Emini	Nasalë	Breshëri	Grurë	2	40%	3550	2840	0.18	511.20
15	Ismajl Ukshini	Nasalë	Breshëri	Grurë	2	40%	3550	2840	0.18	511.20
16	Emin Emini	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.5	40%	3550	718	0.18	127.80
17	Ajet Aliu	Nasalë	Breshëri	Grurë	8.6	40%	3550	12212	0.18	2198.10
18	Nexhip Selimi	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.35	40%	3550	497	0.18	89.46
19	Nexhat Selimi	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.36	40%	3550	511.2	0.18	92.00
20	Bekim Ukshini	Nasalë	Breshëri	Kumbulla	0.2	80%	6080	972.8	0.51	496.10
21	Emrush Velu	Nasalë	Breshëri	Grurë	2.45	40%	3550	3479	0.18	626.22
22	Shemsedin Selimi	Nasalë	Breshëri	Grurë	1.5	40%	3550	2130	0.18	383.40
23	Bujar Bektashi	Nasalë	Breshëri	Grurë	2	40%	3550	2840	0.18	511.20
				Molla	0.13	80%	11250	1170	0.39	456.30
									Totali	967.50
24	Saqip Bektashi	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.5	40%	3550	718	0.18	127.80
25	Muhamet Ukshini	Nasalë	Breshëri	Grurë	1.7	40%	3550	2414	0.18	434.52
26	Qahil Ukshini	Nasalë	Breshëri	Grurë	2	40%	3550	2840	0.18	511.20
27	Hamdi Zeqiri	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.6	40%	3550	852	0.18	153.36

28	Selami Aliu	Nasalë	Breshëri	Grurë	0.55	40%	3550	781	0.18	140.50
29	Agim Halimi	Sllubicë	Breshëri	Patate	0.03	100%	20010	600	0.28	168.00
				Qepë	0.02	100%	14680	293.6	0.46	135.05

				Livadh	0.9	100%	3420	3078	0.14	430.90
									Totali	733.10
30	Shefqet Halimi	Sllubicë	Breshëri	Patate	0.03	100%	20010	600	0.28	168.00
				Qepë	0.02	100%	14680	293.6	0.46	135.05
				Livadh	0.8	100%	3420	2736	0.14	383.00
									Totali	606.05
31	Sahit Mehmeti	Sllubicë	Breshëri	Domate	0.02	100%	28290	565	0.57	322.50
				Qepë	0.02	100%	14680	293.6	0.46	135.05
				Patate	0.03	100%	20010	600	0.28	168.00
				Specat	0.01	100%	19110	191	0.76	145.00
				Grurë	5	100%	3550	17750	0.18	3195.00
				Jonxhë	1	50%	4610	4610	1.57	3618.80
				Bari	3	100%	3420	10260	0.14	1436.40
				Misër	1	100%	4160	4160	0.14	582.40
									Totali	9603.15
32	Halil Halimi	Sllubicë	Breshëri	Grurë	0.25	100%	3550	887.5	0.18	159.70
33	Rexhep Bushati	Sllubicë Gjilan	Breshëri	Grurë	1.5	100%	5325	5325	0.18	958.50
				Bari	1	100%	3420	3420	0.14	478.00
				Molla	0.1	100%	11250	1125	0.39	438.75
									Totali	1875.25
34	Pajazit Zahiri	Sllubicë	Breshëri	Tërshër	0.7	100%	2000	1400	0.29	406.00
				Bari	1.4	100%	3420	4788	0.14	670.30
									Totali	1076.30
35	Hajredin Xhemali	Sllubicë	Breshëri	Bari	2	100%	3420	6840	0.14	957.60
36	Fadil Latifi		Breshëri	Patate	0.35	50%	7003.5	3501.7	0.28	980.49

		Lladovë		Grurë	0.5	40%	3550	710	0.18	127.80
									Totali	1108.29
37	Naim Q. Ajeti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.4	30%	3550	426	0.18	76.68
38	Jakup A.Sherifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	2	30%	3550	2130	0.18	383.40
				Shalqin	2	50%	20730	20730	0.19	3938.70
				Pjepen	0.5	50%	14080	3520	0.34	1196.80
									Totali	5518.9
39	Abdyl Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	40%	3550	426	0.18	76.68
				Patate	0.7	60%	20010	8404.2	0.28	2353.17
									Totali	2429.85

40	Bekim Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	2.4	30%	3550	2556	0.18	460.08
				Shalqin	1.6	50%	20730	16584	0.19	3150.96
				Pjepen	0.5	50%	14080	3520	0.34	1196.80
									Totali	4807.84
41	Besim Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	40%	3550	426	0.18	76.68
				Specat	0.15	50%	19110	1433.25	0.76	1089.27
									Totali	1165.95
42	Zenel Imeri	Lladovë	Breshëri	Specat	0.2	50%	19110	1911	0.76	1452.36
				Shalqin	0.3	50%	20730	3109.5	0.19	590.80
				Pjepen	0.2	50%	14080	1408	0.34	478.72
									Totali	2521.88
43	Rahim Sh.Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.9	30%	3550	958.5	0.18	172.53
				Patate	0.4	40%	20010	3201.6	0.28	896.44
									Totali	1068.97
44	Imri F.Jakupi	Lladovë	Breshëri	Grurë	1.6	20%	3550	1136	0.18	204.48
45	Shefki I. Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.8	20%	3550	568	0.18	102.24
46	Xhabir Imeri		Breshëri	Grurë	1.1	20%	3550	781	0.18	140.58
				Shalqin	0.3	50%	20730	3109.5	0.19	590.80

		Lladovë							Totali	731.38
47	Kosum Ymeri	Lladovë	Breshëri	Shalqin	0.79	50%	20730	8188.3	0.19	1555.78
48	Arben Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.22	40%	3550	312.4	0.18	56.23
				Molla	0.6	30%	11250	2025	0.39	789.70
									Totali	845.93
49	Bekim Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	30%	3550	319.5	0.18	57.51
50	Burim Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.5	20%	3550	355	0.18	63.90
51	Kadrush Emini	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.32	20%	3550	227.2	0.18	40.90
52	Irfan Mustafa	Lladovë	Breshëri	Grurë	4	30%	3550	4260	0.18	766.80

53	Kadri Ajeti	Lladovë	Breshëri	Grurë	1.5	30%	3550	1597.5	0.18	287.55
54	Rexhep Ajeti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.6	30%	3550	639	0.18	115.02
55	Nijazi Ramadani	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.54	30%	3550	575.1	0.18	103.51
56	Ram Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	40%	3550	426	0.18	76.68
57	Giner Ramadani		Breshëri	Grurë	1.6	40%	3550	2272	0.18	408.96

		Lladovë								
58	Xhevdet Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.6	30%	3550	639	0.18	115.02
59	Xhemajl Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.2	40%	3550	284	0.18	51.12
60	Behxhet Ymeri	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	30%	3550	319.5	0.18	57.51
61	Rexhep Ymeri	Lladovë	Breshëri	Grurë	0.3	30%	3550	319.5	0.18	57.51
62	Hamzi Mahmuti	Lladovë	Breshëri	Shalqin	1	50%	20730	10365	0.19	1969.35
63	Shefqet Latifi	Lladovë	Breshëri	Grurë	2	20%	3550	1420	0.18	255.60
64	Sabedin Cani	Llashticë	Breshëri	Grurë	0.73	40%	3550	1036.6	0.18	186.58
65	Islam Rexhepi	Gumnishtë	Breshëri	Dredhëza	1.95	35%	7140	4873.05	1.12	5478.81

66	Fadil Sabiti	Gumnishtë	Breshëri	Dredhëza	1.9	25%	7140	3391.5	1.12	3798.50
				Vishnje	4	15%	3340	2004	0.97	1943.88
									Totali	5742.38
67	Bashkim Rexhepi	Muqibabë	Breshëri	Jonxhë	2.1	50%	4610	4840.5	1.57	7599.60
				Patate	0.05	100%	20010	1000.5	0.28	280.10
				Fasule	0.04	100%	2320	92.8	2.03	188.40
				Tërshërë	1	100%	2000	2000	0.29	580.00
				Bari	0.4	80%	3420	1094.5	0.14	153.20

				Arra	0.07	100%	2290	160.3	2.16	346.24
									Totali	9147.50
68	Ildriz Rexhepi	Muqibabë	Breshëri	Bari	1.5	80%	3420	4104	0.14	574.50
				Jonxhë	0.5	50%	4610	1152.5	1.57	1809.40
				Arra	0.02	100%	2290	45.8	2.16	98.90
									Totali	2482.80
69	Nazif Rexhepi	Muqibabë	Breshëri	Tërshërë	2	100%	2000	4000	0.29	1160.00
				Jonxhë	0.5	50%	4610	1152.5	1.57	1809.40
				Misër	0.2	100%	4160	832	0.14	116.40
				Kumbulla	0.24	100%	6080	1459	0.51	744.20
									Totali	3830.00
70	Ramadan Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Patate	0.04	100%	20010	800	0.28	224.10
				Jonxhë	3.5	50%	4610	8067.5	1.57	12666.00
				Arra	0.2	100%	2290	160.3	2.16	346.20
				Molla	0.06	100%	11250	675	0.39	264.00
				13500.30						
									Totali	
71	Xhafer Selmani	Muqibabë	Breshëri	Bari	1	80%	3420	2736	0.14	383.00
				Jonxhë	0.5	50%	4610	1152.5	1.57	1809.40
				Patate	0.04	100%	20010	800	0.28	224.10
				Molla	0.04	100%	11250	450	0.39	175.50
									Totali	2592.00
72	Behar Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Bari	1	80%	3420	2736	0.14	383.00
				Molla	0.04	100%	11250	450	0.39	175.50
									Totali	585.50
73	Khavit Ibrahimi	Muqibabë	Breshëri	Misër	0.6	70%	4160	1747	0.14	244.60
				Fasule	0.2	80%	2320	371	2.03	753.50
									Totali	998.10
74	Sadri Ibrahimi	Muqibabë	Breshëri	Bari	3	80%	3420	8208	0.14	1149.10
				Jonxhë	2	50%	4610	4610	1.57	7237.70
				Patate	0.1	100%	20010	2001	0.28	560.20
									Totali	8947.00
75			Breshëri	Molla	0.2	100%	11250	2250	0.39	877.50

	Vehid Ibrahim	Muqibabë								
76	Selajdin Ibrahim	Muqibabë	Breshëri	Miser	0.6	70%	4160	1747	0.14	244.60
				Fasule	0.2	80%	2320	371	2.03	753.50
				Patate	0.05	100%	20010	1000.5	0.28	280.10
									Totali	1278.20
77	Afrim Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Bari	2	80%	3420	5472	0.14	766.00
				Jonxhë	1	50%	4610	2305	1.57	3618.80
				Patate	0.02	100%	20010	400.2	0.28	112.00
									Totali	4496.80
78	Hekrem Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Jonxhë	4	50%	4610	9220	1.57	14475.40
				Bari	2	80%	3420	5472	0.14	766.00
				Arra	0.2	100%	2290	458	2.16	989.20
									Totali	16230.60
79	Hamid Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Patate	0.05	100%	20010	1000.5	0.28	280.14
				Molla	0.1	100%	11250	1125	0.39	438.75
									Totali	718.89
80	Fatmir Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Patate	0.04	100%	20010	800.4	0.28	224.10
				Arra	0.1	100%	2290	229	2.16	494.60
									Totali	718.70
81	Femi Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Molla	0.13	100%	11250	1462	0.39	570.18
82	Femi Ademi	Muqibabë	Breshëri	Bari	5	80%	3420	13680	0.14	1915.20
				Molla	0.4	100%	11250	4500	0.39	1755.00
									Totali	3670.20
83	Xhemail Zymeri	Muqibabë	Breshëri	Patate	0.03	100%	20010	600.3	0.28	168.00
				Specia	0.01	100%	19110	191.1	0.76	145.23
									Totali	313.23
84	Burim Ademi	Muqibabë	Breshëri	Bari	2	80%	3420	5472	0.14	766.00

85	Ilaz Hyseni	Muqibabë	Breshëri	Molla	0.05	100%	11250	562.5	0.39	219.37
				Dardhë	0.02	100%	8380	167.6	0.81	135.75
									Totali	355.12
86	Menderes Kadriu	Agmia Fruits Gumnisht	Breshëri	Vishnje	30	15%	3340	15030	0.97	14579.10
				Kumbulla	20	20%	6080	24320	0.51	12403.20

									Totali	26982.30
87	Enver Isufi	Fruit Kos Kravaricë	Breshëri	Dardhë	5.5	30%	8380	13827	0.81	11199.87
				Vishnje	1.88	20%	3340	1255.84	0.97	1218.16
									Totali	12418.03
88	Taulant Isufi	Kravaricë	Breshëri	Molla	5.45	30%	11250	18393.75	0.81	7173.56
89	Alban Nuhiu	Kravaricë	Breshëri	Molla	5.75	30%	11250	19406.25	0.39	7568.43
90	Fahredin Amidi	Kokaj	Breshëri	Molla	2	100%	11250	22500	0.39	8775.00
				Kumbulla	0.5	100%	6080	340	0.51	1550.40
				Arra	0.15	100%	2290	343.5	2.16	741.96
									Totali	11067.36
91	Sami Amidi	Kokaj	Breshëri	Bari	2	80%	3420	5472	0.14	766.08
				Kumbulla	0.2	100%	6080	1216	0.51	620.16
									Totali	1386.24
92	Qazim Qazimi	Kokaj	Breshëri	Bari	3	80%	3420	8208	0.14	1149.12
				Molla	0.02	100%	11250	225	0.39	87.75
									Totali	1236.87
93	Ekrem Haziri	Kokaj	Breshëri	Bari	20	80%	3420	54720	0.14	7660.80
				Patate	0.04	100%	20010	800	0.28	224.28
				Fasule	0.03	100%	2320	69.6	2.03	141.28
				Molla	0.15	100%	11250	1687.5	0.39	658.12
				Kumbulla	0.05	100%	6080	304	0.51	155.04
				Jonxhë	0.6	50%	4610	1383	1.57	2171.31
				Qepë	0.01	100%	14680	146.8	0.46	67.52
									Totali	11078.17
94	Yllzon Haziri		Breshëri	Bari	10	80%	3420	27360	0.14	3830.40

		Kokaj		Patate	0.04	100%	20010	800.4	0.28	224.10
				Fasule	0.15	100%	2320	348	2.03	706.44
				Qepë	0.01	100%	14680	146.8	0.46	67.52
									Totali	4828.46
95	Dardan Vokshi	Gumnishtë	Breshëri	Arra	3	10%	2290	687	2.16	1483.92
96	Besim Isufi	Gumnishtë	Breshëri	Arra	3	5%	2290	687	2.16	1483.92
97	Adem Fetahu	Pogragjë	Breshëri	Fasule	0.09	100%	2320	208.8	2.03	423.86
				Grurë	0.7	60%	3550	1491	0.18	268.38
				Patate	0.25	50%	20010	2501.25	0.28	700.35
									Totali	1392.59
98	Zeqirja Fetahu	Pogragjë	Breshëri	Fasule	0.05	80%	2320	92.8	2.03	188.38
99	Fadil Nuredini	Pogragjë	Breshëri	Patate	0.02	100%	20010	400.2	0.28	112.05
				Fasule	0.03	100%	2320	69.6	2.03	141.28
									Totali	253.33
100	Afrim Nuredini	Pogragjë	Breshëri	Fasule	0.06	100%	2320	139.2	2.03	282.57
101	Ramadan Salihu	Pogragjë	Breshëri	Fasule	0.05	100%	2320	116	2.03	235.48
102	Bekim Nuredini	Pogragjë	Breshëri	Specë	0.04	100%	19110	764.4	0.76	580.94
103	Ardian Xhemali	Pogragjë	Breshëri	Fasule	0.05	100%	2320	116	2.03	235.48
104	Nuredin Avdiu		Breshëri	Fasule	0.08	100%	2320	185.6	2.03	376.76

		Pogragjë								
105	Lulzim Rexhepi	Pogragjë	Breshëri	Misër	0.4	100%	4160	1664	0.14	232.96
106	Ali S.Selimi	Llashticë	Breshëri	Grurë	1	40%	3550	1420	0.18	255.60
Gjithsejtë: 228,716.10 €										

Në bazë të planifikimeve vjetore të shfrytëzimit të masës drusore për vitin 2021 nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, janë planifikuar prerja e masës drusore me vëllim prej **1.371 m³** në njësinë menaxhuese të Zhegocit. Ky aktivitet ndodhet në fazën e përgatitjes së ankandit në zyrën e prokurimit.

Me datë: 16.06.2021, kemi implementuar dy programet me Islamic Relief Kosova, atij të furnizimit të 37 familjeve me mëshqerra të racës Simental dhe 50 familjeve me pula vojse. Ndërsa, dy programet tjera ai i serrave dhe hapja e puseve janë në fazën e shqyrtimit të aplikacioneve dhe vizitave në teren.

Me vendim të Kryetarit të komunës z.Lufti Haziri me nr.të protokollit 02/451 të datës **23.06.2021** formohet komisioni komunal për korrje-shirje në përbërje prej pesë anëtarëve. Komisioni komunal për korrje-shirje në takimin e mbajtur më 30.06.2021, ka përpiluar planin dinamik të aktiviteteve ku janë paraparë: Takimi me kombajnerë, vizita mullirit dhe pikave grumbulluese, hapja zyrtare e fushatës, si dhe monitorimi i saj deri në përfundim të korrjeve.

III. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme të cilat i përkasin fushëveprimtarisë së vet - Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim konform buxhetit të projektuar dhe planit të punës objektiv të vetin ka pasur këto detyra :

Ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;

Kompletimi dhe harmonizimi i infrastrukturës ligjore-akteve normative nga fushëveprimi i Drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;

Realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;

Mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike, infrastrukturën, Identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimi, ofrimi i zgjidhjeve të mundshme;

Krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim në procedurë administrative ka shqyrtuar një numër të kërkesave dhe atë konform LPA dhe sistemit unik të përcaktuar nga MAPL për administratën komunale brenda afatit ligjor janë trajtuar:

Statusi i lendeve ne procedure administrative:

Te arritura 570

Ne proces 59

Miratuara 469

Lëndë të daluara nga DSHPIB 42

Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit brenda territorit të saj duke përfshirë edhe transportin e rregullt të udhëtarëve me taxi dhe me autobus.

Numri taksistëve legal të cilët janë të pajisur me leje për operim brenda territorit të Komunës së Gjilanit deri me 01.07.2021 është 78.

Me vendim sipas Ligjit mbi Transportin Rrugor është bërë vazhdimi/vërtetimi i rendit të udhëtimit në linjat urbane-periferike në territorin e komunës së Gjilanit në vitin 2021, për 15 operator nga 28.02.2021 deri 29.02.2024 për tri vite.

II. Projektet kapitale si dhe kontratat që ofrojnë shërbime për qytetar

Me projektin “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve” jemi angazhuar që ne asnjë moment mos të kemi ndonjë ndërprerje ose bllokim të rrugëve nga reshjet e bores duke u angazhuar në mirëmbajtjen e rrugëve në tërë territorin e komunës tonë

Për projektin “Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet dhe fshatra të komunës së Gjilanit” kontraktuar kompaninë “El-Bau”, ku më anë të kësaj kontrate janë sanuar disa rrugë kryesore në qytet si “Nënë Teresa”, “15 Qershori”, “Beqir Musliu”, “Haki Myderizi” dhe do të vazhdojmë me sanimin e rrugëve Isa Kastrati, rruga, Tivari, Evlia Qelebia, dhe në rrugë tjera në qytet dhe fshatra.

Projekti “Pastrimi i rrugëve mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara” është duke vazhduar me rritëm të kënaqshëm në pastrimin e trotuareve dhe hapësirave të gjelbëruara.

Projekti “Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e komunës së Gjilanit. Kontraktues “Toni Goni” nga Gjilani. Ndriçimi publik në të gjitha fshatrat është duke vazhduar sipas kërkesave tona .

Drejtoria e SHPIB e gjithashtu me projektin “Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin e Gjilanit, është duke u punua sipas kërkesave të qytetarëve për sanimin e defekteve dhe shtrimin e rrjetit të ri.

Me projektin e Shërbimeve të varrimit të qytetarëve në Komunën tonë, shërbimet janë kryer me përkushtim dhe për shkak të pandemisë kemi një rritje të numrit të vdekjeve dhe për 5 mujorin e këtij viti kemi 457 raste të vdekjeve për të cilat janë paguar 96,074.00 euro nga buxheti i komunës.

Drejtoria e DSHPIB, me projektin “Rregullimi dhe hapja e Rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i deponive të egra dhe i lumenjve” - ka intervenuar në disa rajone siç është në hapja e rrugën nga fshati Selishtë në drejtim të fshatit Stubëll komuna e Vitisë, pastaj pas vërshimeve të fundit kemi intervenuar në fshatin Sllubicë dhe Pogragjë në deblokimin e rrugëve të mbyllura dhe të shkatërruara tërësisht duke bllokuar një numër të madhe të shtëpive dhe familjeve të këtyre dy fshatrave. Gjithashtu është bërë edhe pastrimi i rrugës regjionale Zhegër-Stançiq që lidhe piken kufitare me Kumanovë , edhe pse kjo rrugë nuk është në përgjegjësi të komunës tonë, por duke pesë parasysh bllokimin e rrugës ne kemi intervenuar shumë shpejtë duke bërë rrugën plotësisht të qarkullueshme.

Në vazhdim disa nga projektet e përfunduara këtë vit dhe ato në realizim

- Ndërtimi i trotuareve në lagjen Dardania,
- Rekonstruimi i rrugëve në lagjen Dardania,
- Ndërtimi i rrugës 7 Shtatori,
- Ka përfunduar asfaltimi i shtresës së parë me asfalt së shpejti do të finalizohet si projekt.
- Rekonstruimi i rrugës Hasan Mekuli dhe Kadri Osmani , pritet të shtrohet shtesa e parë me asfalt
- Kanalizimi fekal, Kanalizimi atmosferik Rruga Vëllezërit Gërvalla
- Kanalizimi atmosferik rruga Lot Vaka është kryer,
- Rregullimi i hapësirave gjelbëruese dhe parkingjeve mbrapa Soliterit dhe Teatrit
- Rregullimi i hapësirës publike (parkingjet në lagjen Bojanina-Kamnik
- Projekti është afër përfundimit
- Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova
- Projekti është duke vazhduar me dinamikë të kënaqshme □ Rehabilitimi i rrugës në fshatin Pogragjë
- Projekti është duke vazhduar me dinamikë të kënaqshme
- Krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe rregullimi i platos mbi lumin Mirush- Veri
- Projekti është duke vazhduar por mungesa e buxhetit nga ana e Ministrisë së Ambientit po ndikon në dinamikën e punimeve
- Rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotualet, ndriçimi publik në Sos fshatin në Zabel
- Projekti është duke vazhduar me dinamikë të kënaqshme
- Rruga e Kumanovës , faza 1 dhe 2 janë duke vazhduar sipas buxhetit të planifikuar për këtë vit.
- Zgjerimi i rrugës në drejtim të Bujanocit
- Me dinamike të kënaqshme
- Zgjerimi i rrugës në drejtim të Prishtinës (revidim dhe plotësim i projektit ...)
- Vazhdimi i punimeve në Urën e Dobërqanit (është nënshkruar aneks kontrata...)

- Vazhdimi i punimeve në rrugën Dobërqan-Pogragjë dhe rrugicave në Dobërqan , Mungesa e buxhetit nga ana e MI
- Rregullimi i platosë së lumit Mirusha Jugu 2, Inicimi për shpallje
- Rikonstruimi i rrugës Adem Jashari dhe Zija Shemsiu, Inicim për shpallje
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kravaric MOEA

V. Aktivitete tjera te DSHPIB

Me KRU “Hidromorava” kemi vazhduar bashkëpunimin për intervenime në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe shtrimin e rrjeteve të reja në disa lagje dhe fshatra si që është Bilinica dhe shtrimi i rrjetit të ri në të dy krahët e rrugës së Prishtinës.

Përgatitjen e te dhënave mbi qiranë të pronës komunale për lokale afariste. Kemi shpallë ankandin publik për dhanjen me qera të banesave dhe lokaleve pronë e Komunës, së shpejti do të përgatitim dhënen në shfrytëzim edhe të cityllajteve.

Me vendim të Kryetarit të Komunës është bërë falja e obligimeve të qirasë për shfrytëzuesit e hapësirave publike, qirasë së banesave dhe lokaleve pronë e komunës deri fund të këtij viti për shkak të pandemisë

Sfidat e Drejtorisë për vitin 2021

Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja vijave ujore dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre mbetet prioritet;

Ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet dhe fshatra duke përfshi edhe impiantin për trajtim të ujerave të zeza një projekt i cili është nënshkruar mes Komunës , qeverisë dhe BERZH

Ndërtimi i autoparkut - për vendosjen e makinave te aksidentuara dhe tjerat që tërhiqen për shkak te parkingut të gabuar, veprave penale,

Për realizimin e kërkesave të qytetarëve, ngritjen e shkallës së ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe realizimin e gjitha projekteve që ka planifikuar DSHPIB-ja kërkojmë që të bëhen rekrutime të stafit të ri për zëvendësimin e stafit të suspenduar, si dhe buxhet shtesë për këtë drejtori.

III. DREJTORIA PËR ARSIM

Aktivitete të Përgjithshme

- Më 17.01.2021, Drejtoria e Arsimit nga UNICEF në bashkëpunim me Ambasadën e Britanisë së Madhe ka pranuar donacion me materiale higjienike dhe dezinfektuese për të gjitha shkollat e Komunës së Gjilanit.
- Më 20.01.2021 me qëllim të parandalimit të dukurive negative dhe incidenteve të mundshme në shkollat e Gjilanit, është mbajtur takimi i përbashkët i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjilan dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, së bashku me drejtorët e SHML u pritën nga zëvendës drejtori, Nënkolonel Shaban Azizi dhe stafi i tij.
- Më 22.01.2021 Asociacioni i Komunave të Kosovës, mbajti takimin e radhës të Kolegjiut të Arsimit me qëllim diskutimin e temave aktuale në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë së Kolegjiut. Me këtë rast Ministri i Arsimit z. Ramë Likaj njoftoi të pranishmit lidhur me arritjen e marrëveshjes për Kontratën Kolektive në Arsim.
- Më 26.01.2021 pranuan një Tabelë të mençur për Shkollën e Muzikës, donacion nga KFOR-i Italian.
- Më 26.01.2021 nga UNICEF dhe përmes MASH-it, janë dhuruar Tabletë për nxënësit e Shkollave; “Agim Ramadani”, “Vatra e Diturisë”, “Liria”, “Sadullah Brestovci”, “Arbëria” dhe Shkolla e Muzikës, me qëllim të lehtësimit dhe përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në procesin edukativo-arsimor dhe duke ndihmuar qasjen e tyre në mësimin online.

□

- Më 20.02.2021 nën përkujdesjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit, është mbajtur Olimpiada Matematike e Gjilanit - OMGJ 2021, për nxënësit e klasave IX,X,XI dhe XI.
- Më 21.02.2021 Drejtoria Komunale e Arsimit-Gjilan, në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të Fizikës, u mbajt Gara Komunale e Fizikantëve të Rinj 2021, e cila u organizua në hapësirat e Gjimnazit Natyror "Xhavit Ahmeti".
 - Më 06.03.2021 është mbajtur festa e Ditës së Mësuesit.
 - Më 20.03.2021 u hap Kampionati Republikan i Basketbollit për Shkollat e Mesme, ku kanë marrë pjesë nxënësit e shtatë regjioneve të Republikës së Kosovës, i cili u mbajt në Palestrën e Sporteve "Bashkim Selishta"-Gjilan.
 - Më 21.03.2021 është mbajtur Gara Ndërkombëtare e Matematikës "Kangaroo", e cila organizohet në të njëjtën ditë në mbarë botën dhe marrin pjesë më shumë se 80 shtete të botës, e cila ka për qëllim, promovimin, nxitjen e identifikimin e talenteve si dhe për të avancuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën e matematikës.
 - Më 22.03.2021 kemi pranuar një donacion nga KFOR-i Amerikan dhe KFOR-i Turk, të cilët dhuruan tabelë të mençur, kompjuter dhe pajisje të tjera teknologjike për nxënësit e fshatit Ponesh, respektivisht në paralelen e ndarë të shkollës "Vesel Muji" dhe në shkollën "Sveti Sava"-Ponesh.
 - Më 25.03.2021 në Kuvendin Komunal të KK Gjilan, miratohet rregullorja për Kodin e Etikës në Institucionet Edukativo-Arsimore të Komunës së Gjilanit.
 - Më 02.04.2021 me rastin e Ditës Botërore të Autizmit, u mbajt aktiviteti nga nxënësit e SHFMU "Thimi Mitko", të cilët përformuan talentet e tyre përmes punimeve artistike të prezantuara në ambientin e kësaj shkolle.
 - Më 08.04.2021 Gjilani dhe Tirana nënshkruajnë marrëveshje binjakëzimi për shkollat e Arteve, në 75 vjetorin e themelimit të Liceut Artistik "Jordan Misja" në Tiranë, së bashku me drejtorin z. Shkëlqim Sirika.
 - Më 13.04.2021 u zhvillua vizitë në shkollën "Zija Shemsiu" nga z. Nazim Gagica dhe kryesuesja e kuvendit znj. Shpresa Kurteshi, të cilët nga afër pan zhvillimin e mësimi online nga mësimdhënësit e shkollës.
 - Më 21.04.2021 për t'u përkulur dhe për të nderuar lavdinë e lartësinë e Dëshmorit të Kombit, Ibrahim Uruqi, për nder të Ditës së SHFMU " Ibrahim Uruqi"-Bresalc, së bashku me familjarët e dëshmorit, Ibrahim Uruqi, stafin e DKA-së, mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës shënuam këtë ditë të veçantë.
 - Më 21.04.2021 mbështetur nga Qeveria Britanike, funksionalizua kabinetin e Informatikës në Shkollën e Mesme Ekonomike "Marin Barleti".
 - Më 22.04.2021 në Shkollën e Mesme të Agrobiznesit "Arbëria"-Gjilan, u inaugurua Inkubatori i Agrobiznesit-Rajoni-Lindje, i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me komunat e tjera nga Regjioni Lindor.
 - Më 29.04.2021 nxënësit e Gjimnazit Natyror " Xhavit Ahmeti", shkëlqyen në prezantimin e gjashtë projekteve shkollore në kuadër të programit "Mbështetje Adoleshentëve pas Mësimi të Rregullt"- ASSET.

□

- Më 30.04.2021 me qëllim të ruajtjes dhe kujdesit për mjedisin e shkollës si përgjegjësi e përbashkët, andaj, së bashku me zyrtarët e DKA-së, mësimdhënësit e shkollës së muzikës dhe këshillin e nxënësve, u mbollën lule në hapësirat e kampusit të shkollave të mesme.
Më 30.04.2021, si pjesë e debatit me nxënësit e Gjimnazit Natyror “Xhavit Ahmeti”, me temën: “Ndikimi i pandemisë në mësimdhënie dhe mësim nxënie”.
- Më 08.05.2021 nxënësit e Shkollës së Muzikës-Gjilan, marrin çmimet kryesore në garën Internacionale për Muzikë dhe Art.
- Më 11.05.2021 u mbajt debati me nxënësit e shkollës “Thimi Mitko” me temën: “Parandalimi i dukurive negative në shkolla”, ku pjesëmarrës në këtë debat ishin: Zyrtarë të DKA-së, Policia Kosovës, Menaxhmenti i shkollës dhe përfaqësues nga këshilli i prindërve të shkollës.
- Më 19.05.2021 Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi - Festivalin e Dramës me nxënësit e shkollave të mesme, në Teatrin e Qytetit të Gjilanit nga data 1 deri më 5 Qershor, në formë garuese.
- Më 24.05.2021 filloi Java e Psikologjisë në kuadër të Shkollave të Mesme, organizuar nga DKA në bashkëpunim me psikologet e shkollave.
- Më 25.05.2021 në takimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës-Kolegjiut për Arsim u diskutua për organizimin e Testit të Maturës bazuar në vendimin e MASH, nr.43-01/B i dt.25.05.2021 për shtyrjen dhe organizimin e provimit të Maturës Shtetërore.
- Më 25.05.2021 në hapësirat e kampusit të Shkollave të Mesme, në kuadër të Javës së Psikologjisë, u shfaqën dy filma edukativ për nxënësit e shkollave të mesme, prodhim i Doku-Fest “Shkolla dhe Filmi”, e që bartën mesazhe vetëdijesuese për parandalimin e dukurive negative.
- Më 26.05.2021 pjesëmarrje në debatin e organizuar me nxënësit Gjimnazit Shoqëror “Zenel Hajdini”, me temën: "Abuzimi dhe llojet e Abuzimit".
- Më 26.05.2021 nënshkruam Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare Italiane, Volontari nel Mondo RTM, në kuadër të projektit PEDAKOS i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë.
- Më 27.05.2021 së bashku me nxënësit me Nevoja të Veçanta vizituam shkollat profesionale të Gjilanit, për t’u informuar nga afër me profilet ekzistuese dhe potencialin që ofrojnë shkollat profesionale, në mënyrë që këta nxënës të mund të marrin vendime reale të karrierës dhe të bëjnë zgjedhje të drejtë për të ardhmen e tyre.
- Më 28.05.2021 përmbyllet me sukses Testi i Arritshmërisë i organizuar për 1300 nxënës të klasave të nënta të Komunës së Gjilanit.
- Më 28.05.2021 në ceremoninë e mbylljes së manifestimit “Java e Psikologjisë”, u ndanë mirënjohje falënderimi për të gjithë ata të cilët kontribuan në realizimin e aktiviteteve të shumta, në kuadër të këtij manifestimi.

□

- Më 29.05.2021, u zhvillua vizitë në shkollën “Abaz Ajeti”, ku është mbajtur mësimi plotësues për orët e humbura si pasojë e pandemisë, si një mundësi për plotësimin e mësimi dhe përmirësimin e rezultateve të nxënësve.
- Më 31.05.2021, u zhvillua festivali i Teatrit të Shkollave të Mesme. Në natën e parë të festivalit. Festivali ka karakter garues dhe pjesë e garës ishin shkollat e mesme të Komunës së Gjilanit.
- Më 01.06.2021, u bë shënimi i festës së “1 Qershorit”, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, në Institucionin Parashkollor “Integj”.
- Më 03.06.2021, Shkolla e Muzikës me një aktivitet ndryshe dhe të veçantë në Kampusin e Shkollave të Mesme-Karaoke.

Më 04.06.2021, u dhanë mirënjohje nga Drejtoria e Arsimit, z. Nazim Gagica për ekipen vlerësuese komunale lidhur me kontributin, angazhimin dhe përkushtimin për vlerësimin e vazhdueshëm të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e komunës së Gjilanit.

- Më 07.06.2021, u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve “Një zë i fortë”, fituese e Festivalit të Teatrit të shkollave të mesme.
- Më 08.06.2021, u vlerësua se janë shënuar rënie të dukurive negative-ku u vlerësua siguria në shkollat e Gjilanit. Me Komandantin e Stacionit Policor të Gjilanit z. Alban Ramushi, zv. drejtorin i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Gjilan, z. Shaban Azizi, zëdhënësin e Policisë së Kosovës në Drejtorinë Rajonale, z. Ismet Hashani dhe znj. Sahadete Sadiku nga njësi Policia në Komunitet, zhvilluam një takim të përbashkët me drejtoret e shkollave të Komunës së Gjilanit.
- Më 09.06.2021, u zhvillua ceremonia e nxënësve të shkollave të mesme-Diplomimi i maturantëve.
- Më 11.06.2021 së bashku me zv.Shefen e UNICEF zjn.Larissa Bruun dhe drejtorin e Kosova Education Center - KEC z. Petrit Tahiri, vizituam Gjimnazin “ Zenel Hajdini”, me ç’rast shpërndamë laptop për pesë shkollat përfituese të Komunës së Gjilanit, në kuadër të programit “Fuqizimi i të rinjve për një të ardhme paqësore, prosperuese dhe të qëndrueshme në Kosovë”.
- Më 17.06.2021, edhe një mbështetje nga Qeveria e Luksemburgut për shkollat profesionale. Në ambientet e MASH, nënshkruam marrëveshjen me “Meister Training Center”, në kuadër të projektit KSV/020, e cila bazohet në modernizimin e sistemit formal të arsimit nëpërmjet reformës së sektorit të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional(AAP), krijimit dhe avancimit të institucioneve të AAP-së, si dhe zhvillimit të këtyre institucioneve.
- Më 17.06.2021 në Kampusin e Shkollave të Mesme, është mbajtur aktiviteti “ Ditët e Informimit për Cilësinë e Ajrit”, në bashkëpunim me e Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës dhe Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe i mbështetur nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) përmes Fondacionit të Mijëvjeçarit të Kosovës (MFK) dhe zbatuar nga Konzorciumi NIRAS.

□

- Më 18.06.2021 nxënësit, mësimdhënësit, drejtorët, Policinë në Komunitet dhe stafin teknik të të gjitha shkollave të Komunës të Gjilanit i'u bashkuan aksionit të përbashkët për pastrimin dhe gjelbërimin e hapësirave brenda dhe jashtë zonave të Qytetit.
 - Më 19.06.2021 në kuadër të shkollave Kampione të Kosovës, në shkollën "Thimi Mitko" u organizua Konferenca e pare me temën: "Menaxhimi i procesit mësimor gjate"periudhës se"Pandemisë COVID-19".
 - Më 20.06.2021 u mbajtën garat komunale në not për shkollat e Mesme të Ulëta të Komunës së Gjilanit. Të mbështetura nga Drejtoria Komunale e Arsimit, ky aktivitet u realizua nga Shoqata e Sportit Shkollor.
 - Më 21.06.2021 më bashkëpunimin si rrjedhë e binjakëzimit me Liceun Artistik prestigjioz të Tiranës "Jordan Misja", të cilët na nderuan me vizitën e tyre si dhe një koncert madhështor në Ditën Ndërkombëtare të Muzikës, nga talentet e spikatur, duke filluar kështu rrugën e bashkëpunimit në fushën e artit dhe kulturës.
 - Më 23.06.2021 Z.Nazim Gagica pranoi mirënjohje nga Ministria e Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, për suksesin e nxënësve tanë të arritur në garat e shkencave natyrore.
- Më 29.06.2021, pranuar konfirmimin nga Zyra për Bashkëpunim në Mbrojtje në Ambasadën Amerikane, që projekti për renovimin e SHFMU "Ibrahim Uruqi" në Bresalc është miratuar nga Komanda Evropiane e Ushtrisë Amerikane, Programi për Ndihmë Humanitare (U.S European Command, Humanitarian Assistance Program). Ky projekt do të implementohet nga Komanda e Marinës për Sisteme Inxhinierike (KMSI) (Naval Facilities Engineering Systems Command).

Arsimi gjithëpërfshirës :

- Përkundër sfidave të mëdha që ka paraqitur përhapja e pandemisë COVID-19, me përkushtim të madh kemi arritur t'i realizojmë aktivitetet e shumta, të parapara sipas planit të veprimit në funksion të procesit arsimor në Nivelin e Arsimit Gjithëpërfshirës.
- Hartimi i planit individual vjetor të punës në fillim të vitit kalendarik.
- Hartimi i planit të veprimit për Ekipin Vlerësues Pedagogjik për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Hartimi i planit dinamik të punës së ekipit vlerësues pedagogjik.
- Gjatë këtij gjashtëmujori, sipas planit të punës janë vlerësuar dhe rivlerësuar nga ekipi vlerësues pedagogjik (EVP) 24 fëmijë me nevoja të veçanta.
- Zhvillimi i projekteve dhe partneriteteve për ngritje të vetëdijes rreth Arsimit gjithëpërfshirës, dhe rritjen e përfshirjes së numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin edukativo-arsimor.
- Zbatimi i programeve për trajnime në arsimin gjithëpërfshirës, trajnime online të ndihmuar e mbështetur nga partnerët e DKA-së.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me MASH-in dhe organizata të ndryshme partnere të DKAsë dhe komunës së Gjilanit.

□

- Në kuadër të platformës së krijuar në projektin “Edukimi për të gjithë” mbështetur nga EU dhe implementuar nga PIN (People in Need) dhe “Autizmi Flet” & “TIP” kemi zhvilluar dy takime të përbashkëta.
 - Janë realizuar trajnime të zhvillimit profesional për edukatorët mbështetës, mësimdhënësit mbështetës përmes platformave virtuale nga: organizatat vendore dhe ndërkombëtare.
 - Në këtë vit shkollor, për herë të parë në Komunën e Gjilanit, në bashkëpunim me Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, financuar nga UNICEF, janë angazhuar 6 asistentë, për 4 muaj, por duke i parë rezultatet e mira DKA-ja pas skadimit të kontratës, e ka marrë përsipër pagesën e tyre për muajt e mbetur. Gjithashtu janë angazhuar edhe 2 asistentë më shumë, sepse kërkesat për shtimin e asistentëve janë çdoherë në rritje.
 - Me iniciativën tonë dhe shkresën përcjellëse që kemi dërguar në shkolla, nga ky vit shkollor edukatorët mbështetës, mësimdhënësit mbështetës, dhe asistentët dërgojnë raporte 3 mujore të punës në DKA.
 - Takime të rregullta me stafin e DKA-së.
 - Takime të rregullta me drejtorët e shkollave.
 - Takime të rregullta në MASH rreth raportimit të FNV si dhe gjendjes së tyre.
 - Takime të ndryshme me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Shënimi i ditës së fëmijëve 1 Qershorit – ditës ndërkombëtare në SHFMU “Selami Hallaqi”, si dhe gjithë përfshirja e Fëmijëve me nevoja të veçanta në program.
- Me iniciativën tonë kemi vizituar shkollat profesionale të komunës sonë, duke i parë për së afërmi me profilet ekzistuese dhe potencialet të cilat i ofrojnë këto shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta.
 - Në bashkëpunim me Psikologjen e SHML “Dr. Asllan Elezi”, dhe FNV, kemi ngjyrosur një mural me temën “Të gjithë të barabartë”.
 - Planifikimi për realizimin e testit të klasave të nënta, dhe maturës shtetërore për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe caktimi i asistentëve për ditën e testimit.
 - Shqyrtimi i ankesave/kërkesave të ndryshme.
 - Takim me edukatorët mbështetës dhe mësimdhënësit mbështetës.
 - Organizimi, planifikimi për regjistrimin e nxënësve në parashkollor, klasën e parë si dhe klasën e dhjetë të fëmijëve me nevoja të veçanta.
 - Në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës në kuadër të projektit UEFAFFK- GRASSROOTS, kemi organizuar dy herë në muaj aktivitete sportive me FNV, të komunës sonë, duke i ofruar një përfshirje, integrime në lojë, socializmi, aktivitete fizike etj.

Niveli i Arsimit Parashkollor :

□

Përkundër sfidave të mëdha që ka paraqitur përhapja e pandemisë COVID-19, Drejtoria e Arsimit, me përkushtim të madh ka arritur t'i realizojë aktivitetet e shumta, të parapara sipas planit të veprimit në funksion të procesit arsimor në Nivelin e Arsimit Parashkollor.

- Trajnimet e realizuara për zhvillimin profesional të edukatoreve, të mbështetur nga DKA dhe partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, në fushën e zhvillimit të fëmijërisë së hershme:

Sindikate e Bashkuar e Arsimit:

- Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik
- Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social
- Menaxhimi i institucioneve edukativo arsimore

Organizata: aksioni për nënat dhe fëmijët AMC në bashkëpunim me Institutin kombëtar të shëndetësisë dhe MASHTI-në:

- Planifikimi ushqimor dhe ushqyeshmeria e drejtë tek fëmijët e moshave 6 muaj deri 6 vjeç:

MASH, qendra për shëndetësi humane dhe zhvillim, Unicef:

- Trajnim "Edukimi në distancë", Paketa mbi zhvillimin e hershëm të fëmijës (ECD) Ligjëratë për Prindër dhe Edukatore nga Qendra e Mjekësisë Familjare:
- Variçela-simptomatologjia (format e para të paraqitjes)

□ **Përpunimi i databazës, të plotësuar për klasat para fillore moshë 5-6 vite, nga ShFMU dhe IP:**

- Databaza është iniciuar dhe e sponsorizuar nga organizata Caritasi Zviceran, e cila ka për qëllim mbledhjen e të dhënave nga klasat parashkollore, këto të dhëna fillimisht do të analizohen nga DKA në partneritet me Institutin Pedagogjik dhe do t'i shërbejnë për identifikimin e nevojave dhe përpilimin e raportit të cilësisë në nivel të Komunës dhe në nivel vendi, krahas tij do të hartohet edhe një udhëzues për ngritjen e mëtejme të cilësisë. Marr parasysh punën e përditshme që bëjmë për ngritjen e cilësisë, kjo databazë, do t'iu shërbejë të gjithë akterëve të përfshirë në arsimin parashkollor. (Raporti përfundimtar do të jetë i gatshëm me datë: 30.07.2021).

□ Vizitat në Institucione Parashkollore dhe Shkolla.

1. Vizita, monitorimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së procesit edukativo-arsimor, si dhe për fuqizimin, menaxhimin efikas dhe cilësor të institucioneve parashkollore, rrjedhimisht përfshirë gjithë nivelin e arsimit parashkollor;
2. Respektimi i masave anti -covid 19, Meny-ja, vijueshmëria e personelit dhe e fëmijëve;
3. Siguria e fëmijëve.
4. Adresimi i çështjeve për ngritje të cilësisë së shërbimeve sipas specifikave të institucioneve parashkollore, qendrave me bazë në komunitet dhe klasave përgatitore.
5. Higjiena;
6. Shpërndarja e pakove higjienike nga organizata ndërkombëtare RTM dhe Save the Children për pesë IP.
7. Shpërndarja e pakove didaktike, në IP mbështetur nga organizata Save the Children.

□ Infrastruktura e Institucioneve Parashkollore:

1. Monitorimi i vazhdueshëm i punimeve në objektin e çerdhes e cila aktualisht është në fazën finale të përfundimit të punimeve, fshati Zhegër.
2. Hartimi i kërkesës drejtuar në MASh, për zbatimin e marrëveshjes nga MAShTI dhe Komuna e Gjilanit për projektin “Renovimi dhe funksionalizimi i objekteve ekzistuese në çerdhe për fëmijë më qëndrim ditor” në Komunën e Gjilanit, fshati Zhegër.
3. Vizita, takime pune dhe monitorimi i punimeve sipas fazave të projektit ndërtimi i objektit të çerdhes me drejtorin z. Gagica.
4. Komunikim dhe harmonizim të vazhdueshëm me menaxherin për mbikëqyrjen e projektit, z. Rahman Agushi.
5. Hartimi i specifikacionit për inventarizimin e çerdhes.
6. Takimi në MASh me shefin e infrastrukturës dhe drejtorin z.Gagica, ku u diskutua rreth procedurave të procedimit të mjeteve financiare ndaj operatorit për objektin e çerdhes.
7. Takimi online dhe hartimi i kërkesës adresuar për organizatën vendore, Qendra Humane për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme për mbështetjen në furnizim me mjete didaktike dhe demonstruese, për çerdhen e re në fshatin Zhegër.

8. Angazhime përmes hartimit dhe procedimit të kërkesave, drejtuar Drejtorisë Komunale për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe kabinetit të Kryetarit z.Haziri, për definimin e pronave të cilat kanë destinim për ndërtimin e çerdhes dhe një shkolle fillore sipas planit rregullues urban, në lagjen “ Livadhet e Arapit”.
9. Investime në IP “ Integj, furnizuar me tepison në të gjitha dhomat e punës së fëmijëve.
10. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me organizatën botërore UNICEF për iniciativën dhe kërkesën e DKA-së në mbështetjen e hapjes së edhe një Qendre me Bazë në Komunitet për fëmijët e moshës nën moshën 4 vjeç në zonat rurale të komunës sonë.
11. Gjatë muajit qershor '21 janë bërë matjet e hapësirave të brendshme të dy Institucioneve Parashkollore të cilat do të jenë përfituese me investime në vlerë nga 8000 Euro me inventarë dhe materiale didaktike sipas qasjes - Regio Milo nga organizata PEDAKOS.

□ Nënshkrimi i Marrëveshjes Bashkëpunimi:

1. Me organizatën, Pedakos Projekti: “Preschool Education Development Alliance for Kosovo AID 0011860” projektit PEDAKOS i financuar nga Ministria e Punëve të jashtme të Italisë.

□ Takimet dhe vizitat:

1. Takime me zyrtarët e MASH-it, Institucione komunale, donatorë, organizata vendore e ndërkombëtare.
2. Takime pune me organizatën PEDAKOS, (vizita të përbashkëta në dy Institucione Parashkollore).
3. Takim pune me koordinatorët e Institutit Pedagogjik.
4. Takim pune me Dr. Tanushe Kallaba, Specialiste e Ekologjisë Humane IRSHP-Gjilan

□ Angazhimet në bazë ditore dhe javore:

1. Duke pasur parasysh nevojën e vazhdueshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së popullatës, IKSHPK bën kontrollin e zbatimit të standardeve minimale sanitarohigjienike dhe përcaktimin e ndotësve bakteriologjikë në institucionet parashkollore, andaj DKA analizon me kujdes të shtuar rezultatet e strishove dhe rekomandimet e Institutit Regjional të Shëndetit Publik të adresuara për IP.
2. Grumbullimi dhe përpunimi i raporteve në baza ditore të raportit, covid -19.
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe informatave të shumta përmes adresës elektronike nga Institucionet Arsimore, Organizatat vendore, ndërkombëtare, media si dhe akterë të tjerë.
4. Përpunimi i kërkesave për ditarë.
5. Analiza e raporteve javore dhe mujore nga IP.
6. Analiza e raporteve nga Task- Forcat në kuadër të IA.
7. Takime të rregullta me udhëheqësin e institucioneve arsimore, nivelit parashkollor në kuadër të IP dhe ShFMU.
8. Takime Konsultative dhe koordinimi i detyrave dhe përgjegjësi me drejtuesit e IP.

9. Takime permanente me palë.
10. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave me shkrim.
11. Pjesëmarrje në evente të ndryshme të organizuara nga IP dhe shkollat respektive me drejtorin z.Gagica .
12. Angazhime në plotësimin e raportit për matjen e performancës në nivel të Komunës .
13. Përkushtimi në angazhimin e zëvendësimeve të personelit arsimor dhe teknik në IP dhe edukatoreve në kuadër të SHFMU .
14. Hartimi i Raporteve dhe informative për konsum të DKA-së.

□ Pjesëmarrje në punëtori , trajnime online dhe komisione:

1. Trajnimin për përdorimin e platformës digjitale, Microsoft Teams për mësimdhënie nga MASH.
2. Punëtori konsultative me koordinatorin e organizatës PEDAKOS.
3. Punëtori me koordinatoren e Organizatës QHZHFH.
4. Punëtori me Organizatën PEDAKOS, inventarizimi i dy IP-ve pilotë në komunën tonë.
5. Hartimi i Rekomandimeve, për strategjinë e organizatës ndërkombëtare, Save the Children për periudhën 2022-2024.
6. Hartimi i rekomandimeve për rregulloren e Kodit të Etikës për Institucionet Edukativo Arsimore në Komunën e Gjilanit.
7. Angazhime në komisionin e DKA-së për Vlerësimin e Performancës së Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve të Institucioneve Publike Arsimore Parauniversitare.

Shpallja Konkursit për regjistrimin e fëmijëve të klasave përgatitore në kuadër të shkollave për moshën 5-6 vjeç dhe Shpallja e konkursit për pranimin e fëmijëve të moshës 9 muaj - 5 vjet në kuadër të pesë Institucioneve Parashkollore Publike.

Niveli Fillor i Mesëm i Ulët (1-9).

- Planifikimi dhe realizimi i Testit të Arritshmërisë.
- Planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në klasat e I-ra.
- Organizimi i trajnimit për kurrikul dhe trajnime të tjera për mësimdhënës.
- Planifikimi i ditarëve për nxënës për vitin shkollor 2021-22.
- Kërkesa për furnizim në MASHT, për tekste shkollore për nxënësit e Shkollave Filllore të Mesme të Ulëta për vitin shkollor 2021-22.
- Grumbullimi i orëve dhe normave mësimore për vitin shkollor 2021-22.
- Hapja e konkursit dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit për pozitë: psikolog, pedagog dhe asistent për FNV.
- Monitorimi i suksesit të nxënësve në përfundim të gjysmë vjetorit të dytë dhe futja e shënimeve në SMIA.
- Vizita për planifikimin e terreneve sportive në bashkëpunim me zyrën e projekteve, vizitë 10 shkollave.
- Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të ndryshme.
- Vlerësimi i performancës së drejtorëve dhe zv- drejtorëve.

- Organizimi dhe mbajtja e testit ndërkombëtar – PIRLS- me disa klasa të katërta të përzgjedhura nga MASHTI.
- Kompletimi i Kodit të Etikës pas hartimit nga komisioni komunal.

Niveli i Mesëm i Lartë (10-12)

Takimet me drejtorë të SHML:

- Bashkëpunimi dhe komunikimi i rregullt me drejtorë të shkollave, me qëllim të realizimit të gjitha objektivave sipas planit të veprimit dhe aktiviteteve tjera të paplanifikuara.

Planifikimi për vendet e lira dhe përgatitja e konkursit për SHML:

- Planifikimi i vendeve të lira dhe përgatitja e konkursit për personelin profesional. □ **Puna me komisionin për rekrutim të personelit profesional**
- **Puna me komisionin e vlerësimit të performancës së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve**
- Vlerësimi i performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Institucioneve Publike Arsimore Parauniversitar, me ç'rast kemi bërë vlerësimin e katër drejtorëve dhe një zëvendës drejtoresh siç janë: z. Sami Hoxha, drejtor i Gjimnazit “Zenel Hajdini”, z. Kushtrim Jakupi, drejtor i Shkollës së Muzikës, z. Ruhan Zymberi, drejtor i SHFMU “Sadulla Brestovci”, znj. Merita Zejnullahu, drejtoresh e IP “Ardhmëria II” si dhe znj. Zyrije Shala, zëvendës drejtoresh e SHFMU “Thimi Mitko”.

Takim pune për sugjerime në Draft Rregulloren për Kodin e Etikës në Institucionet Edukativo-Arsimore:

- Me datë: 25.02.2021, në objektin e DKA-së u mbajt takimi për sugjerimet në Draft Rregulloren për Kodin e Etikës në Institucionet Edukativo-Arsimore.

Përgatitjet rreth organizimit për pilotimin e testit PISA -2022:

- Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me DVSM dhe drejtorët e shkollave, ka realizuar me sukses Pilotimin e Testit PISA 2022.
- Pilotimi i testit PISA në Komunën e Gjilanit është realizuar në shkollat: Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti”, SHMLM “Dr. Asllan Elezi” si dhe SHMLE “Mehmet Isai”. Testit i ‘u nënshtruan gjithsej 168 nxënës të klasës së dhjetë, nga 56 nxënës nga secila shkollë.

Pilotimi i testi PISA-a u realizua në datat si në vijim:

Në SHMLE “Mehmet Isai” me datë: 05.05.21, Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” me datë: 06.05.21 si dhe në SHMLM “Dr. Asllan Elezi” me datë: 07.05.21.

- Pilotimi i testit është realizuar edhe me datë: 11.05.2021 për nxënësit të cilët munguan ditën e mbajtjes së testit.

Pjesëmarrje në takimin e Mekanizmit Referues:

- Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me IOM, ka organizuar takim me Mekanizmin Referues dhe KVRL lidhur me riintegrimin e personave të kthyer nga zonat e luftës.

Organizmi i trajnimit të MR dhe OJQ-LIZA:

- Mekanizmi Referues i Gjilanit në bashkëpunim me OJQ "Liza", ka mbajtur trajnim me 20 kujdestarët e klasave dhe 20 kryetarët e shkollave të mesme të larta, përfshirë edhe këshillin e nxënësve të Gjilanit. Trajnimi u mbajt më 26 dhe 27 mars 2021, me fillim në orën 10:00, në Shkollën e "Selami Hallaqi".

Temat e ligjëratave:

1. Mekanizmi Referues
2. Ekstremizmi i hershëm radikal dhe terrorizmi
3. Ndikimi i bullizmit në ekstremizëm

Ligjërues: Dr.sc Mensur Morina dhe Toger- Muhamet Hyseni

Koordinimi me MASH rreth organizimit të trajnimit të psikologëve:

- Me kërkesë të MASH me datat 16, 18, 19 dhe 30 mars dhe 01 prill 2021 është organizuar trajnimi me psikologë të shkollave të cilat kanë nxënës të kthyer nga zonat e luftës në lindjen e mesme. Nga Komuna e Gjilanit, trajnimin e ka ndjekur psikologjia Festa Demiri.

Organizimi i debatit me nxënësit e SHMLT "Mehmet Isai":

- Në bashkëpunim me psikologun e DKA-se, u organizua debati me nxënësit e SHMLT "Mehmet Isai" me temë: "Droga dhe pasojat e përdorimit të saj".
- Në këtë takim të ftuar ishin edhe Policia e Komunitetit.

Vaksinimi i nxënësve të klasave të XII-ta:

- Me kërkesë të QKMF nga datë: 19.01.2021, ka filluar vaksinimi i nxënësve të klasave të XII-ta. Vaksina është kundër helmimit të gjakut dhe gripit sezonal.

Përzgjedhja e mësimdhënësit më të mirë për çmimin "Shaban Jashari":

- DKA ka bërë grumbullimin dhe seleksionimin e dosjeve të mësimdhënëseve të të gjitha niveleve nga IEA -të për zgjedhjen e mësimdhënësit garues për çmimin "Shaban Jashari".
- Mësimdhënësi më i dalluar në Komunën tonë i nominuar për çmimin tradicional „Shaban Jashari”, për nderë të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit është përzgjedhur Ganimete Sylejmani, mësimdhënëse në SHFMU "Selami Hallaqi."

Aktivitetet në planifikim e sipër

Planifikimi i paraleleve dhe profileve për SHML për vitin shkollor 2021-2022:

- Me qëllim të një planifikimi sa më të mirë, DKA në bashkëpunim me drejtorët e shkollave, ka mbajtur disa takime për planifikimin e paraleleve/ profileve, për vitin shkollor 2021-2022.
- Drejtorët e shkollave në bashkëpunim me aktivet profesionale kanë propozuar profilet, ndërsa paralelet janë planifikuar nga DKA, bazuar në numrin e nxënësve në klasën e 9.
- Ky planifikim është dorëzuar në MASH për aprovim.

Planifikimi dhe realizimi i Testit të Maturës Shtetërore:

- Provimi i Maturës Shtetërore u realizua me datë: 26.06.2021 në 9 Qendra të testimit. Nga 1535 maturant testit iu nënshtruan 1501 ndërsa 34 maturantë munguan. Testi u administrua nga 131 administruues nga Komuna e Vitisë dhe Kamenicës, 27 komisioner nga MASH, SHKOLLA dhe DKA si dhe 18 monitorues Universiteti “Kadri Zeka”. Numri i maturantëve të larguar nga testi është 11 (9 të shkollave publike, 3 Kolegjit “Don Bosko” si dhe 1 shkollës së Medresesë.

Realizimi i aktivitetit:

Shpallja e Konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e X:

- Në bazë të kërkesës së MASH me datë: 28.06.2021 është shpallur Konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e X.
- Edhe përkundër planifikimit të DKA-së sa i përket Konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e X, me kërkesë të MASH, konkursi është shpallur me planifikimin e profileve dhe paraleleve për vitin 2019-2021 (vitit të kaluar), si dhe SHMLM “Dr.Asllan Elezi” i janë lejuar vetëm 7 paralele nga 8 sa janë planifikuar.

Puna me palë:

- Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të palëve (mësimdhënës, nxënës, prindër).

Koordinatori i Cilësisë

1. Sigurimi i procesit të cilësisë në shkollë:

- 1.1 Siç e kemi thënë edhe me herët se sigurimi i cilësisë në shkollë është proces dhe përfshin thuajse të gjitha hallkat në arsim. Po ashtu, sigurimi i cilësisë paraqet një sistem gjithëpërfshirës në nën sektorin e arsimit parauniversitar që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rezultateve arsimore. Drejt arritjes së kësaj, ne jemi angazhuar në vazhdimësi dhe me përkushtim të lartë.
- 1.2 Viti shkollor 2020/21 ka qenë ndër më të vështirët dhe aspak i zakonshëm për të gjithë akterët e përfshirë në procesin edukativo-arsimor, edhe fusha jonë e cila thuajse e shtrirë në të gjitha shkollat e komunës sonë sipas anës ligjore që ishte viti i dytë e kishte tejet të vështirë të kishim rezultate të planifikuara apo që kemi synuar t’i arrijmë. Megjithatë ne jemi munduar dhe kemi bërë përpjekjet tona të vazhdueshme të kontribuojmë në sigurimin e cilësisë sipas mundësive dhe kapaciteteve tona që kemi pasur në dispozicion nëpërmjet KC në shkollë.
- 1.3 Gjatë kësaj periudhe jemi kujdesur që KC në shkollë të jenë në krye të detyrës dhe sidomos për këtë vit shkollor kemi kërkuar të jenë në gjendje gatishmërie në kryerjen e detyrave të caktuara nga drejtori i shkollës e deri te anët edhe më teknike organizative të nevojshme.
- 1.4 Me përfundimin e vitit shkollor 2020/21 kemi kërkuar nga ta të përgatisim raportin vjetor të punë dhe gjendjes së përgjithshme në shkollë, ku për këtë vit kemi kërkuar një raport shtesë me kërkesa të veçanta nëpërmjet të cilave ne do kompletojmë

raportin vjetor të gjendjes në shkolla. Deri më 15.07.2021 kanë afat ta dorëzojnë këtë raport.

2. Koordinimi i detyrave të Koordinatorëve të Cilësisë në Shkolla:

- 2.1 Gjatë këtij viti shkollor kemi inkurajuar bashkëpunimin dhe koordinimin e disa punëve dhe angazhimeve të KC në shkolla. Gjatë këtij viti kemi pasur të angazhuar një koordinator të ri në Sh.F.M.U."Nazmi Hoxha" e cila si shkollë ka pasur mungesë dhe në bashkëpunim me drejtorin e shkollës, nga ky vit edhe kjo shkollë është e mbuluar.
- 2.2 Në dy shkolla të tjera kemi pasur ndryshime të KC, në: Sh.F.M.U."Vatra e Diturisë" dhe Sh.F.M.U."Liria". Këto ndryshime janë bërë brenda kompetencave dhe përgjegjësi të drejtorëve të shkollave.
- 2.3 Kam inkurajuar bashkëpunim mes KC rreth organizimit të punëve të tyre sidomos me Aktivet Profesionale, ku në të kaluarën nuk kanë qenë funksionale. Në këtë drejtim vazhdojmë të insistojmë se ka nevojë të bëhet më tepër vitet në vazhdim.

3. Bashkëpunimi me MASHT dhe komunat:

- 3.1 Bashkëpunimi me MASHTI-n është i kënaqshëm por jo në nivelin e duhur. Sipas detyrave dhe përgjegjësi kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjitha nivelet në MASHTI sipas adresimeve që marrim. Por, mangësi vazhdon të mbetet vet mungesa e Koordinatorit të Cilësisë në MASHTI.
- 3.2 Si në takim me U.D së KC në MASHTI e në çdo takim me përfaqësuesit e tyre kam ngritur çështjen e KC nëpër shkolla të cilët kanë nevojë për mbështetje profesionale, duke u nisur nga trajnimet, përforsimi i pozicionit të tyre në detyra etj.

4. Analiza përmbledhëse të të gjeturave:

- 4.1 Në fushën tonë, të ngritjes së cilësisë paka shumë mbeten vështirësitë e njëjta si ato të vitit të kaluar, ku KC kanë nevojë për mbështetje dhe ngritje profesionale më të avancuar qoftë në pozicionin e trajnimeve bazike që mbeten po të njëjta: trajnimi për KC, trajnimi për vlerësimin e brendshëm të shkollës (VBSh), MKLSh etj.
- 4.2 Aktivet Profesionale në Shkolla, përkundër përpjekjeve tona në funksionimin e tyre ndoshta ende nuk është bërë mjaftueshëm në këtë drejtim dhe si shqetësim i yni mendojmë ta trajtojmë edhe në vitin pasues shkollor. Në këtë drejtim duhet të angazhohen më tepër vet drejtorët e shkollave sepse përveç tjerash është obligim ligjor që kanë ata si drejtues shkolle.
- 4.3 Planet e punës dhe përgatitjet me shkrim, mbetën gjithashtu njëri ndër fokuset tona edhe për vitin e ardhshëm shkollor, në këtë pikë sipas detyrave dhe përgjegjësi KC vetëm informohet rreth planeve, por nuk i kontrollojnë, andaj ne mendojmë ta forcojmë një lidhje mes drejtorit të shkollës dhe KC në këtë pikë, e ne veçanti në ato shkolla ku nuk ka zëvendës drejtor shkolle.
- 4.4 Tekstet shkollore mbeten njëra ndër kritikën apo vërejtjet e vazhdueshme nga shkollat, si nga drejtorët e shkollave, KC, apo edhe nga Aktivet Profesionale deri tek vet mësimdhënësit. Pavarësisht se kjo nuk është nën kompetencën tonë si DKA

gjithsesi ne këto vërejtje i kemi adresuar në MASHTI dhe shpresojmë të mos përsëriten prapë.

Psikologu i Shkollave

Takimet me drejtorë të IEA-ve, Psikologë, Pedagogë, etj:

- Bashkëpunimi dhe komunikimi i rregullt me drejtor të shkollave, psikologet e shkollave, policinë e komunitetit, OJQ etj, me qëllim të realizimit të aktiviteteve dhe planit të veprimit të planifikuara për IEA.

Organizimi i Debatit me nxënësit e SHML' Mehmet Isai':

- Në bashkëpunim me psikologun e SHML 'Mehmet Isai' është organizuar debati me temë: "Përdorimi i Narkotikëve dhe Pasojat e saj tek Adoleshentët". Në këtë debat kanë qenë prezent: drejtori DKA-së, Policia e Komunitetit dhe Menaxhmenti i Shkollës.

Koordimi me MASHTI-in për Organizimin e trajnimit të Psikologeve:

- Me kërkesë nga MASHTI-in dhe në bashkëpunim me zyrtaren për SHML, është organizuar trajnimi për psikologët e shkollave të cilët kanë nxënës të kthyer nga zonat e luftës në lindjen e mesme.

Trajtimi i rasteve të ndryshme të IEA-ve:

- Trajtimi i rasteve të ndryshme në bazë të kërkesave të drejtorëve, mësimdhënësve, policisë së komunitetit, po ashtu edhe trajtimi i rasteve të ndryshme nga Këshilli Sprovues i Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera të vendit.

Takime me Këshillin e Nxënësve:

- Takime të rregullta me Këshillin e Nxënësve, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndryshme edukativo-arsimore.

Organizimi i Javës së Psikologjisë:

- Në bashkëpunim me psikologet e Shkollave u organizua 'Java e Psikologjisë' në kuadër të Shkollave të Mesme.

Financa, Furnizim, Kontabilitet dhe Infrastrukturë

Paga	5, 667, 371. 23 Euro
Shërbime dhe mallra	616, 466. 09 Euro
Komunali	55, 222. 11 Euro
Subvencione	3, 354. 15 Euro
Kapitale	165, 221. 59 Euro
Totali	6, 507, 635. 17 Euro

Aktivitet e përgjithshme gjashtëmujore, 2021

- Për shkak të pandemisë nuk janë realizuar të hyrat sipas planifikimit.
- Kemi proceduar njëzetën (21) aktivitete në prokurim.

- Kemi regjistruar 690 lëndë.
- Kemi kryer me shkollat dhe DKA, si dhe specifikacione të alokimit të mjeteve nga nivelet në shkolla.
- Bashkëpunimi me Auditorin e brendshëm dhe Gjeneral.
- Realizimi i kërkesave për DKA dhe IEA – 56 kërkesa.
- Pranimi i faturave dhe regjistrimin e sistemin E-Financa – 134.
- Përgatitja e projektbuxhetit për vitin 2022.
- Përgatitja e raporteve të hyrave për 2021.
- Aprovimi i kërkesave të shkollave lidhur me furnizimin me materiale dhe shërbime të ndryshme.
- Bashkëpunimi me përfaqësuesit e IEA-ve.
- Bashkëpunimi me ATK-në.
- Bashkëpunimi me Auditorin Gjeneral.
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Financave.
- Përgatitja e dokumentacioneve lidhur me furnizimin e IEA-ve dhe DKA-së me materiale dhe shërbime të ndryshme dhe dërgimi tek zyra e Prokurimit.
- Përgatitja e formulareve lidhur me shpenzimin e buxhetit të IEA-ve.
- Përpunimi i statistikave lidhur me pagën jubilarë, me pagën e punëtorëve të sëmundjeve kronike, statistika për shujtën e nxënësve nga klasa I-IX si dhe statistika për buxhetin e shkollave profesionale.
- Përpunimi i statistikave nga lista e pagave të IEA me qëllim të konstatimit të gjendjes së numrit të mësimdhënësve, stafit administrativ dhe teknik si dhe shpenzimet buxhetore për periudhën gjashtë mujore.
- Pjesëmarrja në komisionet eventuale për vlerësim të tenderëve për furnizim të IEA-ve me shërbime, materiale të ndryshme ose paisje teknike.
- Pranimi i formulareve për të hyra vetanake të gjeneruara në IP dhe shkollat e mesme profesionale.
- Porosia, pranimi dhe verifikimi i materialit nga firmat furnizuese.
- Pranimi i faturave nga operatorët e ndryshëm si dhe verifikimi i tyre.
- Pranimi i lëndëve të kryera nga IEA-të dhe regjistrimi i lëndëve të kryera në programin e kontabilitetit.
- Regjistrimi i fakturave në sistemin E-finance në programin e Komunës □ Menaxhimi i kontabilitetit për DKA dhe IEA-të.
- Organizimi i shërbimit për transportin e nxënësve me nevoja të veçanta.
- Realizimi i rrjedhes së parasë në të gjitha IEA-të me propozimin e tyre.

Sektori i Personelit

1. Përpilimin e Akteve dhe shkresave për DKA-në dhe Personelin Arsimit:

- 1.1 Aktvendime për pushime të Lehonisë (9),
- 1.2 Aktvendime për pushime pa pagesë (07),
- 1.3 Aktvendime për pension (34),
- 1.4 Aktvendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore – vdekjen

(2),

1.5 Aktvendim për ndërprerjen e punës sipas dorëheqjes (2).

2. Konkurse të Shpallura nga janari 2021:

2.1 Konkursi për mësimdhënës 27.01.2021 gjithsej 8 pozita,

2.2 Konkursi për Sekretar 2 pozita,

2.3 Konkursi për mësimdhënës 05.02.2021 gjithsej 16 pozita,

2.4 Konkursi për Edukatore 10.03.2021 gjithsej 1 pozitë,

2.5 Konkursi për Drejtor dhe zv.Drejtor gjithsej 27 pozita,

2.6 Konkursi për psikolog, pedagog dhe Asistent me fëmijë me nevoja të veçanta më datën 23.04.2021 gjithsej 13 pozita,

2.8 Konkursi për punëtorë teknikë dhe fokist më 24.03.2021 gjithsej 10 pozita,

2.9 Konkursi për mësimdhënës më 31.05.2021 gjithsej 41 pozita.

3. Përgatitjen e shënimeve për Auditorin Gjeneral:

3.1 Listën e punëtorëve të larguar,

3.2 Listën e rekrutimeve sipas konkursit,

3.3 Listën e pushimeve të lehonisë, 3.4 Listën e punëtorëve në kontratë mbi veprën.

4. Kërkesat dhe Përgjigjja e palëve:

4.1 Përgjigjet në kërkesat e palëve drejtuar DKA-së (246),

4.2 Përpilimin dhe protokollimin e kontratave për Roje (124),

4.3 Përpilimin e kontratave të rregullta për mësimdhënës dhe stafin tjetër jo profesional (70),

4.4 Përpilimin e kontratave për zëvendësime (219),

4.5 Shqyrtimin e ankesave të konkurseve; mësimdhënës, punëtorë teknikë (10),

4.6 Ndryshimet në Listë e Pagave - Formulari për ndryshime si: kthim në punë, plotësim norme, ndalesa të lehonisë, njohja e përvojës së punës, njohje e kualifikimit, ndalesa në paga, ndërrim të shkollave, plotësim norme etj. (171),

4.7 Retroaktivet për punëtorët, mësimdhënësit e pensionuar dhe të tjerë (97),

4.8 Largime nga listat e pagave, formulari për largim (186),

4.9 Përgatitjen e shkresave për futjen në listë të pagave – punëtorë të rijnë (232),

4.10 Plotësimin e formularëve për transfere bankare të kërkuar nga punëtorët të të gjitha niveleve (25),

4.11 Gjithsej ndryshime nga Janari deri qershor (711),

4.12 Bashkëpunim të vazhdueshëm me Inspektoratin e Punës dhe Inspektoratin e Arsimit,

4.13 Puna me palë sipas orarit,

4.14 Aktivitete tjera të cilat paraqiten sipas kohës dhe nevojave në DKA si dhe nga institucionet apo personat me të cilët jemi në bashkëpunim.

Bashkëpunimi me eprorët dhe kolegët nga gjitha sektorët në DKA.

V. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë kësaj periudhe (Janar -Qershor 2021) në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete tjera si në vijim:

1. Janë pranuar : 2761 lëndë- kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, hipoteka, masa të përkohshme, barra tatimore, oferta, vlerësime, kontrata të ndryshme, kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat, servitute, parcelime, legalizime të objekteve etj.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar - Qershor 2020	Janar - Qershor 2021
		2192 kërkesa	2761 kërkesa
1.	Kërkesa të pranuar DGJKP në		

Për të njëjtën periudhë (Janar - Qershor) në vitin 2021 kemi rritje të numrit për 569 kërkesa më shumë.

2. Janë kryer: 2822 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar - Qershor 2020	Janar - Qershor 2021
		2124 kërkesa	2822 kërkesa
1.	Kërkesa të kryera		

Për të njëjtën periudhë (Janar - Qershor) në vitin 2021 janë kryer 698 lëndë më tepër se sa në vitin paraprakë. Gjithashtu për këtë periudhë janë kryer edhe lëndët të cilat kanë qenë në procedurë në fund të vitit 2020 e të cilat në kohën e raportimit ishin të papërfunduara.

3. Në procedurë janë : 45 lëndë.

Nr.	Përshkrimi	Periudha e raportimit	
		Janar - Qershor 2020	Janar - Qershor 2021
		68 kërkesa	45 kërkesa
1.	Kërkesa të kryera		

Përveç kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare :

- Janë lëshuar: **5292 kopje** Certifikata të pronësisë. Në vitin 2020 për të njëjtën periudhë janë lëshuar 4165 certifikata (1127 kopje më tepër në vitin 2021).
- Janë lëshuar rreth: **876 kopje** Certifikata të gjendjes ekonomike. Në vitin 2020 për të njëjtën periudhë janë lëshuar 610 certifikata (266 kopje më tepër në vitin 2021).
- Janë lëshuar: **1286 kopje të planit**. Në vitin 2020 për të njëjtën periudhë janë lëshuar 956 kopje plani (330 kopje më tepër në vitin 2021).

Gjithsej produkte të gatshme: 7454 kopje. Në vitin 2020 për të njëjtën periudhë janë lëshuar 5731 kopje (1723 kopje më tepër në vitin 2021).

Përveç lëndëve përmes QSHQ -së, DGJKP-ja, ka kryer edhe lëndë – kërkesa sipas detyrës zyrtare lidhur me :

- 16 kërkesa për historiate të pronave me kërkesa të subjekteve të ndryshme: Policisë së Kosovës, Avokatit të Komunës dhe Gjykatës Themelore;
- 5 Regjistrime të objekteve në procedurën e legalizimit;
- 3 kërkesa sipas detyrës zyrtare për koordinata në DUPMM ;
- 2 kërkesa sipas detyrës zyrtare për parcelime për nevoja të shpronësimit në Sektorin e Gjeodezisë;
- 2 konkluzione për ngritjen e procedurës kundër uzurpimit të pronës komunale.
- Dëgjimi publik me pronarët e tokave ZK Uglar, lidhur me shpronësimin e pronave për nevoja të impiantit.
- Hartimi dhe publikimi i regjistrit të veçantë të pronave komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim subjekteve atyre fizik dhe juridik,
- Sponzorizimi i Vendimeve për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal, si : Dhënia në shfrytëzim për periudhë afatgjate të pronave komunale ZK Ponesh, ZK Bresalc, ZK Livoq i Epërm dhe ZK Gjilan,
- Organizimi i procedurës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim për 99 vite përmes Shprehjes Publike të Interesit deri në përgatitjen e rekomandimit për ofertën ekonomikisht më të favorshme;
- Sponzorizimi i Vendimeve në Kuvendin Komunal për këmbimin e pronave private me ato komunale për realizimin e interesit publik – sigurimin e kohës për nevoja të infrastrukturës publike.
- Shqyrtimi dhe përgatitja e kërkesës iniciativës për Shpalljen zonë e interesit të përgjithshëm publik hapësirën prej 15 ha, në lagjen e Zabelit të Sahit Agës e njohur si “Te çami” pronë e mbjellur me pisha e Kombinatit Bujqësor Agrikultura.

Te hyrat vetanake :

Janë planifikuar për vitin 2021: 230.000,00 €

Janë realizuar për këtë periudhë: 105.400,00 € (45.83 %)

Janë shpenzuar investimet kapitale (kompensimet) për shpronësime në shumën prej 925.000,00 €.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë dhe zyrat tjera komunale, me institucionet dhe agjencitë qeveritare: MAPL-në, Ministrinë e Financave, Agjencinin Kadastral të Kosovës, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencionin Kosovar të Pronave, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Arkivin Ndër komunal, Gjykatat e rangut të ndryshëm, etj. si dhe me Organizatat Ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë: OSCE, USAID, KFOR etj.

VI. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tërë aktivitetin në kuadër të përgjegjësi dhe kompetencave të cilat janë të përcaktuara me Ligj dhe akte të tjera nënligjore (LVL), Statuti i Komunës, Ligji për Shëndetësi etj...) për këtë vit e ka bazuar në Planin e Punës për vitin 2021. Krahas aktiviteteve të cilat zhvillohen në baza ditore në kuadër të zyrave që funksionojnë brenda DSHMS-së si dhe aktiviteteve në dy institucione të rëndësishme siç është QKMF Dr.Nagip Rexhepi dhe Qendra për Punë Sociale.

Në kuadër të investimeve në infrastrukturën shëndetësore, në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë, projekti i ndërtimit të QKMF-së, është në përfundim e sipër, dhe tani jemi në fazën e inventarizimit, pajisjes me aparatura si dhe rregullimin e infrastrukturës së jashtme për rreth objektit.

Funksionalizimi i objektit të ri të QKMF-së pritet të bëhet gjatë muajit gusht apo në fillim të muajit shtator të këtij vitit.

Ndërtimi i Fshatit-Social është projekt i cili realizohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit të Komunës së Gjilanit dhe qeverisë së Kuvajtit të cilin e përfaqëson Organizata Ekonomiko - Kulturore "Qëndresa Kosovare". Sipas marrëveshjes Komuna i ka kryer të gjitha obligimet që nga ndarja e parcelës së tokës në sipërfaqe prej 3.5 Ha me vendim të Kuvendit Komunal, e deri tek pajisja me leje ndërtimore. Ky projekt është në përfundim e ku janë ndërtuar dhjetë objekte të cilat do të jenë në funksion të ofrimit të shërbimeve sociale për të gjitha kategoritë që kanë nevojë. Funksionalizimi i këtij projekti pritet të bëhet në muajin shtator.

Përmes zyrës për mirëqenie sociale ka vazhduar implementimi i skemës sociale, pagesa e qirasë për 61 familje me gjendje të rëndë sociale. Ky aktivitet është zhvilluar në baza mujore, në bazë të kontratave të lidhura në mes të komunës dhe 61 familjeve me gjendje të rëndë sociale të cilat janë përzgjedhur nga komisioni AD-HOC.

Meqenëse kontratat për pagesën e qirasë kanë skaduar në fund të vitit 2020, në këtë vit pas pranimit të kërkesave kemi lidhur kontrata të reja për pagën e qirave me 61 familje me kosto 5,650 € në muaj.

Edhe këtë vit kemi vazhduar implementimin e rregullores 04/2017 për financimin e projekteve të OJQ-ve përmes thirrjes publike.

Në thirrjen publike të shpallur nga DSHMS-ja për subvencionimin e projekteve që kanë të bëjnë me trajtimin e personave me nevoja të veçanta kanë aplikuar 7 OJQ, me 7 aplikacione. Shuma totale për mbështetje financiare për OJQ-të gjithsej është 20,000 euro

Gjithashtu edhe realizimi i Projektit të DDD-së (Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim) ka qenë me prioritet për Drejtorinë tonë.

Të bashkangjitur gjeni Raportin e punës sipas zyrave të organizuara në kuadër të DSHMS-së si dhe raportin e punës të QKMF Dr. Nagip Rexhepi dhe Qendrës për Punë Sociale.

Zyra për Shëndetin Publik

Gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2021, në kuadër të zyrës për shëndet publikë, janë zhvilluar aktivitete si në lëmin e edukimit shëndetësorë të popullatës po ashtu edhe në sferën e pro pagimit të shëndetësisë, monitorimit të sëmundjeve ngjitëse të cilat paraqiten në regionin tonë edhe atë duke u bazuar në specifikat e secilit mjedis lidhur me problemet shëndetësore. Aktivitete të tilla në sferën e pro pagimit të shëndetësisë, monitorimit të sëmundjeve janë zhvilluar si në viset rurale po ashtu edhe në Komunën tonë.

Monitorimi është bërë në fshatrat: Zhegër, Bresalcë, Lladovë, Nasalë, Livoq i Poshtëm, Livoq i Epërm. ku po ashtu janë vizituar qendrat dhe punktet e mjekësisë familjare dhe janë bërë konsultimet me stafin mjekësorë. Duke u bazuar në të dhënat e marrura nga terreni dhe nga burimet e qendrave të mjekësisë familjare, punkteve të mjekësisë familjare, Institutit rajonal të shëndetësisë publike lidhur me sëmundjet infektive, të atyre kronike, të shëndetit mjedisor (uji,ajri), janë nxjerr të dhëna në bazë të numrit të pacienteve të kontrolluar për periudhën janar-qershor 2021, dhe janë analizuar në kuadër të zyrës për shëndet publik ku rezulton se sëmundjet më të shpeshta gjatë kësaj periudhe kohore ishin: influenza,covid-19, pneumoni, diarre akute, hepatiti akut, sëmundjet kardiake, hipertensioni, diabeti sëmundjet malinje. Për ditën botërore të ujit është mbajtur ligjëratë me temën “Uji dhe shëndeti” si dhe është vizituar me ekipin profesioniste penda Përlepnicës ku për së afërmi jemi njoftuar lidhur me gjendjen e ujit të pijshëm si dhe analizat kimiko bakteriologjike që bëhen në laboratorin e tyre.

Furnizimin me ujë në viset rurale kryesisht bëhet nga pusët që shumica prej tyre nuk i plotësojnë kriteret e ujit të pijshëm. Në bazë të këtyre të dhënave detyrat më prioritete janë: Mbikëqyrja, hulumtimi dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse Matja e frekuencës dhe përhapjes së sëmundjeve, hulumtimi i etiologjisë së tyre. Intervenimi në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve me marrjen e masave profilaktike dhe kundër epidemike.

Paraqitja Covid-19, në muajin mars të vitit të kaluar në Kosovë, ka bërë që të mobilizohen të gjitha strukturat relevante të komunë sonë për të marr masat e domosdoshme për të parandaluar shpërndarjen e coronavirusit-19 në masa më të gjëra të popullatës. Instituti Kombëtar Shëndetësisë Publike ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike të ngritët niveli i vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë ku ne si Drejtori i kemi marrë të gjitha masat e duhura preventive në bashkëpunim me QKMF-n dhe të gjithë organet relevante duke rritur vigjilencën për t'u përballur me rastet e gripit Covid-19 dhe jemi në gjendje gatishmërie të përcjellë situatën epidemiologjike për mbrojtje nga kjo pandemi. Përdorimi i maskave mbrojtëse, ruajtja e distancës fizike, përdorimi i dezinfektantëve dhe vaksinimi janë elemente kyçe në parandalimin e Covid-19.

Në vazhden e aktiviteteve të zyrës për shëndet publik me 25.06.2021, ka filluar dezinfektimi hapësinor i qytetit *Faza e parë* –

Faza e parë e ka filluar ashtu siç është paraparë me datë 25.06.2021, në ora 18.30 është takuar komisioni mbikëqyrës me ekipin e kompanisë lidhur me planin e veprimit dhe përgatitja e preparateve për dezinfektim, në ora 19.30 ka filluar Dezinfektimi i hapësirës rreth lumenjve: Mirusha dhe Stanishorka me pompa dore për shkak të pamundësisë së qasjes së kamionetave. Me tri kamioneta ULV(Ultra Loë Volume) për dezinfektim hapësinor të ndara në tri ekipe janë dezinfektuar: Zabeli Sahit Agës për të vazhduar me lagjen Qenar Qeshme, Bojanina, Kamnik dhe ka përfunduar në ora 00.30.

Projekti ka vazhduar me datën 26.06.2020, ora 18.30- Reshat Ymeri, Dheu i Bardhë, Rozaleta dhe ka përfunduar në ora 00.30.

Në ditët në vijim 27.06.2021 duke filluar nga ora 18.30 deri ora 00.30 janë të përfshi lagjet tjera Dardania, Kodra e Dëshmorëve, Bregu i Djegur. Me datën 28.06.2021 dhe 29.06.2021 ku është vazhduar me qendrën e qytetit, lagjen e tetë si dhe tërë hapësirat tjera të qytetit si dhe dy

fshatrat të parapara për dezinfektim Livoqi i Epërm, Livoqi i Poshtëm ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve, sidomos rreth lumenjve në këto fshatra. Me 30.06.2021 nga 18.30 është vazhduar me këto fshatra Malisheva, Uglari, Pogragja, Dobërçani, Përlepница, Cërrnica, Lladova, Zhegra, Llashtica dhe Velekinca, është kryer dezinfektimi i tyre rreth lumenjve në këto fshatra i ndarë në dy ekipe me dy kamioneta ULV(Ultra Loë Volume) për dezinfektim me 30.06.2021, deri 00.30, ku edhe përfundon faza e parë e dezinfektimit.

Trajtimi i sipërfaqeve për dezinfektim hapësinor është bërë nga toka me mjete të posaçme të cilat krijojnë aerosole të imta në formë të mjegullës së ftohët mjete të sofistikuar në bazë të principit ULV(Ultra Loë Volume), tri kamioneta dhe pompa dore në ato vende ku nuk mund të depërtoj kamioneta. Principi themelor i spërkatjes hapësimore është arritja e kontaktit maksimal në mes të insektit dhe insekticidit.

Angazhimi ynë ekipor si dhe i kompanisë për të arrit suksesin e duhur ka qenë në nivel, me qëllim që ky proces shumë i domosdoshëm dhe i mirëpritur të ketë rezultatin e kënaqshëm.

Preparati për dezinfektim ishte: NEOPITROID PREMIUM, përqendrimi i preparatit është 1L preparat i tretur me 9L ujë.

Përmbajtja e preparatit: Permetrina
108 g/l

D-trans aletrina 1,5 g/l

Piperonil butoksida 110 g/l

NEOPITROID PREMIUM është biocid dhe insekticid që përdoret për eliminimin e insekteve, i prodhuar nga Genera d.d. Kroaci, që përdoret për dezinfektimin e hapësirave në ambiente të jashtëm, preparati është i aprovuar nga Unioni Evropian, që është ekologjikë me një veprim të shpejt dhe efekte maksimale.

Hapësira për dezinfektim e paraparë prej 1300 hektarësh- faza e parë është kryer me sukses.

Zyra për Shërbime Shëndetësore

Kërkesat e palëve për barëra dhe mjekim në skemën e „subvencionit” të DSHMS (që vazhdojnë të jenë në numër të konsiderueshëm) janë kontrolluar, kompletuar dhe përgatitur për seancat e komisionit për vlerësim dhe më pas edhe janë kompletuar listat e pagesës për palët të cilëve iu është aprovuar ndihma! Numri i kërkesave të aprovuara në si dhe shpenzimet sipas periodave paraqiten në:

Tab.Nr:1

Nr.	Muaji kur është bërë pagesa.	Nr, i kërkesave të aprovuara	Shuma e paguar (€)	Data e shpenzimit	Vërejtje!
1	Mars/2021	72	6,300.00	04/03/-2021	(Kërk.Janar/2021)
2	Mars/2021	102	8,280.00	18/03/2021	(Kerk. nga shkurti 2021!)
2	Prill/2021	73	8,980.00	16/04/2021	(Kerk. marsi/2021)
3	-//-	2	-	-	Prill(ven. të ZKK-së.)
3	Qershor/2021	41	-	-	(Kërkesa nga prilli)
4	Qershor/2021	62	-	-	(Kerk nga maji/2021)
5	Qershor/2021	2	11,310.00	Qershor/2021	Maj(vendimi ZKK-së.)
Tot		354	34,870.00€		

Për të krahasuar me periudhat e ngjashme të viteve të kaluara shërben tabela në vazhdim.

Tab,Nr:2

Viti	Aprovim ndihme për barëra Janar-Qershor sipas viteve	Mjete shpenzuara shprehur në euro!	Kër. të apr. më tepër ose më pak se në periodat e njëjta të viteve paraprake!	Shpenzim më tepër ose më pak (euro).
2021	354	34,870.00	+132	+8790
2020	222	28.210	-79	-7625
2019	301	35.835	41	+6608
2018	259	29.277	53	+9547
2017	206	19.730	-55	- 6130
2016	261	25.800	8	+1280
2015	252	24.520	46	+1620
2014	206	22.900		

Me komisionin komunal për riatdhesim dhe ri integrim në katër(4) raste kam prezantuar në vizita intervistuese dhe vlerësuese të shkallës së cënueshmërisë (vulnerabilitetit) të përkufizuar me: UA 20/2020 për individ ose familje në procedurë të riatdhesimit.

Edhe këtë vit në cilësi të anëtarit të komisionit komunal për performancë jam angazhuar në grumbullimin e shënimeve, llogaritjen dhe nxjerrjen e indikatorëve (treguesve të efikasitetit dhe efektivitetit si dhe krahasimin me standardet e rekomanduara nga organizata relevante botërore për shëndetësi –(ËHO) lidhur me shërbimet shëndetësore në KPSH.

Në kuadër të përgatitjes së lëndëve për përfitues individualë (subvencionim për barëra dhe mjekim si dhe pagesa tjera për kategorinë e cekur më parë) kam për pagesë materialet për katër muaj sipas periodave të shqyrtimit të kërkesave si dhe rastet e përfituesve individual që janë paguar me vendime të posaçme i kam dërguar në MF-Thesar (12 raste për regjistrim në SIMFK.)

Zyra për Mirëqenie Sociale

Raporti i punës janar-qershor 2021 i Zyrës për Mirëqenie Sociale pranë Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Raporti i punës janar-qershor 2021 i Zyrës për Mirëqenie Sociale pranë Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Punët dhe aktivitetet e Zyrës për Mirëqenie Sociale për gjashtë mujorin e parë, janë të bazuara në planin e punës dhe përmbushjen e objektivat kryesore:

1.Banimi Social

- a) Pagesa e qirasë për familje me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale,
- b)Renovimi-ndërtimi i shtëpive të familjeve me gjendje të rëndë sociale

2. Fshati Social

3. Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për rastet sociale.

4. Thirrja publike për subvencionimin e projekteve të OJQ-ve
5. Bashkëpunimi me Qendrën për Punë Sociale në lidhje me rastet 6. Pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë ekonomike
7. Bashkëpunimi me Organizatën People in Need (PIN).
8. Konsulta me palë në lidhje me kërkesat.
9. Pjesëmarrje në trajnime, punëtori.

1. BANIMI SOCIAL- përmes Zyrës për Mirëqenie Sociale ka vazhduar implementimin e skemës sociale, pagesa e qirasë për 61 familje me gjendje të rëndë sociale. Ky aktivitet është zhvilluar në baza mujore, në bazë të kontratave të lidhura në mes të komunës dhe 61 familjeve me gjendje të rëndë sociale, të cilat janë përzgjedhur nga komisioni AD-HOC.

Meqenëse kontratat për pagesën e qirasë kanë skaduar në fund të vitit 2020, këtë vit pas pranimit të kërkesave kemi lidhur kontrata të reja për pagesën e qirave me 61 familje dhe 16 kërkesa janë në pritje për pagesën e qirasë për përdhën janar-qershor 2021.

Gjithashtu kemi monitoruar edhe kontratat e shfrytëzuesve të banesave të ndërtesave të banimit social, 53 familje janë të vendosura në dy objektet e banimit social, përmbledhja e të dhënave të përgjithshme të banorëve në objektet e banimit social.

2. FSHATI SOCIAL- ndërtimi i Fshatit Social është projekt i cili realizohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit të Komunës së Gjilanit dhe qeverisë së Kuvajtit të cilin e përfaqëson Organizata Ekonomiko – Kulturore “Qëndresa Kosovare”.

Sipas marrëveshjes Komuna i ka kryer të gjitha obligimet që nga ndarja e parcelës së tokës në sipërfaqe prej 3.5 ha, me vendim të Kuvendit Komunal, e deri tek pajisja me leje ndërtimore. Ky projekt ka filluar së implementuari me 10 Korrik dhe përfundimi i tij pritet të bëhet brenda 24 muajsh. Jemi në monitorim të vazhdueshëm të implementimit të projektit sipas Planit Dinamik të Punës.

3. NDËRTIMI DHE RENOVIMI I SHITËPIVE PËR RASTET SOCIALE- gjithsej 8 kërkesa të reja për vitin 2021 janë në pritje të renovimit apo ndërtimit të shtëpive.

4. THIRRJA PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E OJQ-ve -Edhe këtë vit kemi vazhduar implementimin e rregullores 04/2017 për financimin e projekteve të OJQ-ve përmes thirrjes publike. Në thirrjen publike të shpallur nga DSHMS-ja për subvencionimin e projekteve që kanë të bëjnë me trajtimin e personave me nevoja të veçanta kanë aplikuar 7 OJQ, me 7 aplikacione. Shuma totale për mbështetje financiare për OJQ-të gjithsej është 20,000 euro.

Me qëllim të përcjelljes të implementimit të këtyre projekteve me vendim të posaçëm kemi caktuar një zyrtar, i cili në fund të këtij viti do të hartoj raportin e implementimit të projekteve të OJQ-ve dhe arsyetimit të shpenzuara nga OJQ-të përfituese.

5. BASHKËPUNIMI ME QENDRËN PËR PUNË SOCIALE--ka vazhduar bashkëpunimi me QPS-së në lidhje me rastet, familjet në nevojë me gjendje të rëndë ekonomike.

6.SHPËRNDARJA E PAKOVE USHQIMORE- është bërë shpërndarja e pakove ushqimore për familjet në nevojë me ndihme donatorëve.

270 pako ushqimore dhe higjienike janë shpërndarë për familjet në nevojë nga donator të ndryshëm (Islamik Relief, mishtorja Malësia, shoqata Jetimat e Ballaknit dhe donacion nga Zyra e BE-së në Kosovë) në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit.

7.VAZHDON- pjesëmarrja në takimet punuese për hartimin e Strategjisë Komunale për Shërbime Sociale, marrëveshje e nënshkruar mes zyrës së Kryetarit dhe organizatës People in Need(PIN).

8.KONSULTA ME PALË- janë realizuar konsulta të vazhdueshme me palë në lidhje me kërkesat tyre, rastet janë referuar tek shërbimet e nevojshme.

9.Trajnim dy ditor 30 dhe 31 mars 2021 në Prishtinë “ Puna ndër sektoriale dhe procesi i menaxhimit të rasteve, për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale e që janë në konflikt me ligjin” organizuar nga IKAP dhe organizata Terre de Hommes.

Trajnim dy ditor 27 dhe 28 maj në Gjilan “Inicimi i qasjes multi-disiplinore dhe shkëmbimi i metodologjive, procedurave dhe protokollove të ndryshme të punës në fushën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës” organizuar nga Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës-HENDIKOS.

Trajnim dy ditore 1 dhe 2 korrik në Durrës, Shqipëri për planifikim të shërbimeve sociale me qëllim hartimin e strategjisë komunale për shërbime sociale dhe planin vjetor të veprimit për komunën e Gjilanit.

Kërkesa të ndryshme të qytetarëve, përgjigje të kërkesave për barëra, për kompensim të qirasë, kërkesa për ndërtim të shtëpisë, etj...

Kontaktet dhe informatat me palë të ndryshme.

Tabelar i kërkesave dhe Vendimeve për periudhën : janar- qershor 2021

Nr	Lloji i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në proces	Gjithsejtë
1	Kërkesë për barëra	350	140	79	569
2	Kërkesë për qira, strehim dhe renovim të shtëpisë	/	/	38	38
3	Kërkesa tjera	/	/		14
4	Kërkesa për kompensim shpenzimeve Covid'19	/	/	857	857

	Gjithsejtë				1.478

Zyra për buxhet dhe financa

Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përkatësisht kodi buxhetor 73036 për vitin 2021 i ndarë dhe miratuar nga buxheti i shtetit, Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake është gjithsej 295,863.00 €.

- **Gjatë** këtij gjashtë mujori në këtë kod buxhetor janë shpenzuar gjithsej 104,345.47€ për të gjitha kategoritë e shpenzimeve të cilat do t'i paraqesim në mënyrë të detajuar veç e veç.
- **Pjesa** më e madhe e buxhetit të DSHMS-s është e rezervuar për Subvencione dhe Transfere, ndërsa pjesa tjetër për Paga&Mëditje mallra e shërbime si dhe shpenzime komunale.

Pagat dhe meditet:

Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan që përbën kategorinë e shpenzimeve për Paga dhe Meditje i cili për vitin 2021 është 46,863.00 €

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale aktualisht numëron 6 punonjës me kontratë të rregullt të përfshirë në listën e pagave .

Buxheti i cili është shpenzuar për paga&mëditje në këtë gjashtë mujore është 19,932.33 €.

Shpenzimet për periudhën Janar –Qershor 2021

Mallra dhe Shërbime:

Kategoria e pozicionit për Mallra&Shërbime në DSHMS-s për vitin 2021 është 70,000.00 € Mjetet të cilat janë shpenzuar gjatë kësaj periudhe janë 16,013.92€ .

Shpenzime komunale:

Shpenzimet Komunale në DSHMS për vitin 2021 janë 9,000.00€ dhe janë shpenzuar 2,389.22€.

Në shpenzimet komunale përfshihen :

- shpenzimet e rrymës të cilat janë 1,079.94 €,

- shpenzimet e telefonisë fikse 364.45 €
- shpenzimet për ujë 403.13€
- shpenzimet e mbeturinave në vlerë prej 541.70 €

Të gjitha pagesat në këtë pozicion janë realizuar në kohë.

Subvencionet dhe Transferet:

Kategoria e pozicionit për Subvencione dhe Tarnsfere për vitin 2021 është 170,000.00€, kjo kategori është kategoria kyçe në kuadër të DSHMS-s

Gjatë periudhës janar-qershor janë shpenzuar nga kjo kategori gjithsej 66,010.00€

Subvencion për barna-34,870.00 €

Subvencion për qira-28,290.00 €

Subvencion për përfitues individual-2,850.00

Shpenzimet për periudhën Janar -Qershor 2021

	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Komunali	Subvencion për barna	Subvencion për Qira	Subvencion përfitues individual
Janar	3280.75	-			-	-
Shkurt	3280.75	977.84	1077.57		-	-
Mars	3485.08	760.92	583.41	6,300.00	11,200.00	450.00
Prill	3295.25	9,425.38	92.38	8,280.00	5,890.00	1,900.00
Maj	3295.25	768.02	166.19	8,980.00	5,550.00	-
Qershor	3295.25	4081.76	469.67	11,310.00	5,650.00	500.00
Total	19,932.33	16,013.92	2,389.22	34,870.00	28,290.00	2,850.00

	RRYMA	TEL.FIX	MBETURINAT	UJE
Janar				
Shkurt	878.01	199.56	8.18	
Mars	-	66.25	517.16	
Prill	51.58	32.62	8.18	
Maj	124.79	33.22	8.18	
Qershor	25.56	32.80	8.18	403.13
Total:	1,079.94	364.45	541.70	403.13

Gjithsej shpenzime janar-qershor 2021=**104,345.47€**

QENDRA PËR PUNË SOCIALE GJILAN

Raporti financiar :

- Buxheti i Qendrës Për Punë Sociale përkatësisht kodi buxhetor 75631 për vitin 2021 i ndarë dhe miratuar nga buxheti i shtetit Grandi qeveritar dhe të hyrat vetanake dhe buxheti shtesë i qeverisë është gjithsej 122,760.00 €.
- Gjatë këtij gjashtë mujori në këtë kod buxhetor janë shpenzuar gjithsej 50,979.28€ për të gjitha kategoritë e shpenzimeve të cilat do t'i paraqesim në mënyrë të detajuar veç e veç.
- Pjesa më e madhe e buxhetit të QPS-s është e rezervuar për Paga&Mëditje, ndërsa pjesa tjetër për mallra e shërbime si dhe shpenzime komunale.
- Qendra për punë sociale nuk ka pasur asnjëherë mjete për kategoritë e shpenzimeve Subvncione&Transfere dhe Investime Kapitale.
- Në QPS kemi edhe të hyra vetanake të cilat realizohen përmes QPS-s sektorit financiar nga participimi i qytetarëve të cilët paguajnë taksa të përcaktuara me ligj sipas rregullores për taksa ,ngarkesa dhe gjoba komunale.

Të hyrat:

Gjatë këtij gjashtë mujori në QPS, përkatësisht në kategorinë e të hyrave vetanake janë realizuar gjithsej :15.00€.

Të hyrat vetanake realizohen sipas rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr.016-126416 të dt.29.12.2016 dhe ndryshimit të rregullores nr.03/2018.

Dokumenti me pagesë i cili është lëshuar nga QPS duke realizuar kërkesat e qytetarëve janë kryesisht konstatime zyrtare

Gjatë ndryshimit dhe plotësimit të rregullores në fjalë ndër vite janë larguar pagesat për shumicën e shërbimeve me pagesë dhe janë anuluar propozimet për disa shërbime prandaj QPS-ja nuk arrin më t'i grumbulloj të hyrat e planifikuara dhe të realizuara vite më parë.

Paga & Mëditje

Buxheti i Qendrës për Punë Sociale në Gjilan përbën kryesisht kategorinë e shpenzimeve për Paga dhe Mëditje i cili për vitin 2021 është 102,760.00€.

Qendra për Punë Sociale aktualisht numëron 15 punonjës me kontratë të rregullt të përfshirë në listën e pagave

Buxheti i cili është shpenzuar për paga & mëditje në këtë gjashtë muor është 46,299.80€.

Mallra dhe Shërbime:

Kategoria e pozicionit për Mallra & Shërbime në QPS për vitin 2021 është 12,000.00€ nga granditë qeveritar si dhe 3,000.00€ nga të hyrat vetanake që do të thotë gjithsej 15,000.00€.

Mjetet të cilat janë shpenzuar gjatë kësaj periudhe janë 3,121.65€ .

Buxheti i shpenzuar në pozicionin në fjalë është realizuar kryesisht paga e një zyrtare me kontratë mbi vepër, furnizime për zyre, pagesa për praktikantë etj....

Gjithashtu në këtë pozicion kemi pagesa në procedurë, por pasi që nuk janë të shpenzuara nuk kemi mundur t'i paraqesim si shpenzim.

Gjatë kësaj kohe nuk ka pasur ndonjë problem gjatë realizimit të pagesave, të gjitha janë kryer në mënyrë të rregullt duke u kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm.

Shpenzime komunale:

Shpenzimet Komunale në QPS për vitin 2021 janë 5,000.00€ dhe janë shpenzuar 1,557.83€.

Në shpenzimet komunale përfshihen :

- shpenzimet e rrymës të cilat janë 825.67€,

- shpenzimet e telefonisë fikse 233.76€
- shpenzimet e ujit 421.24 € si dhe
- shpenzimet e mbeturinave në vlerë prej 77.16 €

Të gjitha pagesat në këtë pozicion janë realizuar në kohë.

RAPORTI GJASHTE MUJOR I SHËRBIMEVE SOCIALE

	<i>Aktivitetet</i>	Kategoria 0	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej	
APLIKIMI	1. Nr. i rast. që kanë aplik. për herë të pare.	1.1+1.2+1.3	1.1+1.2+1.3 63	1.1+1.2+1.3 34	1.1+1.2+1.3 97	Kategoria 0+1+2
	Sa prej tyre janë të aprovuara		35	26	61	
	Sa janë në shqyrtim		17	6	23	
	Sa prej tyre janë të refuzuara		11	2	13	
RIAPLIKIMI	2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim					Kkat. 0+1+2
	3. Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar		419	98	517	
	4. Numri i rast. të larguar për mungesë të dokumentacionit		66	15	81	
VERIFIKIMI	5. Numri total i familjeve të verifikuara/riverifikuara	1+2+3+4	1+2+3+4 547	1+2+3+4 137	1+2+3+4 684	Kat. 0+1+2
	5.1. Sa prej tyre janë aprovuar		446	116	562	
	5.2. Sa janë refuzuar/çregjistruar		98	20	118	
			3	1	4	

	5.3. Sa janë në procedurë e sipër					
KOM. MJEKËSOR	6. Nr i rasteve të dërgu. në Komi. Mjek.(KM)	6.1+6.2+6.3	6.145v v +6.2+6.3 218	6	6.1+6.2+6.3 224	Kat. 0+1+2
	6.1. Numri i rasteve të aprovuara nga KM		156	4	160	

	6.2. Numri i rasteve të refuzuara nga KM		62	2	64	Kat. 0+1+2
	6.3. Numri i rasteve të kthyer nga KM për kompletim dokumentacioni		/	/	/	
ANKESAT	7. Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit	A+B+C	42	A+B+C 14	A+B+C 56	Kat. 0+1+2
	A. Në shkallë të parë(I)	a1+a2+a3	28	a1+a2+a3 14	a1+a2+a3 42	
	a) 1. Ankesa të pranuar		15	10	25	
	a) 2. Ankesa të refuzuara		4	4	8	
	a) 3. Ankesa në procedurë e sipër		9	0	9	

	B. Në shkallë të dytë(II)	b1+b2+b3	14	b1+b2+b3 /	b1+b2+b3 14	
	b) 1. Ankesa të pranuar		/	/	/	
	b) 2. Ankesa të refuzuara		3	/	3	
	b) 3. Ankesa në procedurë e sip.		6	/	6	
	C. Kontestet në Gjykata	C1+c2+c3	C1+c2+c3	C1+c2+c3 /	C1+c2+c3	
	c) 1. Kontestet të pranuar		/	/	/	
	c) 2. Konteste të refuzuara		/	/	/	
	c) 3. Konteste në procedurë e sip.		5	/	5	
						K 0+1+2

Raport i Asistencës Sociale Aktivitetet tjera:

Gjatë këtij gjysmë vjetori të këtij viti 2021 në qendrën për punë sociale janë shpërnda 238 kupona, donacion nga UNDP për familjet me gjendje të rëndë ekonomike-sociale e të cilat kupona kanë pasur vlerën nga 60-70 euro për gjatë muaj rresht, nga muaji Maj deri në muajin Tetor 2021.

Gjithashtu janë shpërndarë 2020 pako ushqimore me rastin e festes së Bajramit, donacion nga vëllezërit e Drejtorit Mursel Zymberit.

- 9 -vërtetim se janë shfrytëzues të ndihmës sociale,
- 97 -vërtetime se nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale.
- 33 vërtetime për lirim të shtetësisë
- 139 Gjithsej vërtetime

Është mbajtur komisioni mjekësor gjysmë vjetorin e parë të viti 2021 ku në komision kemi prezantuar gjithsej 224 lëndë të aprovuara janë 160 lëndë dhe të refuzuara janë 64 lëndë.

Gjithashtu kemi dal në terren për verifikimin e kërkesave të reja.

Është njoftuar DNS-ja për komision mjekësor për muajin Janar

RAPORTI GJASHTË MUJOR NGA QKMF

Vitin 2021-të QKMF si gjithherë e ka filluar me ofrime të shërbimeve shëndetësore, por edhe me planifikim dhe aktivitete tjera duke u fokusuar në:

- ofrim të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Gjilanit
- ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet shëndetësore
- furnizim më të mirë me terapi orale dhe parenterale sipas listës esenciale
- furnizim me aparaturë mjekësore dhe inventar për kushte me të mira të punës
- trajnime dhe ligjërata të stafit si të mjekëve ashtu edhe të infermiereve

Drejtori i QKMF-së **Dr. Arbenita Hajdari** ka filluar vitin 2021 së bashku me të gjithë shefat dhe kryeinfermierët e shërbimeve shëndetësore duke marrë për sipër që të ofrojnë shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit. E ne veçanti kujdes të veçantë i ka kushtuar situatës me Covid -19, sidomos vaksinimit të qytetareve të Komunës së Gjilanit .

- Gjatë kësaj periudhe 6 mujore drejtoresha e QKMF-se, ka pasur takime të rregullta me Shtabin e përgjithshëm në kuadër të Komunës së Gjilanit dhe me Institucionet relevante, ku janë diktuar të gjitha problematikat e situatës shëndetësore në Komunën e Gjilanit dhe më gjerë dhe janë marr masa mbi kujdesin shëndetësor e sidomos tek pacientet me Covid-19 .

- Gjithashtu në bashkëpunim me institutin rajonal kemi bërë edhe testimet e pacienteve me Teste Rapide -antigjen për Covid -19

-Me fillimin e ardhjes së vaksinave në Republikën e Kosovës, drejtoresha e QKMF-se ka marr të gjitha masat e duhura për organizmin e vaksinimit të qytetarëve të Gjilanit duke angazhuar ekipin e vaksinimit si dhe formimin e ekipeve shtese që vaksinimi të funksionoj në mënyrën me të mirë të mundshme .

- Nga data **02.04.2021** kemi filluar vaksinimin ne QMF Ramiz Cërnica dhe kemi vazhduar deri me 15.06.2021 ku nga kjo datë kemi kaluar në Sallën e Sporteve “ Bashkim Selishta –Petriti”.

Vlen të ceket se nga fillimi i vaksinimit të datës 02.04.2021 deri më **30.06.2021 janë dhënë 8549** vaksina qytetarëve të Komunës së Gjilanit dhe planifikojmë që deri në fund të vitit 2021 të **vaksinojmë 60 % të** popullatës së Gjilanit.

Puna në shërbimet shëndetësore

1.1. Mjekësia Familjare

Ka ofruar shërbime shëndetësorë për të gjithë qytetarët e komunës së Gjilanit të të gjitha moshave si në objektin e saj kryesor me shërbimet brenda saj, gjithashtu edhe në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare të shtrira në tërë territorin e Komunës së Gjilanit, shih tabelën nr1.

Stomatologjia

- Shërbimi i stomatologjisë i cili ofron shërbime shëndetësore me gjashtë ordianca brenda objektit kryesor QKMF, gjithashtu ka rrjetin e saj të karrigeve stomatologjike edhe nëpër qendrat e tjera si në qytet gjithashtu edhe nëpër disa fshatra. Shërbimet të cilat ofrohen janë :



Preventivë

- Ortodonci
- Protetikë
- Kirurgji orale
- Sëmundje të dhëmbit

Të gjitha këto ofrojnë shërbime shëndetësore për të gjitha moshat e qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Urgjenca

- Sikurse edhe në vitet tjera shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore 24 orë 7 ditë në javë.
- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës, vikendeve dhe festave, ku puna ka ecur pa probleme .
- Autoambulanca është monitoruar në vazhdimësi në drejtim të funksionimit dhe furnizimit të saj me pajisje dhe mjete të nevojshme për punë në terren, rregullisht ka qenë e furnizuar me barëra dhe material tjetër hargjues për intervenime të shpejta në terren për të gjitha thirrjet nga ana e qytetarëve .
- Përpos sigurimit të automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për punë gjithashtu ky shërbim është përforcuar edhe me kuadër profesional shëndetësor të cilat do të japin shërbime 24 orëshe për qytetarët e Komunës së Gjilanit shih tabelën nr1.

Laboratori

- Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të Laboratorit.
- Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët janë paraqit në shërbimin e Laboratorit shih tabelën nr 1.
- Edhe ky shërbim i laboratorit është përforcuar me kuadër profesional adekuat .

Barnatorja

- Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material hargjues nga MSH



- është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues nëpër QMF dhe AMF-ët duke i llogaritur edhe shërbimet brenda tyre
- është bërë furnizimi i pacientëve me barna dhe insulinë
- është bërë planifikimi për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2021
- gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake në raste specifike terapi të domosdoshme për shërbimin e Urgjencës,

Sistemi informativ Shëndetësor

- janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet relevante
- është përcjellë gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në IRSH.
- Në QKMF pas instalimit të Sistemit Elektronik, 90% e pacientëve të vizituar kryhen në mënyrë digjitale
- Sistemi SESSH-it në menaxhimin e Covid -19 ka qenë gjithmonë në gjendje gatishmërie në raportimet me kohë të të gjithë pacientëve të dyshuar me Covid -19 të gjitha Institucioneve relevante,

Kujdesi për nëna dhe fëmijë

- Kujdesi për nëna dhe fëmijë edhe pse ishte kohë pandemie kanë kryer vizitat e rregullta si për fëmijët e porsalindur ashtu edhe për lehonat dhe shtatzënat, shih tabelën në vijim, shih tabelën në vijim

Kujdesi paliativ

- Shërbimi i kujdesit pailiativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacienteve me sëmundje kronike dhe atyre të pa lëvizshëm, por edhe atyre me Covid -19, për shërbimet ë kryera shih tabelën nr.1

Shërbimi i Vaksinit

- Shërbimi i vaksinimit në mënyrë kontinuele punon në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor po ashtu edhe edukimin e pacientëve në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijëve



- Ka zhvilluar aktivitet e parapara me planin vjetor mbi vaksinimin e fëmijëve parashkollorë dhe shkollorë në tërë territorin e Komunës së Gjilanit
- Gjithashtu ekipet e vaksinimit me ardhjen e vaksinave në Kosovë, ka filluar me vaksinimin sipas planit të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë edhe në Komunën e Gjilanit duke filluar vaksinimin e qytetarëve sipas moshës së përcaktuar

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- janë mbajtur takime të rregullta të Komitetit për Cilësi.
- është bërë në vazhdimësi monitorimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore nga ana e Koordinatorit për cilësi në të gjitha QMF-ët dhe shërbimet shëndetësore.

Qendra e trajnimit të Mjekësisë Familjare

- Janë mbajtur sesionet klinike për specialistët e Mjekësisë Familjare nga Komuna jonë, Vitia dhe Kamenica prej trajnerëve të Mjekësisë Familjare.
- Ka vazhduar bashkëpunimi me Spitalin Përgjithshëm të Gjilanit dhe IKSHIP në Gjilan me qëllim që specialistët tanë një pjesë të stazhit të tyre specialistik të kryejnë në këto institucione.

Edukimi i vazhdueshëm profesional

- Ka vazhduar edukimi profesional si nga ana e mjekeve ashtu edhe e infermierëve .

Raportet e shërbimeve shëndetësore shih tabelat në vijim

Tab.nr.2.1. Tabela Kryesore e të gjitha shërbimeve për 6 mujorin e vitit 2021

Nr	Shërbimet	Totali	Nr.referimeve dhe %
1	Vizita në mjekësinë familjare	72404	10896 15.04%
2	Vizitat në Emergjencë	20251	3315 16.36 %

□

3	Vizitat shtëpiake -shër.Emërgjent	2004	
4	Vizita Stomatologjike	4940	
5	Shërbime laboratorike	13184	
6	Shërbime të Kujdesi Paliativ	5204	

7	Kujdestaria e fëmijëve	2140	487 22.75%
8	Qendra e diabetit	906	19 %
9	Participimi i përgjithshëm	0	% pagesa
10	Vizita Psikologjike	471	10 2.12%
11	Evidentimi i fletëzave kompjuterike nga SESSH -i	36232	%
12	Certifikata mjekësore	653	
13	Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë	621	
14	Pushime Mjekësore	1452	
15	Totali i Vizitave	43156	
16	Shërbimet tjera shëndetësore	135463	
17	Totali i ofrimit të shërbimeve nga QKMF për qytetaret e K. Gjilanit	178619	

Tab. Nr.2.2. Raporti i sëmundjeve ngjitëse

RAPORTI I SËMUNDJEVE NGJITËSE							
Sipas Moshës	0-4 vjeç	5-14 vjeç	15-34 vjeç	35-49 vjeç	50-64 vjeç	mbi 65 vjeç	Totali
Pneumoni	1	4	8	13	8	4	38
Dhiarë Akute	78	156	151	114	92	16	607
Varicela	29	29	11	3	3	0	75
Dyshimi në Influençë(Gripi)	19	27	36	52	34	12	180

SARI (infeksionet akute respiratore të rënda)	1	0	4	4	2	1	12
Dyshimi në parotitin epidemik	0	0	0	0	0	0	0
Sindroma e verdhëzës akute	0	0	0	0	0	0	0

Tab nr.2.3. Lëshimi i Certifikatave

LËSHIMI I ÇERTIFIKATAVE								
QMF dhe PMF	Certifikata për patentë shofer	Pushimet mjekësore	certifikata të K.I	Certifikata të mjekësore	Certifikata të vdekjes	EKG	Participim i certifikatave	Spirometri
Janar	0	189	19	21	35	29	0	4
Shkurt	0	265	35	45	33	52	15	4
Mars	0	325	11	82	46	38	43	5
Prill	0	240	18	27	61	39	21	4
Maj	0	216	6	42	35	58	28	2
Qershor	0	217	13	89	35	15	0	0
	0	1452	102	306	245	231	107	19

Tab.nr 2.4. Raporti i sëmundjeve malinje dhe masovike jo ngjitëse

Raporti i sëmundjeve malinje dhe masvike jo ngjitëse	
Sëmundjet e paraqitura	Rastet
Sëmundjet malinje	0
Sëmundjet masovike jo ngjitëse	0

Tabela nr.2.5. Raporti i shërbimit të vaksinimit

RAPORTI MUJOR I SHËRBIMIT TË VAKSINIMIT									
Emri i Vaksinës	0-11 muaj	12-23 muaj	24-59 muaj	mbi 59 muaj	Totali	Emri i vaksines	12-23 Muaj	Mbi 23 muaj	Totali

BCG ne maternitet					0	OPV R1 (1218m)	342		342
Hepatit B ne maternitet					0	DP R1 (1218m)	342		342
OPV1	405				405	OPV R2 (6-7vj)		918	
OPV2	413				413	DT (6-7vj)		918	
OPV3	414				414	MMRr (6-7vj)		1113	
DPT1+Hib1+hep B1	405				405	OPV R3(12-13vj)		1101	
DPT2+Hib2+hep B	413				413	Td(12-13vj)		1101	
DPT3+Hib3+hep B3	414				414	Td(18vj)		980	
Hep.B1 ne maternitet						Vaksinat tjera			
Eep.B2									
Hep.B3									
MMR		359			359				
MMMR II 15-18 Muaj									
Vaksina tjera									

Tab.nr.2.6.. Raporti i vizitave në shtëpi për shëndetin e nënës dhe fëmijës

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Numri i vizitave shtëpiake për fëmijë	81	131	150	80	93	86	621
Numri i vizitave shtëpiake për shtatzëna	6	29	36	8	15	16	110
Nr. total i vizitave shtëpiake të kryera (gjatë një muaji)	87	160	186	88	108	102	731
Nr. i fëmijëve vajza të cilat kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	37	34	44	33	32	27	207

Nr. i fëmijëve djem të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	34	37	66	37	32	28	234
Nr. Total i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	71	71	110	70	64	55	441
Nr. i shtatzënave që kanë pranuar 1 vizitë gjatë shtatzënisë (Janë vizituar për herë të parë)	6	14	28	8	10	11	77
Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	3	5	6	0	1	1	16
Numri i familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që kanë	0	0	0	0	0	0	0
pranuar të paktën një vizitë shtëpiake							
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistet mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	1	0	1	1	0	0	3
Numri i infermierëve që janë duke i zbatuar vizitat në shtëpi	12	19	22	22	13	14	102

Tabela Nr.2.7. Shërbimi i Barnatores

Nr Ren.	Shërbimet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
1	Nr.Pac.te furnizuar me insuline	373	673	605	514	332	119	2616

2	Nr.i pacientëve të rinj të iniciuar në insulinë	7	10	13	3	4	2	39
3	Nr.i pac. Qe kanë kaluar nga një lloj insuline në llojin tjetër	8	22	20	50	22	8	130
4	Nr.i pacientëve që kanë rritur dozën e insulinës	0	0	0	0	0	0	0
5	Nr i përgjithshëm i insulinave të shpërndara	0	0	0	0	0	0	0
6	Nr.i pacientëve të furnizuar me barna	0	83	103	93	110	6	395
7	Nr i recetave të ekzekutuara	0	0	0	0	0	0	0
8	Nr i faturave hyrëse	2	7	6	6	6	9	36
9	Nr i faturave dalëse furnizimi i qendrave dhe shërbimeve	22	18	54	45	43	28	210

Tabela nr.2.8 .Futja e fletëzave kompjuterike sipas operatoreve

EVEIDENTIMI I FLETËZAVE KOMPJUTERIKE								
Emri Mbiemri		Janar	shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali
Admir	Jashari	1286	1854	497	Vaksinim	378	139	4154
Mevlyde	Brestovci	1111	884	1367	1222	1568	1569	7721
Endrit	Osmani	760	1135	1097	458	2897	2879	9226
Selvete	Mahmuti	454	639	754	526	604	1353	4330
Kemal	Bekteshi	1124	1944	2165	Vaksinim	39	Vaksinim	5272
Ali Musliu	Musliu	768	1265	1380	1254	862	Vaksinim	5529
Totali		5503	7721	7260	3460	6348	5940	36232

RAPORTI GJASHTE MUJOR I SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr.	Kategoria e shfryt.	Nr.i rast.		Llojet e intervenimit	Rezultatet e arritura	Vërejtje
1	Shërbimet Rezidenciale	Të vjetra	Të reja			
1.1.	Kujdestaria për rastet e veçanta.			Me kërkesë të Gjykatës, caktohet kujdestari i përkohshëm për prezantim në seance gjyqësorë.		
1.2	Strehimi në shtëpi me bazë në komunitet.					
1.3	Strehimi i viktimave të dhunës në familje.					
1.4	Strehimi i viktimave të trafikimit.					

1.5	Vendosja në institucione të mbrojtjes sociale Shtëpi të Pleqve Prishtinë	1		.Kërkesa të reja, Vizitë shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar ,vlerësimi i kërkesës,	Përcjellja e gjendjes së të moshuarve përmes vizitave dhe konsultimeve,	Mbrenda periudhës së vlerësimit i moshuari vdes në spital.
1.6	Të trajtuarit e shëndetit mendor të kateg.të ndry.					
2.	Shërbimet familjare					
2.1	Fëmijët e braktisur të porsalindur			Vizitë përcjellëse e rasteve të vjetra të vendosura në strehim familjarë, sesion këshillues individual familjarë.	Fëmijët në gjendje të mirë shëndetësore, kompensimi material nga MPMS me rregull.	

2.2	Fëmijët me sjellje asociale	4		Vizite shtëpiake,sesione këshilluese individuale familjare-raste te reja	Janë udhëzuar te ushtrojnë mbikëqyrjen prindërore ndaj fëmijës se tyre.	
2.3	Abuzimi seksual i të miturve jashtë familjesprostitucion.					
2.4	Kujdestaria për të mitur					
2.5	Kujdestaria për të rritur.	1		Vizite përcjellëse ,sesione këshilluese individuale familjare,	Konsultime me pale,familjar, përgatitja e raporteve,	Shpalla per te vdekur personin e zhdukurcaktimi i kujdestarit
2.6	Bashkimi familjar	2		1Rast eshte vendosur te te afërmit, 1.Me vendim tgjykses ieshte besuar babait biologjik		
2.7	Kërkesa për me Birësimi element vendor	1		Kërkesë e re ne procedure te vlerësimit adoptim vendor,	Vlerësim pozitiv.	

2.8	Birësimi me element ndërkombëtar.			////////////////////////////////////		
2.9	Strehimi në familjet farefisnore.			Vizite përcjellëse rasteve te vjetra ne strehim,	Vizite përcjellëse rasteve,sesione këshilluese individuale,familjar,konsultime për rastet	
2.10	Fëmijët nën Kujdestari			Vizita familjare,sesione këshilluese individuale,familjare,konsultime për rastet,	Vlerësimi i kërkesës-caktimi i kujdestarit te përkohshëm-fëmijë jetim.	
2.11	Strehimi në familjet alternative.					Ska raste te reja për paujin Janar 2019.

2.12	Shërbime për reintegrimin e viktimave të trafikimit.					
2.13	Shërbime për viktima të dhunës në familje.	59		Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar, ndihme e përgjithshme për klientin,	Vazhdim i bashkëpunimit dhe kontakteve lidhur me rastin.	Përcjellja e rastit
2.14	Ndihmë në rregullimi e marrëdhëni ve bashkëshortore.	21		Vizite shtëpiake-sesione këshilluese individuale, familjare, konsultime për rastin rast ne procedure te vlerësimit	Vazhdimi i bashkëpunimit procedure te shkurorëzimit ndarjes.	Ne procedure
2.15	Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve.	18		Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar, dhënia e mendimit për besimin e fëmijës dhe lejimin e kontaktit prind fëmijë.	Ne pritje te aktvendimit .	
2.16	Dhënia e mendimit për martesë të miturve.					
2.17	Persona me nevojë të veçanta.					

2.18	Ndihmë në realizimin e kontakteve prind-fëmijë.					
2.19	Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer.					
2.20	Fëmijët me aftësi të kufizuara.	15		Pranimi, paraditja e për dosjes K.Mjeksor.		

3	Shërbimet e komunitetit					
3.1	Fëmijët në punë			Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjar,it,	Sesione këshilluese individuale,familjare,ne procedure te tërheqjes se fëmijëve nga punët e rrezikshme,	
4.	Bashkëpunim me institucionet Publike.					
4.1	Shërbime për fëmijë në konflikt me Ligjin.	21		Vizite shtëpiake,sesion këshillues individual,familjare	.Sesion këshillues individual, familjar ,udhëzime për mos kryerjen e veprave dhe mbikëqyrjes prindërore,dërgimi i raportit social gjykatës	Raport per Gjykate-Kundervajtje,si dhe Masa Ok.
4.2	Prezantim në seanca Gjyqësore-Prokurori	49		.Prezantim ne seance gjyqësore,për te mitur,dhune ne familje si dhe adoptime.		
4.3	Prezantim në Polici.	23		Pjesëmarrje ne seance-intervistim ne polici,te mitur,	Pas intervistimit te gjithë te miturit lirohen	
5.	Shërbimet Tjera					
5.1.	Konsultim me palë	830		.Konsultime te ndryshme lidhur me rastet ne QPS,rastet e reja dhe atyre nen përcjelljemonitorim.		
5.2.	Vizita- familje, spital, QSHM, OJQ-ët etj	125		Vizitat shtëpiake,ne institucione për rastet e reja,te vjetra dhe me kolege.		

5.3	Vizita institucionale	6		Shtëpi te Pleve Prishtine,SHI Kamenice,Strehimore Liria ne Gjiilan.		
6.	Shërbimet Administrative					

6.1	Klient tjerë:Vërtetimet konstatimet zyrtare etj:	166		Klient tjerë, vërtetime, konstatime zyrtare etj.		
6.2	Shkollat-DKA	1		Raste te referimit-bashkëpunimit me shkollat.		
6.3	Futja e rasteve ne bazën e te dhënave	455		Futja e rasteve te reja ne bazën e te dhënave dhe shërbimeve e intervenimeve ne rastet e vjetra.		
6.4	DPSF-Prishtine	76		Njoftime ,referim,bashkpunim		
6.5	Bashkëpunim me QSHM	1		Referim te rasteve me qrregullime me ndore per trajtim.		
6.6	Bashkëpunim me Familjet strehuese	24		Bashkëpunim me familjet strehuese,konsultim për gjendjen e fëmijëve,pagesat etj.		
6.7	Bashkpunim me Ojq "Liria"-			Bashkpunime		
6.8	Bashkëpunim me QPS	23		Kontakttime për qeshte e adoptimit fëmijëfamilje..		
6.9	MVPT-Prishtine			Konsultime lidhur me rastin social		
6.10	SOS Fshati Prishtine	8		Vizite bashpunuese me SOS Fshatin e femijeve Prishtine lidhur me dy femijet e vendosur ne .		
6.11	Takime Ekipa vleresue DKA			Takime vleresuese neper shkolla-Seminar		
6.12	Trajnim	5		1.DPSF Baza fëmijëve ne pune- 1 zyrtar 2.Trajnim per temitur IKAP 3.Hartimi i strategjisë per shërbime sociale		
6.13	HHCH-Prishtine			Bashkpunime.3 fëmijë te strehuar dhe është bere bashkimi familjar.		
6.14	Komision mjekesor	2		10 kërkesa te shqyrtuara FFAK fëmijë.		

6.15	Seminar	2		1.Seminar "Trajtimi DPSF-Baza" 2."Autizmi"		
6.16	TMR					
6.17	Bashkëpunim me Gjykatën dhe Prokurorinë	15	12	Shkresa gjykatës për rastet pa adrese, konstatime zyrtare etj		

VII. DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në gjashtëmujorin e parë të këtij viti 2021, DUPMM ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë duke u bazuar në përshkrimin e punëve dhe detyrave punuese të secilit sektorë duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si dhe rregulloret komunale.

Duhet potencuar se pandemia ka ndikuar në masë të madhe tek qytetarët sidomos në pjesën e parë të vitit, kështu që kërkesa e qytetarëve ka pësuar një rënie të tepër të ndjeshme për t'u pajisur me kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Interesimi në aspektin e ndërtimit dhe planifikimit nga ana e qytetarëve të Gjilanit më vonë ka filluar të shtohet dhe të kthehet deri di kund trendi i ndërtimit si dhe pajisja me dokumentacion të ndërtimit konform planeve hapësinore. Ky aktivitetet ndikon direkt në të hyrat e Drejtorisë por edhe në ruajtjen e hapësirave të planifikuara. Ndërsa në bashkëpunim me MEA është duke vazhduar edhe faza e legalizimit të objekteve të kategorisë I dhe II që janë në kuadër të kompetencave të komunës në tërë zonën e qytetit.

Shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve të cilat drejtohen e parashtrihen në këtë institucion publik, bëhet konform ligjit dhe me efikasitet të plotë në afatin ligjor të përcaktuar dhe sipas prioritetëve. Përkushtimi i punës në DUPMM nga ana e zyrtarëve përgjegjës në kuadër të sektorëve sipas përshkrimit të detyrave të tyre është në nivelin e kërkuar përkundër kapaciteteve ekzistuese .

DUPMM-ja është në fazën e përfundimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) si dhe ka përfunduar draftin final të PZhK-së në bashkëpunim me kompaninë e kontraktuar konsulentë INSI nga Prishtina. Pas mbajtjes së dëgjimit publik dhe plotësimit të të gjeturave nga autoriteti mbikëqyrës është arritur të punohet edhe drafti final i cili pritet të aprovohet së shpejti në seancën e KK Gjilan. Për herë të parë PZhK është hartuar në bashkëpunim edhe me komunitetet si pjesë integruese e qytetit.

Harta Zonale e Komunës është pjesa detajuese ku në të cilën do të jenë në mënyrë specifike kushtet për zhvillimin e mëtutjeshëm si për ndërtim, infrastrukturë, ekonomi, kulturë, trashëgimi dhe në të gjitha sferat përkatëse të komunës dhe rrethinës së KK Gjilan. Vlen të theksohet që kushtet ndërtimore do të jepen edhe në zonat rurale dhe në këtë mënyrë do të përkujdesemi për ndërtimet ekzistuese dhe trendin e ndërtimit të mëtutjeshëm. Po ashtu

edhe për këtë strategji është punuar vlerësimi i ndikimit të saj në mjedis dhe aprovimi i tij në seancë të KK Gjilan por që në masë të madhe është prolonguar si proces për shkak të ndikimit direkt të pandemisë përgjatë vitit 2021.

Stafi përgjegjës për Legalizimin e objekteve është duke e vazhduar punën sipas ligjit të trajtimit të objekteve pa leje dhe të udhëzimeve administrative përkatëse. Vlen të theksohet që ndikimi i pandemisë është dukshëm i madh në vazhdimin edhe të këtij procesi.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT

1 Aktiviteteve e ndërmarra gjatë kësaj periudhe kohore nga Sektori i Planifikimit

- 1.1 Janë shqyrtuar, analizuar, reviduar dhe proceduar parcelime të trojeve, komisioni profesional, të infrastrukturës si dhe propozim zgjidhjet e hapësirave të ndryshme publike.

Tipologjia e lëndëve	njësia	Nr i lëndëve të shqyrtuara	Lëndët në proces të shqyrtimit
Parcelime	copë	7	12
Informata			
Komisioni profesional			
Propozim zgjidhje			

1.2 Plani Zhvillimor Komunal- i përfunduar drafti final

- 1.3 **Harta Zonale e Komunës- në proces.** Mbajtja e takimit me Ekipin Bazë (EB) dhe Ekipin Komunal të Planifikimit (EKP) lidhur me të arriturat, sfidat e paraqitura dhe paqartësitë lidhur me përpilimin e dokumentit në vazhdim deri në përfundim dhe futjes zbatim.

1.4 Hartimi i dokumentit të VSM-së për Planin Zhvillimor Komunal – i kryer

- 1.5 Menaxhimi i punëve në projektin “ Renovimi i Stadiumit të qytetit të Gjilanit “ - në proces
- 1.6 Hartimi i dokumentit “PLANI I MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM URBAN PËR KOMUNËN E GJILANIT” përgatitur nga Projekti i AKK-se me GIZ – i përfunduar.

Vërejtje: gjatë kësaj kohe është filluar procesi i Hartimit të Planit Lokal për Veprim në Mjedis, i cili për shkak të gjendjes së shpallur të pandemisë është ndërprerë për një periudhë të nevojshme. Komisioni së bashku me hartuesin e planit ka arritur të punoj deri në fazën e analizës së gjendjes dhe skenarëve, gjithashtu është bërë anketimi i qytetareve gjithsejtë 400 të anketuar.

- 1.7 Është bërë një numër i madh i parcelimeve, ekstrakteve nga Planet Urbanistike në zonën urbane dhe rurale, njoftimeve për palë, si dhe bashkëpunimi Institucioneve brenda dhe jashtë komunës

- 1.8 Caktimi i kushteve mjedisore në kuadër të PZhK, PZhU dhe PRRU.
- 1.9 Caktimi i kushteve për pajisje me leje mjedisore në varësi të planeve hapësinore.
- 1.10 Parku i Paqes të Livadhet e Arapit- projekti i përfunduar dhe i gatshëm për implementim,
- 1.11 Parku Baja të burimi i ujit Banja- projekti i përfunduar dhe i gatshëm për implementim
- 1.12 Parku i Pajtimit në Gllamë të Bresalcit- projekti i përfunduar dhe i gatshëm për implementim dhe
- 1.13 Lokacioni i ri i **varrezave të qytetit** i propozuar në planin e ri komunal. Në projekt janë paraparë edhe objektet për rite të ndryshme me të gjitha pjesët përcjellëse. Zgjidhja e problemit të varrezave është bërë për së paku 100 vjet.
- 1.14 Caktimi i lokacionit për objektin e **agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë**- AUV, ndërsa ky objekt parashihet të implementohet nga Komisioni Evropian. Ky objekt do të ketë karakter rajonal dhe do të shërbejë për tërë zonën. Lokacioni i ri është përcaktuar në pronën që është në shfrytëzim nga konvikti turk. Nga kjo parcelë do të ndahen 15 ari për këtë qëllim.
- 1.15 Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për intervenim në **shtratin e lumit në Cërnicë** dhe mbrojtja e tokave bujqësore. Granti i siguruar nga BE në bashkëpunim me zyrën konsulentë të KK. Projekti i filluar në implementim dhe në fazën përfundimtare.
- 1.16 Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për intervenim në objektin e shkollës së muzikës dhe ridestinimi i saj në **muzeun etnografik**. Granti i siguruar nga BE në bashkëpunim me zyrën konsulentë të KK. Projekti i filluar në implementim dhe në fazën përfundimtare.
- 1.17 Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit të tregut të kafshëve. Granti i siguruar nga BE në bashkëpunim me zyrën konsulentë të KK. Projekti i filluar në implementim dhe në fazën përfundimtare.
- 1.18 Përzgjedhja me konkurs e projektit ideor të Administratës së përgjithshme të KK Gjilan. Në vazhdim detalizimi i projektit kryesor/ zbatues dhe përgatitja për koncesion për shkak të buxhetit të lartë për KK Gjilan.
- 1.19 Përzgjedhja me konkurs e projektit ideor të rigjenerimit urban në zonën qendrore të qytetit së bashku me degëzimet përkatëse të aksit kryesor. Në vazhdim detalizimi i projektit kryesor/ zbatues dhe përgatitja për implementim.
- 1.20 Vlerësimi i punimeve të kryera në disa objekte, prerja e punimeve apo procese përfundimtare.

Mbikëqyrjet, Menaxhimet, Komisionet dhe Pranimet Teknike

Mbikëqyrje e punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës (përmes kompanisë së kontraktuar)

Menaxhimi i punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës

Mbikëqyrje e procesit të Planeve Rregulluese të Hollësishme

Komisionit Ad hoc për zhvillimin e procedurave të emërimit me afat të caktuar – marrëveshje për shërbime të veçanta

Pranim teknik të projekteve të implementuara nga KK Gjilan.

Aktivitete tjera

Shqyrtimi i pikave grumbulluese të mbeturinave në KK Gjilan

Azhurnimi dhe mirëmbajtja e platformës GIS

SEKTORI I LEJEVE TË NDËRTIMIT

Aktivitet të cilat kryhen në kuadër të sektorit.

Përcakton kushtet urbanistike dhe arkitektonike për hartimin e dokumentacioneve investivoteknike për ndërtimin e objekteve lidhur me realizimin e projekteve kryesore urbanistike dhe zgjedhjet e tyre arkitektonike;

Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro urbane në territorin e qytetit dhe komunës;

Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale dhe zhvillimeve të tjera;

Organizon dhe kontrollon dokumentacionin teknik
Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi; Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;

Programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në territorin e komunës;

Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;

Zbaton programet e sektorëve të tjerë të administratës komunale në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale si dhe Rregulloret komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie;

Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridik nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme, për punën e udhëheqjes komunale.

Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;

Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi dhe veçmas me rregulloren dhe manualin për legalizim;

Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim; Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore dhe me të gjitha subjektet tjera përkatëse;

Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;

Kryen detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore, akte nënligjore dhe rregullore komunale dhe të deleguara.

Aktivitet të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe

Punë në zyre shqyrtimi i lëndës

Punë me palë dhe shqyrtim i kërkesave

Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve për plotësimin e lëndës

Takime të ndryshme zyrtare dhe aktivitet punuese
 Jep pëlqime për ndërtimin, Kontrollon dokumentacionin teknik
 Në terren sipas kërkesës së qytetarëve dhe vizita në vendin e ngjarjes

Llojet e kërkesave:

Kërkesa për Ekstrakt nga Plani
 Kërkesa për Parcelim të truallit
 Kërkesa për objekt të karakterit të përkohshëm të tipit montues
 Kërkesa për kushte Ndërtimi
 Kërkesa për rekonstruim, aneks ndërtim, shtim, mbindërtim, e forma të tjera të ndërhyrjeve në ndërtesën ekzistuese
 Kërkesa për Leje paraprake
 Kërkesa për Leje Ndërtimi
 Kërkesa për Kontrollim teknik- Leje të përdorimit
 Kërkesa për ndërtim të objekteve të përkohshme – ndihmëse, në vend ndërtim
 (Objektet e përkohshme – ndihmëse në vend ndërtim kërkojnë Leje të Veçantë nëse e cenojnë shëndetin e njerëzve, trafikun – qarkullimin dhe mjedisin si në rastet e mëposhtme):
 Kërkesa për Leje Rrërimi-Demolimi të objektit
 Kërkesa për Vlerësim dhe konstatim të gjendjes së objektit
 Kërkesa për ndërtim të objekteve të Infrastrukturës komunale: (rrugë, ura, hapësira gjelbëruese, hapësira për sport dhe rekreacion, rrjet të energjisë, ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, PTK dhe përçuesve tjerë;

Pranimi i kërkesave në Sektorin Leje Ndërtimit

Parcelim të truallit	51
Kushtet e Ndërtimit	69
Leje ndërtimi	61
Leje të Përdorimit	2
Leje Rrërimi	16
Ankesa	34
Lëndë të vitit 2020	33
Gjithsejtë	266

Kërkesat e shqyrtuara

Parcelim të truallit	83+7(planifikimi)=90
Kushtet e ndërtimit	40
Leje ndërtimi	49
Leje përdorimit	5
Lajmërimet (Konkluzat)	15

Leje rrënimi	10
Refuzimet e kërkesave	3
Gjithsejtë kërkesa janë shqyrtuar	212
Gjithsejtë kërkesa janë në shqyrtim	54

Pranimi i kërkesave në Sektorin Legalizimit

Aplikimi për certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m2)
..... 250

Aplikimi për leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I (përveç depove deri 1500 m2) dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m2)..... 3

Aplikimi për certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë) (për ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara)..... 15

Gjithsejtë 268 kërkesa

Kërkesat e shqyrtuara në Janar- Qershor 2021

Certifikatë të legalizimit për kategorinë I dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m2)
..... 155

Leje të legalizimit për përfundim të ndërtimit për kategorinë I (përveç depove deri 1500 m2) dhe shtëpitë e kategorisë II (mbi 450m2)..... 0

Certifikatë të legalizimit për kategorinë II (jo shtëpitë) (për ndërtimet e përfunduara ose substancialisht të përfunduara)..... 19

Listë e Pritjes 9

Gjithsejtë 183 kërkesa

Raporti i të hyrave (euro) për këtë periudhë:

Muaji	Leje ndërtimi	Leje Legalizimi	Leje Mjedisore	Taksa rrënimi	Taksa kërkesave	Totali
Janar	46,803.89	2,178.54	386.00	-	96.00	49,464.43
Shkurt	2,782.41	12,988.53	0,00	59.36	129.00	15,959.30
Mars	6,071.08	9,317.20	0,00	959.36	224.00	16,571.64
Prill	83,153.12	5,372.67	6,771.00	763.09	142.00	96,201.88
Maj	31,255.52	3,151.98	4,835.00	649.63	120.00	40,012.13

Qershor	154,614.77	3,391.18	12,143.00	212.00	160.00	170,520.95
Totali	324,680.79	36,400.10	24,135.00	2,643.44	871.00	388,730.33

VIII. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Në sferën e ndërtimit është bërë: inspektimi i rasteve në proces të ndërtimit, ndërprerja e punimeve ndërtimore, shiritimi i objekteve, dorëzimi i vendimeve për ndërprerje të punëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve, inicimi i procedurave gjyqësore për kundërvajtje, nxjerrja e vendimeve për rrënim etj..

Në sferën e tregut është bërë: identifikimi i bizneseve të cilat nuk janë të regjistruara në M.T.Isë, identifikimi i bizneseve të cilat nuk kanë pranim teknik të lokalit, etj..

Në sferën e shërbimeve publike, komunikacionit dhe ambientit është bërë: inspektimi i hapësirave publike dhe trotuareve për kushte të dimrit, inspektimi i hedhjeve të mbeturinave jashtë kontejnerëve, inspektimi i bartjes publike të udhëtarëve me autobus, me taksì, inspektimi i transportit të mallrave, inspektimi i sinjalizimit, inspektimin e parkimeve të veturave taksì, inspektimi dhe vëzhgimi i problemeve që kanë me hedhjen e mbeturinave, inspektimi dhe djegia e mbeturinave, inspektimi dhe djegia e thëngjillit, inspektimi i pikave grumbulluese të metaleve, inspektimi i ndotjes akustike, etj.

Në sferën e veterinës, bujqësisë dhe sanitarisë është bërë: kontrollimi i therjeve të kafshëve në thertore të licencuara, inspektimi i mishtoreve, fabrikave për përpunimin e mishit, thertoreve të shpezëve, industrive të përpunimit të qumështit, inspektimi i subjekteve afariste ushqimore, inspektimi i afatshmërisë së artikujve ushqimor me prejardhje bimore dhe shtazore, inspektimi i kushteve higjieniko-sanitare, inspektimi i furrave të bukës, inspektimi i restoranteve, hoteleve, qebaptoreve, gjellëtoreve dhe lokalet e ushqimeve të shpejta etj..

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe inspektorët e tregut dhe të sanitarisë kanë qenë të angazhuar një javë me orar të paradites dhe një javë me orar të pasdites për parandalimin e përhapjes së sëmundjes Covid 19.

Inspeksioni i ndërtimit :

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e sektorit të inspeksionit të ndërtimit, gjatë kësaj faze - (Janar-Qershor 2021), janë kryer këto punë: Inspektim të rasteve në proces të ndërtimit, hartim të procesverbaleve-ndërprerje të punimeve ndërtimore, hartim të procesverbaleve – shiritim të objekteve, dorëzim të vendimeve për ndërprerje të punëve, pranim-shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptim i gjobave ndaj kundërvajtësve, inicim të procedurave gjyqësore për kundërvajtje, vendime për rrënim si dhe pranimin-evidencimin dhe kontrollimin e Lejeve ndërtimore të pranuar nga sektori i lejeve.

Nr.	Përshkrimi i punës	Numri
1.	Procesverbale	80
2.	Procesverbale për ndërprerje të punimeve	31
3.	Aktvendime për ndërprerje të punëve	32
4.	Inspektim i objekteve me leje ndërtimi	26
5.	Procesverbale për ndërprerje të punëve tejkalim i Lejeve Ndërtimore	4
6.	Përgjigje ndaj kërkesave për insp të punimeve ndërtimore	171
7.	Përgjigje ndaj ankesave të qytetarëve	10
8.	Gjoba mandatore	13 (13,050.00€)
9.	Numri i rrënimeve	11
10.	Konkluzione për Rrënim	4
11.	Numri i Lejeve Ndërtimore të pranuar nga DUPMM	LN - 49 K.N. - 38 LRR - 5 SHBA - 4 RK - 3
12.	Totali i të hyrave për sektor	13,050.00 €

Inspeksioni i tregut :

Gjatë kësaj periudhe kryesisht jemi fokusuar në identifikimin e Bizneseve të reja, të pa pajisur me certifikatë mbi regjistrimin e biznesit. Po ashtu gjatë kësaj periudhe, palët janë udhëzuar që të njëjtët të futen në regjistrim të biznesit përmes Q.R.B, duke kërkuar nga bizneset që në afat të caktuar për regjistrim kryesisht 8 (tetë) ditë. Pastaj jemi fokusuar në subjekte të cilat nuk janë të pajisur me aktvendim në D.I, ku me kërkesë të qytetarëve kemi bërë edhe grumbullimin e mjeteve të cilat janë derdhur në xhirollogarinë e Komunës.

Jemi përgjigjur çdo ankesë apo kërkesë të qytetarëve të cilat kanë hasur në probleme me subjekte, ku për secilin rast kemi hartuar edhe procesverbal dhe kemi bërë përgjigje përmes vijës zyrtare.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi qenë të angazhuar një javë me orar të paradites dhe një javë me orar të pasdites për parandalimin e përhapjes së sëmundjes Covid 19.

Nr.	Numri i:	
1.	Inspektimeve pa procesverbal	323
2.	Inspektimeve me procesverbale	148
3.	Kërkesave të refuzara të pranimeve teknike	7
4.	Procesverbaleve të pranimeve teknike	80 (3,020.00 €)
5.	Kërkesave të pranuar	11
6.	Kërkesave të shqyrtuar	11
7.	Aktvendimeve për pranimet teknike	73
	Totali i të hyrave për sektor	3,020.00 €

Prej datës 04.06.2021 në bazë të vendimit komunal 02.nr. 361 të datës 25.05.2021 pranimet teknike janë pa pagesë.

Inspeksioni i Shërbimeve Publike, Komunikacionit dhe i Ambientit:

Inspektorët e Shërbimeve Publike në këtë periudhë janë marrë me inspektimin dhe vëzhgimin e problemeve që kanë të bëjnë me shërbimet publike në Komunën e Gjilanit. Gjatë kësaj periudhe kryesisht janë inspektuar shfrytëzimi i hapësirave publike, shfrytëzimi i hapësirave publike nga kafiteritë për sezonin dimëror, ndërhyrjet në infrastrukturën publike, kyçjet në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit si dhe keqpërdorimet e ujit të pijshëm etj.

Inspektorët e Komunikacionit - gjatë kësaj periudhe janë marrë me inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve me autobus, me taksì, me inspektimin e transportit të mallrave, me inspektimin e sinjalizimit si dhe me inspektimin e parkimeve të veturave taksì. Kanë bashkëpunuar me Policinë e Kosovës për të organizuar inspektime për kontrollin e bartjes publike të udhëtarëve nga operatorët legal dhe ilegal si dhe për transport të mallrave. Kanë qenë pjesë e komisioneve për projekte të vogla, pjesë e komisionit për pranimet teknike, pjesë e komisionit për riorganizimin e rrugëve në komunën e Gjilanit etj.

Inspektorët e Mbrojtjes së Mjedisit janë marrë me inspektimin dhe vëzhgimin e problemeve që kanë të bëjnë me Mbrojtje të Mjedisit si në zonën urbane ashtu edhe atë rurale të Komunës së Gjilanit. kanë bërë shqyrtimin e ankesave zyrtare dhe verbale që kanë të bëjnë me hedhje të mbeturinave, ndezje të mbeturinave, ndërhyrje në hapësira të gjelbërta, inspektim për eksploatimin e resurseve natyrore, thertoreve, inspektim për Leje Mjedisore Komunale,

Gjithashtu kemi bashkëpunuar me Inspektorët e Mbrojtjes së Mjedisit, Inspektorët e Mbrojtjes së Ujërave në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura MMPHI si dhe me Inspektorët nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Monitorimi i deponive ilegale në bashkëpunim me GIZ-Gjerman në kuadër të projektit “Shërbimet e Qëndrueshme Komunale”. Takim informues me përfaqësues nga zyrat e EULEX-it.

Të gjithë inspektorët kanë bashkëpunuar: në inspektimin e hapësirave publike, në inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve dhe të transportit, në inspektimin e objekteve të cilat duhet të pajisen me Leje Mjedisore, në inspektim e lokalet afariste për përmbushjen e kushteve teknike, asistencë në sferën e ndërtimit, asistencë në sferën e veterinarisë, në shqyrtimin e kërkesave të palëve, etj..

Raporti detal për inspeksionin e shërbimeve publike, komunikacionit dhe për ambient :

Nr.	Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre	
1.	Numri i inspektimeve	187
2.	Numri i procesverbaleve	95
3.	Numri i kundërvajtjeve	09
4.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara në sferën e komunikacionit	2 (80 €)
5.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për hedhje të mbeturinave	4 (530 €)
6.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për ndezje të mbeturinave	5 (900 €)
7.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për ndërhyrje në hapësirë gjelbëruese	1 (100 €)
8.	numri i gjobave mandatore të shqiptuara në sferën e shërbimeve publike	1 (100 €)
9.	Numri i automjeteve të përjashtuara nga komunikacioni	02
10.	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	06
11.	Numri i kërkesave të pranuar	28
12.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	20
13.	Numri i kërkesave të cilat janë në shqyrtim	08
	Totali i të hyrave për sektor	1,710.00 €

Inspeksioni i Veterinarisë, Sanitarisë dhe Bujqësisë:

Duke u bazuar në planin veprues është bërë Inspektimi i subjekteve afariste ushqimore, damkosja e mishit në thertoret e licencuara, Inspektimi i furrave të bukës si dhe mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Anti Covid 19 dhe vendimeve tjera nga AUV dhe Ministria e Shëndetësisë.

Inspektori Fito sanitar nga data 25.06.2021 deri më 30.06.2021, ka monitoruar procesin e Dezinfektimit hapësinor faza e parë. Inspeksioni veterinar në vazhdimësi është duke e zbatuar vendimin e AUV të datës 27.05.2021, për ndalimin e lëvizjes së shpezëve në territorin e Republikës së Kosovës.

Inspektori Fito sanitar në bashkëpunim me Inspektorët e tregtisë dhe Inspektorët sanitar nga AUV-i të caktuar për parandalimin e Covid 19, në sistem të kujdestarisë, ku janë kryer 124 Inspektime, 80 Vërejtje, 1 Dënim, 1 Procesverbal, 2 aksione me Policinë e Kosovës Më 02.06.2021 është bërë groposja e pulave në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi Komunal si varrezë e kafshëve. Me 01.02.2021 është bërë asgjësimi i 12 (dymbëdhjetë) krerë gjedhe të konfirmuara pozitive me sëmundjen e Brucelozës në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi Komunal Gjilan .

Asgjësimi është kryer në bazë të vendimit me numër AUV 04/1-068/21 të datës 01.02.2021, në bashkëpunim me Inspektoret Veterinar të AUV.

Në vijim është bërë paraqitja tabelare e aktiviteteve të realizuara:

Natyra e punës	Numri	Vërejtje
Kontrollime-Inspektime	118	
Procesverbale	94	
Dënime	2	1,000.00 €
Therje të kafshëve	1368	6,786.00 €
Transport të kafshëve	38	38.00 €
Përgjigje kërkesave të qytetarëve	5	
Pëlqim për Barnatore Bujqësore	2	
Pëlqime Sanitare	24	190.00 €
Asgjësim i mallit të dëmtuar dhe me afat të skaduar -me kërkesë të subjektit afarist	5 kërkesa 13.955 Kg	110.00 €
Vendime për izolim COVID-19	3472	
Vendime për shërim COVID-19	3316	
Pjesëmarrje në Pranime teknike të lokaleve	20	/
Pjesëmarrje në Inspektime me AUV	52	
Shuma e taksa të grumbulluara	Totali:	8,314.00 €

Taksat e grumbulluara nga transporti i kafshëve shkojnë në xhirollogarinë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës.

Raporti 1 Janar -30 Qershor 2021 :

Nr.	Aktiviteti	Numri	Shuma €
1.	Numri i procesverbaleve	417	
2.	Numri i kundërvajtjeve	32	
3.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara në sferën e ndërtimit	13	13,050.00 €
4.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara në sferën e shërbimeve publike	1	100.00 €
5.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara në sferën e komunikacionit	2	80.00 €
6.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për hedhje të mbeturinave	4	530.00 €
7.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për ndezje të mbeturinave	5	900.00 €
8.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara për ndërhyrje në gjelbërim	1	100.00 €
9.	Numri i automjeteve të përjashtuara nga komunikacioni	02	
10.	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	04	
11.	Numri i konkluzave të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit - rrëtime	04	
12.	Numri i rrëtimeve	11	
13.	Numri i therjeve të kafshëve	1368	6,786.00 €
14.	Numri i lejeve ndërtimore të pranuar nga DUPMM	49	
15.	Numri i kërkesave të pranuar	377	
16.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	343	
17.	Numri i kërkesave të në shqyrtim	34	
18.	Numri i kërkesave të refuzuara	9	
19.	Numri i vendimeve të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit	2	
20.	Numri i aktvendimeve të lëshuara nga Drejt. e Ins. për sferën e ndërtimit	32	
21.	Numri i aktvendimeve të lëshuara nga Drejt e Insp. për sferën e tregut	80	3,020.00 €
22.	Numri i pëlqimeve sanitare të lëshuara nga Drejtoria e Inspeksionit	26	190.00 €

23.	Numri i kërkesave për asgjësim të mallit	5	110.00 €
24.	Numri i autorizimeve të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit	2	
25.	Numri i kërkesave të Drejtorisë së Inspeksionit	6	
Totali i të hyrave në Drejtorinë e Inspeksionit			24,866.00 €

IX. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës gjashtë mujore ka kryer këto punë:

- Raportin final financiar 2020 për Kuvend
- Raportin financiar tremujor (3) për Kuvend
- Koordinimin e punëve mes Komunës së Gjilanit dhe Zyrës kombëtare të auditimit
- Kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024
- Shpërndarja e mjeteve të bartura nga viti 2020
- Përgatitja për kuvend, aprovimi dhe përcjellja e kërkesës në MF për transferin e mjeteve,
- Formimi i dokumentacioni për kode të projekteve dhe alokimin e tyre nga MF
- Analiza e alokimeve buxhetore si p.sh. raporti i alokimeve për Paga&Mëditje, Mallra&Shërbime, Komunali, Investime Kapitale dhe Subvencione.
- Kemi punuar nënlokimet mujore për Paga&Mëditje, Mallra&Shërbime dhe Komunali për çerdhet, arsimin fillor dhe të mesëm (analitikë për çdo çerdhe, konvikt dhe shkollë).
- Analiza e Paga&Mëditje për të gjitha programet buxhetore.
- Formimin e dokumentacionit nga participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe alokimin e mjeteve.
- Bashkëpunimi i ngushtë me auditorët si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm
- Pranimi i të gjitha raporteve të të hyrave nga BQK
- Përpunimi i të gjitha të hyrat sipas kodeve dhe drejtorive.
- Regjistrimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve në SIMFK.
- Përgatisim për të gjitha drejtoritë informata mujore si për te hyra ashtu edhe për shpenzime
- Bëjmë barazime ditore me BQK dhe bankat komerciale.
- Barazime mujore me MF-Thesar
- Barazime tre mujore me MF, zyrën e alokimeve.
- Përgaditim në baza ditore raporte për të hyrat për secilën drejtori.
- Përgatisim UNIREF-at për të gjitha faturat e drejtorive
- Mbajmë evidencë analitike për çdo lloj të hyre
- Mbajmë evidencë analitike për të gjitha shpenzimet.
- Shtypim listat e pagave të dërguara nga Menaxheri i zyrës Personelit i dërgojmë për verifikim nga drejtorët përgjegjës dhe nënshkruhen nga shërbyesit civilë me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i kryejnë vet.
- Gjatë kësaj periudhe kemi:

▪ Lëndë të certifikuara dhe arkivuara **2635**

- Kemi bërë shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë (**27265 fatura**)
- Gjatë punës vjetore bëjmë shtypen e faturave të Tatimit në Pronë me kërkesë të tatimpaguesve dhe lëshojmë vërtetime të ndryshme .
- Janë regjistruar **457** objekte të reja. Janë verifikuar afro **809** objekte ekzistuese
- Në këtë periudhë kemi pranuar dhe shqyrtuar të gjitha ankesa e qytetarëve ▪
Përcjellim regjistrimin dhe transferet e inventarit

Për periudhën gjashtë mujore (6) për 2021, kemi këtë gjendje të të hyrave dhe shpenzimeve në DBF:

Të hyrat e Tatimit në Pronë

	Planifikimi 2021	Realizimi i të hyrave Janardhjetor 2020	Realizimi i të hyrave Janar Qershor 2021	Krahasimi mes realizimit 2020 dhe 2021	% në mes planifikimit dhe realizimit 2021
Të hyrat nga tatimi në Pronë	1,856,707.00€	533,315.14€	1,160,932.80€	217.68	62.52

- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka shpenzuar:**
- -Pagat 88,266.84€
- -Mallra dhe shërbime 12,767.98€
- -Shpenzime komunale 2,858.61€
- **Gjithsej shpenzimet: 103,893.43€**


X. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Gjatë këtij gjysmën viti edhe Komuna e Gjilanit po vazhdon të përballet me pasojat e pandemisë, e cila u reflektua në ekonomi, duke shkaktuar krizë ekonomike dhe rënie të aktivitetit ekonomik.

Komuna ka ndërmarrë disa veprime për të krijuar lehtësira për bizneset, siç janë lirimi nga taksa komunale, lirimi nga qiraja e lokaleve, hapësirave publike dhe banesave në pronësi komunale, nga pagesa për pranim teknik dhe pëlqimet sanitare.

Sektori më i prekur është gastronomia.

Sa i përket bizneseve të reja, edhe sivjet numri është më i lartë se vitin e kaluar. Gjatë kësaj kohe, ndonëse në kushte pandemie, janë hapur 285 biznese të cilat kanë punësuar 445 punëtorë, ndërsa janë mbyllur 61 biznese dhe janë çregjistruar 94 punëtorë.



Jemi të vetëdijshëm se bizneset edhe pse po përballen me pasojat e pandemisë, janë duke bërë përpjekje ekstreme për mbijetesë dhe një numër i konsiderueshëm i tyre vazhdojnë t'i mbajnë punëtorët në punë.

Kjo situatë jep shpresë dhe optimizëm për normalizim në një të ardhme të afërt.

Drejtoria ka bërë përpjekje të vazhdueshme në përkrahje të bizneseve duke ofruar asistencë profesionale bizneseve në pesë (5) thirrjet për grante nga Institucionet e ndryshme.



Një prej thirrjeve publike për grante që kanë mbështetur financiarisht bizneset NVM dhe Bizneset në pronësi të grave ndërmarrëse është edhe skema “Gratë në energji”, Kjo skemë e granteve financohet nga Fondacioni “Mileniumi i Kosovës” me bashkëfinancim nga Komuna e Gjilanit, ndërsa zbatohet në partneritet me organizatën gjermane “Help”. Në kuadër të këtij programi, gjatë muajit Maj 2021 janë organizuar dy (2) sesione informuese për gratë ndërmarrëse në efikasitet dhe teknologji. Sesioni i parë është mbajtur me 20 Maj 2021 në Zhegër, ndërsa tjetri me 26 Maj 2021 në Gjilan i cili për qëllim ka efikasitetin e energjisë, teknologjinë e avancuar dhe planifikimin e

qëndrueshëm. Gjatë sesioneve informuese aplikuesit potencial

kanë marrë informacion në detaje për mënyrën e aplikimit, përparësitë dhe domosdoshmëritë që ka gjatë aplikimit për grant dhe bashkëpjesëmarrjes si dhe kriteret për aplikim.

Drejtoria gjatë këtij procesi ka qenë asistues dhe mbështetës direkt të grave aplikuese në mënyrë që të ketë sa më shumë përfituese. Gjithsej 109 gra ndërmarrëse kanë dorëzuar aplikacionet e tyre dhe gjatë kësaj periudhe ka filluar procesi i vlerësimit. Vlera mesatare e një granti, për një përfitues, është deri në 3,000 Euro, shumë kjo e cila përfshinë edhe kontributin nga përfituesit prej 15%. Krahas pajisjeve, përfituesve do t'u ofrohen edhe trajnime profesionale dhe mbështetje teknike pasi të kenë pranuar pajisjet. Pajisjet duhet të jenë vetëm ato pajisje që kursejnë energjinë.

Thirrjet tjera për grante bizneseve ku drejtoria ka ofruar asistencë teknike gjithsej 146 bizneseve në përgatitjen e aplikacioneve përmes takimeve individuale si dhe në platformën Online janë paraqitur si në vijim:

- Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës – thirrje e publikuar me datë 28.01.2021 – “Aplikimi për Fuqizimin Ekonomik të Gruas – Programi Për Rimëkëmbjen Ekonomike” Masa 10 – Faza II – Masa 4, ku në këtë thirrje në kemi ndihmuar 5 gra ndërmarrëse.
- Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – thirrje e publikuar me datën 12.02.2021 – “Thirrje publike për subvencionimin me mjete financiare për NMVM”, ku në këtë thirrje kemi ndihmuar 4 aplikues.
- Fondacioni i Mileniumit i Kosovës dhe Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit – thirrje e publikuar me datën 11.01.2021 – “Thirrja për aplikime për grante për gratë ndërmarrëse në Energji” - ku në këtë thirrje në kemi ndihmuar 5 aplikues.
- Ministria e Zhvillimit Rajonal – kemi 2 thirrje në kuadër të ministrisë të publikuara me datën 05.03.2021 – Skema e Granteve “Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar” PZHRB 2021 (Lot 1 Start Up dhe Lot 1 Biznes Ekzistues) nga ku Lot 1 Start Up kemi 8 aplikues dhe Lot 1 Biznes Ekzistues kemi 6 aplikues dhe thirrja e dytë është Skema e Granteve “Programi

i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021” Masa 15 (Lot II dhe Lot III) ku nga Lot 2 kemi 1 aplikues dhe nga Lot 3 kemi 4 aplikues.

Gjithashtu, Komuna e Gjilanit dhe organizata gjermane “HELP” kanë mbështetur familjen nga fshati Livoq i Epërm, e prekur nga humbja e dy anëtarëve të familjes gjatë tërmetit të vitit 2019 në Shqipëri. Pas përfundimit të trajnimit për dy përfitueset e grantit në formë të pajisjeve të cilave u janë siguruar pajisjet e nevojshme për të zhvilluar aktivitetin biznesorë në sektorin e parukerisë përmes së cilit mund të pavarësohen financiarisht. Së shpejti planifikohet të hapet biznesi i ri me lokal në Gjilan me ane të të cilit do të mundësohet vet-punësimi i dy zonjave vet-ushqyese si dhe pritjet të gjenerojnë të ardhurave për gjashtë fëmijët dhe familjen e tyre.

Përmes realizimit të këtyre aktiviteteve Drejtoria synon zbatimin e Strategjisë lokale “Gratë në Ndërmarrësi” dhe se punohet në mënyrë sistematike me qëllim të përmirësimit të ekosistemit për nxitjen e ndërmarrësisë sidomos tek te rinjtë dhe gratë.

Zyrtarët e Drejtorisë janë duke punuar në terren për mbledhjen e të dhënave rreth bizneseve aktive në Komunën e Gjilanit dhe deri me tani janë vizituar dhe regjistruar në databazë 769 biznese, derisa është në fazën përgatitore analiza mbi nevojat e bizneseve për fuqi punëtore, sipas kërkesave të sektorit privat.

Edhe përkundër sfidave me pandeminë, drejtoria ka arritur me sukses të realizojë objektivat e planifikuara. Një ndër sukseset kryesore është ai i sektorit të EE me 6 projekte, të cilat janë në faza të auditimit të energjisë dhe dizajnimit si parakushte për fillim të realizimit, me mbështetjen e KfW, FKEE, dhe MFK. Në muajin e ardhshëm pritet të nënshkruhet Marrëveshja për financim ndërmjet KfW dhe Komunës së Gjilanit, derisa në muajin Gusht pritet të shpallet tenderi për realizimin e punimeve, pra masat e EE në shkollën “ Ibrahim Uruqi”, Bresalc, shfmu “liria”, Pogragjë dhe “Vuk Karagjiq’ në Kmetoc dhe punimet do të përfundojnë gjatë vitit 2022.

Gjate këtij gjysmë viti drejtoria në bashkëpunim me organizatën gjermane “Help” janë duke zbatuar dhe bashkë-financim komponentën e granteve të financuar nga MFK Gratë ndërmarrëse në Energji ku do të përfitojnë 20-25 gra afariste nga Komuna e Gjilanit, grante në shumën prej 3,000 Euro për pajisje që kursejnë energjinë. Ky aktivitet do të përfundojë në fund të muajit Shtator.

Gjatë kësaj periudhe do të intervenohet me masa të EE në banimin individual duke trajtuar me prioritet katër (4) familje raste sociale përmes programit të MFK SEEK HER.

Sa i përket investimeve kapitale, janë 7 projekte në realizim e sipër, në bashkëpunim me donatorët: Tregu i kafshëve, Muzeu etnografik, Rruga në Pogradë, shtrati i lumit në Cërrenicë, Tregu i gjelbërit, derisa është përfunduar projekti Tregu dhe Parku në Zhegër si dhe pritet të filloj realizimi i Qendrës kulturore për Komunitete të përzgjedhur për financim pas aplikimit në thirrjen e MZHR Investime kapitale 2021. Vlen të përmendim se drejtoria ka aplikuar edhe me një projekt tjetër në fushën e EE në objekte shëndetësore dhe edukative tek qeveria Japoneze dhe presim të rezultojë i suksesshëm. Gjithashtu, Drejtoria ka aplikuar në thirrjen e hapur publike për pjesëmarrje në Programin Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2) në Kosovë.

Kjo thirrje synon të krijojë partneritet me 7 komuna në Kosovë përmes një skeme grantesh për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe organizatat rinore, duke zgjeruar marrëdhëniet ndërmjet qeverisë lokale-OSHC, përmirësimin e shërbimeve cilësore të OSHC-ve dhe promovimin e iniciativave rinore dhe perspektivat e tyre ekonomike. Kjo është një iniciativë 4-vjeçare rajonale (2021 – 2024), e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP në 6 përfitues të IPA-s nga Ballkani Perëndimor, do të zgjerojë aktivitetet e saj përmes përfshirjes së përfituesve të rinj (komuna dhe OSHC) dhe duke përfshirë aktivitete të reja siç janë mbështetja për iniciativat rinore dhe qasja më e përshtatur për ndërtimin e kapaciteteve në mbështetjen e OSHC-ve. Drejtoria ka dorëzuar aplikimin me 21 Qershor 2021. Më 19 Shkurt 2021 DZHE, sipas kërkesës së Ministrisë së Pushtetit Lokal në kontekstin e strategjisë së qeverisë për të adresuar ndikimin e pandemisë COVID-19, në bashkëpunim me Bankën Botërore është duke hartuar projektin 'Rimëkëmbja Gjithëpërfshirëse Ekonomike Lokale' me qëllim promovimin e veprimit të shpejtë lokal, që kontribuojnë në një rimëkëmbje të qëndrueshme ekonomike duke krijuar kushte për rritjen e vendeve të punës. Drejtoria ka përgatitur projekt propozimin pas analizimit të nevojave të Komunës për investime të menjëhershme si pjesë e rimëkëmbjes nga COVID-19. Propozimi i drejtorisë pas identifikimit të nevojave të komunës për mbështetje nga fondet publike në kuadër të projektit të Bankës botërore që fokusohen në promovimin e punësimit përmes rritjes ekonomike lokale janë si në vijim:

A1. Pastrimi i lumenjve me qëllim punësimin e punëtorëve të pakualifikuar të regjistruar në Qendrën Rajonale të Punësimit si dhe punëtorët të cilët kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë (punëtorë krahu pa kontrata të rregullta pune).

A2. Përmirësimin e kushteve për rritje të produktivitetit dhe efikasitetit të fermerëve përmes sigurimit të pajisjeve bujqësore, subvencionimin e fidanëve, plehrave artificial me qëllim zëvendësimin e importeve. Një tjetër aktivitet në fushën e bujqësisë, pyllëzimi i tokave me qëllim parandalimin e degradimit të tokës dhe ruajtjen e ambientit. Këto dy mase do të ndikojnë në rritjen e vet-punësimit të fermerëve dhe bizneseve familjare si një mundësi për gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe krijimi i të hyrave për familjet e tyre.

A3. Krijimi i infrastrukturës publike, ndërtimi i objektit Qendër Inovacioni (TIK). Komuna e Gjilanit ka potencial real për promovimin dhe inkurajimin e krijimit të bizneseve të reja në fushën e TIK. Në Gjilan ekziston UP, drejtimi "Shkenca kompjuterike" me rreth 600 studentë të cilët janë potencial dhe një numër i madh i të rinjve aktiv në këtë fushë shfrytëzojnë

hapësirat e ICK në Prishtinë në mungesë të infrastrukturës publike në Gjilan. Komuna ka përgatit infrastrukturën ligjore për licencim të QI dhe pas sigurimit të objektit do të jetë në gjendje ta funksionalizoj brenda një periudhe të shkurtër kohore, jo me shume se 1-2 muaj. QI do të krijoj mundësi për krijimin e bizneseve të reja në TIK si dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

A4. Skema të granteve dhe subvencionimi i mikro-bizneseve sidomos në sektorin e shërbimeve si gastronomi dhe artizanate. Për më shumë informata në lidhje me këtë aktivitet po ju përcjellim linkun ku mund të referoheni të gjeturave nga hulumtimi i realizuar me biznese për vlerësimin e ndikimit COVID 19 në ekonominë lokale . Sipas rezultateve të hulumtimit bizneset më të rrezikuara janë bizneset mikro dhe sektorët më të ndikuar negativisht janë: gastronomia, transporti, ndërtimtaria etj. <https://kk.rksgov.net/gjilan/zhvillim-ekonomik/raportet/?page=2020>

A5. Një komponentë tjetër e projektit është edhe “Pune praktike me pagese” me fokus rritjen e shkathhtësive të punës për të rinjtë (50% F dhe 50%) dhe të realizohet në bashkëpunim me sektorin privat dhe nevojave të bizneseve me qëllim të krijimit të mundësive për punësimin afat-gjatë të të rinjve tek bizneset ku do të kryejnë punën praktike pas përfundimit të projektit.

A6. Promovimi i projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij me qëllim promovimin, informimin e publikut të gjerë në lidhje me mbështetjen financiare nga ana e BB dhe MPL Komunës së Gjilanit për tejkalimin e krizës dhe përshpejtim të zhvillimit ekonomik lokal.

Me 3 Mars 2021 DZHE ka shpreh interesin për “Bashkëpunimin Ndër-Komunal” në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave, projekti GIZ "Shërbime të Qëndrueshme Komunale" (SMS) të qenë pjesë e mbështetjes këshilluese e cila do të ofrohet nga GIZ për krijimin e Bashkëpunimit Ndër-Komunal (BNK) në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Qëllimi i BNK-së në sektorin e mbeturinave është të sigurojë mundësi për të bashkuar ekspertizën dhe përvojat për të zgjidhur bashkërisht çështjet e përbashkëta në një mënyrë më efikase dhe efektive. Gjithashtu inkurajon inovacionin në zgjidhjen e problemeve dhe u siguron komunave kapacitetin për të identifikuar dhe adresuar çështjet së bashku dhe në partneritet me komunat e tjera. Komuna e Gjilanit është përzgjedh nga GIZ për të qenë pjesë e këtij programi.

Te projekti i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe infrastruktura përcjellëse, kompania konsulentë dhe NJIP është duke punuar në përgatitjen e dosjes së tenderit dhe rishikimin e projektit ekzistues derisa Komuna ka përfunduar elaboratin e shpronësimit si dhe ka organizuar dëgjimin publik në përmbushje të kërkesave ligjore. Sipas planit, projekti pritet të përfundojë në vitin 2022.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar SF për Ndriçimin Publik dhe është dorëzuar në MFPT për shqyrtim dhe miratim derisa jemi duke përgatitur dokumentacionin teknik për projektin tjetër PPP “Penda e Livoqit”. Këtë vit planifikojmë të shpallim në pako 3 projekte PPP, përfshirë edhe Palestrën e Sporteve “ Bashkim Selishta-Petriti” e gatshme për të proceduar me aktivitet të prokurimit.

Në këtë mënyrë po krijojmë mundësi për investime përmes partneritetit publiko-privat, në projekte zhvillimore, që e bëjnë komunën atraktive për sektorin privat dhe investitorë si dhe po krijojnë vende pune.

Me 9 Mars 2021 Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me ministrin e Zhvillimit Rajonal, Enis Kervan, për Ndërtimin e Qendrës Kulturore për Komunitete në Gjilan. Projekti është përgatitur nga drejtoria dhe parasheh krijimin e Qendrës Kulturore për Komunitete në pronësi të Komunës së Gjilanit, e krijuar për të ruajtur, zhvilluar dhe promovuar artet dhe trashëgiminë kulturore të komuniteteve dhe në shërbim të gjithë qytetareve të komunës. Ky projekt do të jetë funksional pasi që do të mundëson institucioneve dhe organizatave të angazhuara në fushën e kulturës dhe artit të vendosin bashkëpunim për çështjet me interes të përbashkët si dhe të promovojnë artet dhe kulturat e ndryshme për veprat, iniciativat, aktivitetet kulturore dhe artistike. Projekti do të nxit bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore brenda dhe jashtë vendit. Kosto e projektit është 151,471.52 euro, ku MZHR do të financojë me 80,000 euro, derisa Komuna do të bashkë-financojë me shumën prej 71,471.52 euro. Projekti është në procedurë të prokurimit.

Jemi në fazën kur janë në dispozicion 52 prona publike për dhënie në shfrytëzim për individë dhe biznese që e kanë pasur problem zgjerimin e biznesit për shkak të mungesës së pronave. Shërbime i janë ofruar bizneseve të interesuara rreth procedurave të aplikimit apo shprehjes së interesit si dhe investitorëve të huaj nga Austria, Gjermania dhe Holanda.

DZHE ka bashkëpunuar me REA Prishtina në projektin e financuar nga BE “Përkrahje e BE për Konkurrueshmërinë e Sektorit Kosovar të ICT”, i cili synon të mbështesë konkurrueshmërinë e bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale duke përkrahur rritjen e sektorit Kosovar të ICT duke kontribuar në rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës. Qëllimi i projektit është të përmbushë mungesat për shkathtësi digjitale e biznese në mënyrë të qëndrueshme duke plotësuar nevojat e tregut si dhe të mbështetë nxitjen e konkurrueshmërisë së bizneseve kosovare digjitale dhe tradicionale duke përkrahur rritjen e sektorit të ICT në Kosovë e cila do të sjell rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi me 28 Prill 2021 është organizuar takimi B2B përmes dy sesioneve paralele. Gjatë sesionit hyrës, ndërmarrjet patën mundësinë të prezantoheni shkurt me profilet e tyre, shërbimet/produktet para bizneseve pjesëmarrëse sektoriale nonICT. Në sesionet në vazhdim, bizneset pjesëmarrëse demonstruan ofertat e tyre, brandet, materialet promovuese, demos, duke kërkuar mundësi bashkëpunimesh biznese me sektorët non-ICT. Dhe moduli i dytë Të rinjtë e certifikuar nga modulet e ICT me asistimin e projektit prezantuan para bizneseve pjesëmarrëse me arritjet, projektet dhe solucionet e tyre innovative dhe eksplorimin e mundësive për bashkëpunime (punësim, outsource, vetpunësim, partneritete etj) .

Janë ofruar 1127 shërbime kërkesave bizneseve përmes takimeve individuale dhe online. Drejtoria me efikasitet ka shqyrtuar dhe ka ofruar përgjigje edhe në 17 kërkesa të ndryshme brenda afateve ligjore të dorëzuara përmes Qendrën për Shërbim të Qytetarëve.

Falë investimeve në komunë dhe dinamizimit të veprimeve të drejtorive po krijohen mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm të biznesit duke pasur parasysh edhe planifikimin për zonën e lirë ekonomike si dhe interesimin e kohëve të fundit nga disa investitorë të huaj për të investuar në komunë kanë për t'i dhënë një impuls tjetër zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

Drejtoria vazhdon të bashkëpunoj ngushtë dhe të koordinohet edhe me Komisionet Komunale të Ndërmarrjeve publike lokale PL “Tregu”, “Stacioni i Autobusëve” si dhe me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donator, shoqëri civile si dhe në ndihmë të bizneseve dhe investitorëve me qëllim të arritjes së një stabiliteti ekonomik dhe përmirësimit e mirëqenies së qytetarëve tanë.

XI. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim edhe në këtë periudhë raportuese veprimtarinë e vet e mbështetet në rregulloret dhe ligjet në fuqi;

Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me nr.04/L-027; Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarre fikje dhe Shpëtim me nr.04/L-049, si dhe udhëzimet-rregulloret përkatëse në lëmin e emergjencave, të cilat kanë fushë veprimin në menaxhimin e situatave emergjente duke bërë identifikimin, lajmërimin dhe alarmimin me kohë të situatave të cilat kanë të bëjnë me atakimin e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale në komunë. Duke e mbështetur aktivitetin në planet e mëhershme që ka hartuar: si Planin e Vlerësimit të Rrezikut, Planin Operativ Emergjent, Plane Kontingjente; etj...

Duke u bazuar në përgjegjësit e saja DMSH, ka marrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive si dhe ka përcjellë aktivitetet e subjekteve relevantë duke bërë koordinimin me to varësisht nga karakteri, lloji dhe përmasat e fatkeqësisë – shkallës emergjente.

Si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, DMSH ka mbajtur takime të rregullta, ku gjithë herë është raportuar gjendja e fundit, veprimet e ndërmarra, vlerësimi dhe menaxhimi i situatës në parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. DMSH kanë qenë pjesë e drejtpërdrejt e komitetit dhe së bashku me zyrën e kryetarit është angazhuar në QOE.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka vazhduar bashkëpunimin me subjektet e ndryshme që përfshijnë fushën e sigurisë së emergjencave publike si: FSK, KFOR, OSBE, Policinë e Kosovës, KKSB, Kryqin e Kuq dhe OJQ të tjera. Gjithashtu, DMSH ka koordinuar aktivitetin në intervenime të përbashkëta në ndihmë qytetarëve për eliminimin e rrezikut nga pasojat e

vërshimeve dhe në aktivitete tjera të cilat kanë qenë në interes të qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Me 10 Janar 2021, komuna jonë është goditur rëndë nga vërshimet pas reshjeve të mëdha disa ditore, ku kemi pasur vërshime në qytet dhe në dalje të qytetit si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Stanishorka, gjithashtu ka pasur vërshime në fshatrat Livoq i Epërm dhe Livoq i Poshtëm, Malishevë etj, duke shkaktuar dëme të mëdha në biznese, ekonomi familjare, bujqësi dhe infrastrukturë. Sipas komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve, dëmet kanë qenë mbi 1.6 milion euro. Nga Komisioni për vlerësimin e dëmeve të vërshimeve me 10/11 Janar 2021, janë evidentuar 250 raste të dëmeve në ekonomike familjare, 35 raste të dëmeve në bujqësi dhe 22 raste të dëmeve në biznese gjithsejtë 307 raste, gjithashtu dhe dëme të ndryshme në infrastrukturë komunale. Gjatë këtyre vërshimeve përmes ekipeve të zjarrfikjes dhe shpëtimit kemi evakuuar në natën kritike të 10 janarit mbi 25 persona në vende të ndryshme të qytetit duke i shpëtuar jetën këtyre qytetarëve nga rreziku i vërshimeve me ujë të shtëpive dhe veturave.

Të reshurat e fundit të shiut dhe breshrit të datës 27 Maj 2021 të cilat goditën fshatrat: Pogradec, Sllubicë, Kokaj, Llovcë, Zhegër, Demiraj si dhe fshatra për rreth DMSH ka ngritur gatishmërinë duke angazhuar ekipet e shpëtimit të cilët kanë evakuuar nga rreziku për jetën nëntë (9) persona, kafshë shtëpiake dhe të mira materiale. Si pasojë e këtyre vërshimeve janë dëmtuar pesë (5) ura dhe shumë mbikalime të tjera, rruga në një pjesë të fshatit Sllubicë ishte jashtë përdorimit. Sipas komisionit të vlerësimit të dëmeve, ku pjesë e këtij komisioni ka qenë edhe një zyrtari i DMSH, sipas të dhënave janë prekur dhe dëmtuar 43 familje në ekonomi familjare, ku katër shtëpi janë tërësisht të pa banuara nga këto vërshime.

Gjatë kësaj periudhe raportuese DMSH në muajin qershor ka qenë pjesë e angazhimit në Dezinsektimin, Dezinsektim dhe Deratizim në Komunën e Gjilanit me vendim të zyrës së kryetarit

DMSH edhe këtë vit ka vazhduar procedurat e rregullta në furnizimet për Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit me vajra dhe antifriz për automjete të zjarrfikje; ekstrakt (shkumë ajrore), e të tjera pajisje për shuarje të zjarrit.

Gjithashtu, vazhdon aktiviteti për furnizim me mjete të punës për QOE, e të tjera aktivitete të tjera të iniciuara, duke analizuar në hollësi mbarëvajtjen e punës në përgjithësi.

Në muajin Maj të këtij viti është bërë raportimi për zyrën e kryetarit si dhe MAPL për “Menaxhimin e Performancës” për punën e drejtorisë sonë gjatë vitit të kaluar 2020, është raportuar për numrin e fatkeqësive të ndryshme në komunë si dhe për numrin ku ekipet e NjPZSh-së kanë intervenuar në vendin e ngjarjes, si dhe veprime e aktivitete të tjera nga Plani i punës dhe Raporti i punës së DMSH-ës.

Në këtë fazë gjatë sezonit verore përkatësisht muajve të nxehtë (qershor, korrik, gusht), DMSH ka ndërmarrë masat e parapara në parandalimin e hershëm të zjarreve si pjesë e masave kemi bërë fushatë vetdijësuese dhe thirrje tek qytetarët për kujdes ndaj zjarreve fushore dhe malore. Si masë për parandalimin e këtyre dukurive, kemi përgatitur dhe jemi duke bërë shpërndarje fizike të afisheve-njoftimeve (postareve) në vendet publike nëpër qytet e kryesisht nëpër fshatra, nëpërmjet mjeteve të informimit, portaleve dhe rrjeteve sociale duke bërë thirrje për kujdes të shtuar nga zjarret tek qytetarët për sezonin e vitit 2021. Në kuadër të këtyre masave kemi ngritur edhe gatishmërinë e monitorimit të terreneve malore dhe fushore me Inspektorët e parandalimit dhe zyrtarët e DMSH.

Të dhënat sipas protokollit për këtë periudhë Janar-Qershor të vitit 2021 janë: Përgjigje për qytetarët 318, Raporte të punës 12, Njoftime 8, Kërkesa 17, Autorizime 1, Vlerësime 1, Urdhër blerje 15, Lista 3, gjithsej 375.

Nga raporti i Intervenimeve në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Gjiilan, për këtë periudhë, kemi pasur Intervenime në zjarre të ndryshme 168 raste, Intervenime në aksidente komunikacioni 5 raste, 21 Intervenime në vërshime, 24 intervenime teknike, 15 shërbime të ndryshme, 3 lajmërim i rrejshme, gjithsejtë deri më tani janë 236 intervenime të përgjithshme.

Nga raporti i Inspektorëve të Preventivës në periudhën raportuese janë kryer 51 inspektime të rregullta, janë hartuar procesverbale dhe janë propozuar 131 masa, janë nxjerr 13 aktvendime me 80 masa të urdhëruara, gjithashtu janë lëshuar vërtetime mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri të subjekteve të ndryshme gjithsejtë 6, janë hartuar 18 procesverbale për zjarret e ndodhura, po ashtu janë hartuar 20 vërtetime mbi zjarret e ndryshme në sektorin privat, 3 njoftime për hetuesinë e Policisë së Kosovës në Gjiilan, kurse pëlqime të dokumentacioneve teknike janë lëshuar 2 në sektorin privat.

XII. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka arritur të realizoj planin e saj të punës sipas planifikimit në bazë të aktiviteteve për këto gjashtë muaj.

Përmes kalendarit çdo muaj me dizajn apo përmbajtje sipas tematikave të ndryshme, ku për momentin në muajin Qershor janë duke u realizuar aktivitete të ndryshme të cilat kanë filluar nga data 01 qershor e pritet të përfundojnë me 26 qershor.

Muajin e parë të vitit e kemi filluar me manifestimin mbarëkombëtar **“Flaka e Janarit” 2021**, me program një mujor dhe e cila tanimë është pjesë e trashëgimisë shpirtërore, në vigjilje të 30-vjetorit.

Muzeu Etnografik në komunën e Gjilanit:

Me 18 maj 2021, u bë HAPJA e muzeut etnografik përmes projektit: "Përmirësimi i Vlerave të Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes thirrjes për bashkëpunim ndërkufitar ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, projekt i cili u implementua nga Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Kumanovës, Në objektin e Muzeut të Qytetit janë mbajtur 4 -ekspozita të nxënësve të shkollës së mesme të artit pamor "Adem Kastrati", gjatë këtyre muajve.

Galeria e Qytetit në komunën e Gjilanit:

Në bashkëpunim me kryetarin Haziri dhe aktivin profesional të shkollës së mesme të Arteve Pamore "Adem Kastrati" në Gjilan jemi në përgatitje të sipër për hapjen e sallës së re të Galerisë në qytetin tonë.

Pra, kjo Galeri e qytetit do t'i ketë të gjitha parametrat adekuat për organizimin e aktiviteteve, konservimin dhe restaurimin e veprave artistike dhe hapësirën që secili artist do ta ketë mundësinë për ta realizuar ekspozitën e vet personale.

"SOCIAL HUB"

Është duke u bërë renovimi i objektit të shtëpisë së rinise lidhur me projektin e mbështetur nga Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare "Ballkan Union" projekt i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me organizatën "Ballkan Union" si dhe komunat e tjera të Rajonit Lindor.

Ky projekt ka për qëllim që të krijoj një qendër sociale që do të rrisë punësimin dhe përfshirjen sociale të grupeve në disavantazh.

Përmes këtij projekti ne planifikojmë që të implementojmë programin e praktikave, programin e nën-granateve si dhe mbajtjen e disa trajnimeve për grupe të ndryshme të rinjsh kryesisht në sektorin e IT, marketingut digjital, zhvillimin e Web-it dhe dizajnit grafik.

Biblioteka e Qytetit “Fan. S. Noli”, Gjilan

Sa i përket objektit të Bibliotekës së Qytetit, ju njoftoj se këtë vit është bërë regjistrimi i anëtarëve brenda muajit rreth 4177 anëtarë, nga ku 2823 femra-dhe 1354 meshkuj, Gjithashtu, sa i përket huazimit - marrjes apo kthimit të librit janë mbi 10.149 libra dhe materiale tjera që janë huazuar dhe kthyer) në bibliotekë.

Gjatë këtij gjashtë mujori mbi 12.752 lexues kanë shfrytëzuar sallat e leximit si studentë-nxënës dhe pensionistë. Mbi 2450 ekzemplarë të librave janë përpunuar dhe inventarizuar, kurse janë përpunuar dhe kataloguar në formë elektronike mbi 1.529 ekzemplarë,

Janë promovuar tri promovime të librave dhe autorëve në kuadër të “Flakës së Janarit”.

Tetë (8) punëtori të anëtarëve të sektorit të fëmijëve në kuadër të “Qytetari Digjital”-vazhdim i projektit nga viti i kaluar.

Në bashkëpunim me SHMU “Thimi Mitko” dhe Ars Club “Beqir Musliu” është organizuar për nderë të datës 23 prill Ditës Botërore të Librit, ku nxënësit dhe autorët e Gjilanit si folën për poetët e njohur për fëmijë gjilanas- tashmë të ndjerë: Ali Huruglica, Alush Cana, Haxhi Vokshi, Zejnullah Halili e Beqir Musliu.

Ka përfunduar plotësisht meremetimi i bibliotekës degë në fshatin Llashticë, është pastruar dhe të gjitha fondet librare janë kthyer në raftet e bibliotekës.

Është përgatitur Këndi Arkivor i Shqipërisë në Bibliotekën e qytetit "Fan S.Noli" në Gjilan në bazë të marrëveshjes së nënshkruar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Republikës së Shqipërisë, për dhënien e Këndit Arkivor në Bibliotekën e Qytetit, ku me anë të kësaj marrëveshje, i mundësohet komunitetit shkencor të Gjilanit që të kenë qasje të plotë në dokumentin arkivor, si të jenë në Tiranë, pa pasur nevojën e udhëtimit drejt kryeqendrës shqiptare.

Teatri i Qytetit në komunën e Gjilanit

23 Janar - Premiera e shfaqjes “Kosovo for Dummies” nga Jeton Neziraj, regjisore Blerta Rrustemi

23 – 27 janar 2021 - Festivali i Dramës Origjinale Shqipe “Talia e Flakës” 2021

11 maj 2021 - Premiera e komedisë “E vërteta” regjisor: Agon Myftari

26 maj - Premiera e shfaqjes “Autoban” nga Naser Shatrolli (Bashkëpunim me Teatrin)

1-5 qershor - Festivali i Teatrit të Shkollave të Mesme

28 qershor - Premiera e shfaqjes “Bright Ideas” regjisor Shkëlzen Berisha

Nga muaji Janar – e deri sot, 09 qershor 2021, janë realizuar 35 repriza të shfaqjeve tona me mbi 3,000 shikues duke respektuar të gjitha rekomandimet e ISHPK-së.

Deri në dhjetor, teatri planifikon t’i realizojë edhe 2 shfaqje / premiera të reja me regjisorët: Zana Hoxha dhe Ilir Bokshi.

SPORTI

Ju njoftoj që gjatë kësaj periudhe palestra e sporteve ka funksionuar sipas orarit të përcaktuar të punëtorëve dhe orarit të ushtrimeve.

Gjatë muajit janar klubet sportive nuk kanë qenë të angazhuara maksimalisht për shkak të pushimit të tyre dimërorë, por nga gjysma e dytë e janarit kanë filluar të kthehen në stërvitje të rregullta.

Gjatë muajit Shkurt klubet sportive kanë qenë të angazhuara maksimalisht me ushtrime, disa edhe me gara.

Gjatë muajve mars, prill, maj, qershor palestra e sporteve ka funksionuar me kapacitete maksimale sa i përket ushtrimeve dhe garave kampionale.

Nga fillimi i vitit dhe deri tani sa po raportojmë i kemi pasur **90** aktivitete sportive nga të gjitha kategoritë, që i bie që çdo të dytën ditë e kemi pasur nga një ndeshje kampionale. Edhe pse kemi qenë nikoqir i garave republikane të basketbollit nga Sporti Shkollorë, gjithashtu finalët e volejbollit dhe basketbollit, të gjitha aktivitetet janë zhvilluar duke respektuar masat anti covid, pa shikues dhe me grumbullim minimal të njerëzve

Ne si staf i palestrës jemi munduar dhe mundohemi maksimalisht të ofrojmë kushtet dhe hapësirën e nevojshme për mbarëvajtjen e aktiviteteve.

Kemi arritur t’i përgjigjemi shumë kërkesave të cilat kanë të bëjnë me shfrytëzimin e objekteve sportive, subvencionimin si dhe nevoja tjera të klubeve.

Sa i përket stadiumit kryesor gjendja e terrenit është e mirë pasi që tashmë është bërë faza e dytë e konservimit dhe gjendja e terrenit është e kënaqshme.

RAPORTET E ZYREVE DHE NJËSIVE I. ZYRA E PROKURIMIT

Gjatë këtij gjashtëmujori të vitit 2021 të gjitha aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar bazuar në planifikimin preliminar të prokurimit për vitin fiskal 2021 duke respektuar LPP -në dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik:

Në periudhën janar-qershor 2021 janë udhëhequr 33 aktivitete të prokurimit, të cilat edhe janë publikuar në web <https://e-prokurimi.rks-gov.net/> ;

Vlera financiare e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2021

Sipas Raportit vjetor për Kontratat e nënshkruara publike nga procedurat e prokurimit të procedura gjatë vitit 2021 janë nënshkruar 17 kontrata publike prej tyre:

Kontrata Furnizimi 8 në vlerë prej 442,927.71

Kontrata Shërbimi 2 në vlerë prej 597,381.40

Kontrata Pune 7 në vlerë prej 1,095,525.54

Sipas planifikimit të prokurimit dhe sipas kërkesave të njësive kërkuuese, zyra e prokurimit ka zhvilluar procedurave e prokurimit për vitin 2021.

Ndërsa, për aktivitetet të cilat janë në procedurë do të vazhdoj ti realizoj sipas afateve dhe rregullave ligjore të LPP-së.

Gjatë kësaj periudhe zyra e prokurimit ka përgatitur vendimet lidhur me kërkesat për rishqyrtim të parashtruara nga OE, ku vlen të theksohet se shumë prej tyre pas pranimi të përgjigjeve nga AK të cilat kanë qenë bindëse dhe të argumentuara, OE janë pajtuar dhe nuk kanë parashtruar ankesë në OSHP.

Aktivitetet e planifikuara :

Sipas planifikimit përfundimtar të prokurimit publik për periudhën Janar -Qershor 2021 kanë qenë të planifikuara këto aktivitete:

1. Darka e Lamës
2. Sigurimi i ushqimit për kafshët e egra (misër, grurë, guri i kripur)
3. Furnizim me fare misri dhe pleh mineral
4. Sera Komeriale
5. Mekanizëm Bujqësor
6. Furnizim me fidanë të arrës
7. Furnizim me ekstrakt
8. Furnizim me uniforma dhe pajisje
9. Funksionalizimi i radiolidhjeve të DSHM
10. Funksionalizimi qendror operativ emergjente
11. Vazhdimi i garazheve dhe të zyrave të NJPZSH

12. Furnizimi i kabineteve të kimisë dhe biologjisë
13. Furnizim me automjete të terrenit
14. Furnizim me inventar shkollor për nevoja të drejtorisë së Arsimit
15. Furnizim me tonerë
16. Furnizim me material riparues teknik dhe material elektrik .
17. Furnizim me foli plastike
18. Furnizim me inventar dhe mobile
19. Furnizim mjekësor
20. Furnizim me laboratorik
21. Furnizimi me dru
22. Furnizim me pelet
23. Material Botues
24. Furnizim me fotokopje, printer, skener
25. Mirëmbajtja servisi i fotokopjeve, printerëve, skanerëve
26. Furnizim me ditar
27. Dezinfektant – chlormax 1 kg
28. Vajra dhe antifriz për NJPZSH
29. Furnizim me zero klient dhe pajisje të rrjetit
30. Furnizim me farë gruri
31. Furnizim me mjete Higjienike
32. Furnizim me projektor
33. Furnizim me material Higjenik Sanitar
34. Pajisje speciale të shëndetësisë
35. Servisi dhe mirëmbajtja e nxemjes qendrore
36. Trajtimi i qenve endacak
37. Servisi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative
38. Mirëmbajtja e lëndës arkivole të DKGJP
39. Transporti i nxënësve
40. Pastrimi i objekteve Shkollore në Komunën e Gjilanit
41. Digjitalizimi i shkollave
42. Mirëmbajtja servisi i katër e- kioskave
43. SMS (mesazhe) për njoftimin e shërbimi i UEB SMS , njoftimi i qytetarëve lidhur me përgjigjet në kërkesa, parashtrës të dorëzuara në Qendrën për Shërbime me Qytetar
44. Emërtimi dhe numërimi i objekteve
45. Mirëmbajtja dhe servisi i Kamionëve
46. Pastrimi i objekteve të Komunës
47. Ndërtimi i rrugëve fushore për nevoja të bujqësisë
48. Gjelbërimi i hapësirave publike
49. Sani i ndriçimit publik
50. Mirëmbajtja teknike e objekteve të arsimit
51. Sani i rrugëve , trotuareve dhe parqeve në qytet dhe fshatra
52. Ndërtimi i shtatoreve dhe busteve në Gjilan

53. Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore
54. Halla e terrene sportive
55. Asfaltimi i rrugëve në qytet dhe fshatra
56. Rrënimi i objekteve
57. Ndërtimi i zyrave së gjendjes civile në lagjen Arbëria në Gjiçan
58. Rehabilitimi dhe zhvillimi i Palestrës së sporteve dhe infrastrukturës përcjellëse Pishina dhe Objekti i Akomodimit "Bashkim Selishta
59. Largimi i objekteve Interne
60. Ndërtimi i objektit të Administratës
61. Ndërtimi i tregut të Gjellbër
62. Implementimi i projektit të regjërimit Urban

Këto aktivitete kanë qenë të planifikuara për periudhën Janar – Qershor 2021 sipas Planifikimit Preliminar të Prokurimit për vitin fiskal 2021.

Zyra e prokurimit ka filluar procedurat e prokurimit në bazë të kërkesave të kompletuara për inicimin e aktiviteteve të cilat janë paraqitur nga Njësit Kërkuese.

Aktivitetet e implementuara

Gjatë vitit 2021 janë nënshkruar 26 kontrata duke përfshirë edhe procedurat e bartura nga viti 2020 prej tyre sipas Raportit vjetor për Kontratat e nënshkruara publike nga procedurat e prokurimit të procedura gjatë vitit 2021 janë nënshkruar 17 kontrata publike prej tyre:

Kontrata Furnizimi 8

Kontrata Shërbimi 2 Kontrata

Pune 7

Projektet e vitet 2020:

1. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative 2020
2. Mirëmbajtja e fushës , konservimi i stadiumit të qytetit
3. Disblokim i Gypit të ujësjellësit 400 afër Stadiumit të Qytetit
4. Furnizim dhe instalimi i ngrohjes qendrore në objektin e NJPZSH
5. Rehabilitimi rrugës në fshatin Pogragjë L=1675m'
6. Ndërtimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare-Vazhdimi i projektit
7. Dezinsektimi, Mirëmbajtja e tunelit si dhe dezinfektimi i Objekteve shëndetësore 8.
- Rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotualet, ndriçimi publik në Sos fshatin në Zabel
9. Rigjenerimi urban i hapësirave publike qendrore të qytetit.

Projektet e vitet 2021 :

1. Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative
2. Furnizim me farë misri
3. Ndërtimi i tregut dhe parkut në Zhegër
4. Furnizim me foli plastike

5. Mirëmbajtja Verore e rrugëve në Komunën e Gjilanit
6. Ndërtimi i urës në fshatin Dobërqan
7. Asfaltimi i rrugëve Dobërqan Stublin dhe fshatin Stublinë
8. Asfaltimi i rrugës në fshatin Livoq i Ulët Lot 1
9. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve në Komunën e Gjilanit
10. Ndërtimi i rrugës në fshatin Përlepnice (Lot)2
11. Ndërtimi i tregut të Gjellbër në Komunën e Gjilanit
12. Disblokim i Gypit të ujësjellësit 400 afër Stadiumit të Qytetit Gjilan
13. Furnizim me medikamente mjekësore
14. Furnizim me automjet të terrenit, pajisur me mjete Medicinale
15. Furnizim me preparat për dezinfektim të institucioneve arsimore në Komunën e Gjilanit
16. Furnizim me projektor dhe mbajtës për shkollë e mesme

Aktivitetet – vlera minimale (20) për vitin 2021

1. Shërbime të SMS mesazhe për njoftime përmes web platformës
2. Transporti i nxënësve në relacionin Cërrnicë – Smakaj
3. transporti i nx. Muçibabë Gjilan- anasjelltas
4. Furnizim me motoçikletë për nevojat të Komunës
5. Shërbimet e rrjetit digjital për shkollën fillore Mulla Idrizi Gjilani
6. Shërbimet e Avokatit
7. Shërbimet e avokatit dhe Përfaqësimit Juridik
8. Furnizim me reangenca për Laboratorin për analizat të CRP
9. Mirëmbajtja e kamerave dhe programeve financiare për QKMF
10. Shërbime Avokati dhe përfaqësimi juridike
11. Hartimi i projektit për asf. e rrugëve me infrastruktura përcjellëse në lagjen të shkollës fillore Ibrahim Uruqi në fsh. Bresalc
12. Shërbime virtuale “mësojmë nga shtëpia”
13. Furnizim me Pelet për nevojat të TP Dardania
11. Riparimin e diferencialit në automjetin FAP 14/14 për NJPZSH
12. Furnizim me Pesticide, farishta dhe repromaterial për pemishte dhe sera
13. Furnizim me Hardwer -pajisje për kompjuter dhe WI-FI
14. Furnizim me tepison për nevojat të IP Integj
15. Furnizim me vajra dhe filtera për mirëmbajtje të automjeteve
16. Furnizim me ekstrakt (shkumë) për NJPZSH
18. Furnizim me mjete didaktike për shf. Nazmi Hoxha
19. Shërbime virtuale “mësojmë nga shtëpia
20. Transporti i nx. Muçibabë- Gjilan - anasjelltas

Aktivitetet në implementim e sipër:

1. Ofrimi i shërbimeve të varrimit në Komunën e Gjilanit
2. Rregullimi i hapësirave publike - shesheve rruga Xhavit Ahmeti
3. Funksionalizimi i radiolidhjeve si dhe furnizimi me kamera dhe programin e vijueshmerisë (Smart nevoja) për nevojat e DMSH-së dhe NJPZSH-së
4. Rregullimi i platos mbi Lumin Mirusha – jug, pjesa II
5. Furnizim me lodra për institucionet parashkollore: IP Ardhmëria 1, Ardhmëria 2. Integj, Dardania.
6. Sanimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytetin e Gjilanit
7. Rehabilitimi ujësjellësit në fshatin Pogragjë
8. Furnizim me veshmbathje në Drejtorin e DMSH-së
9. Furnizimi dhe vendosja e shenjave për emërtimin e rrugëve
10. Furnizim me material laboratorik
11. Furnizim me material riparues teknik

Lëndët të cilat janë me ankesa në OSHP:

1. Implemetimi i parqeve Baja, Paqes dhe Parku Kodra e Dëshmorëve
2. Mirëmbajtja teknike e objekteve
3. Hartimi i projekteve të infrastrukturës rrugë, kanalizim dhe shërbime gjeodezike
4. Ndërtimi i skulpturës kushtuar Heroit kombëtar Kadri Zeka Gjilan
5. Digjitalizimi i stacionit të autobusëve në Komunën e Gjilanit
6. Mirëmbajtja dhe servisimi i kamerave publike të qytetit
7. Sigurimi fizik i objekteve komunale dhe shkollore

II. NJËSIA E KUVENDIT

Bazuar në Planin e punës së Njesisë së Kuvendit dhe Planin e punës të Kuvendit për periudhën JANAR-QERSHOR 2021, Njësia e Kuvendit ka kryer këto aktivitete:

- Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të rregullta, të jashtëzakonshme dhe urgjente të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bazuar në Orarin vjetor për mbajtjen e seancave të KKGjilan,

- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në Kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve,
- Përcjellja e takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve të KK-së dhe Komisioneve tjera të formuara nga KK-ja,
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Zyrës së Kryetarit dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të tjera të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale,
- Dërgimi në MAPL i raportit mujor, për të gjitha aktet dhe shkresat e përkthyer të lëshuara nga Institucionet komunale,
- Lekturimi i të gjitha materialeve të Kuvendit dhe Komiteteve dhe materialeve e akteve tjera të KK-së,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha materialeve për seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale, në formë fizike dhe elektronike,
- Përgatitja teknike e Sallës së Kuvendit, kujdesi për mirëmbajtjen e aparaturës për zërim dhe incizimi përmes kamerës dhe incizimi tonik i seancave.
- Njoftimi me kohë i anëtarëve të Kuvendit për mbajtjen e seancave të KK-së,
- Dërgimi i të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,
- Dërgimin e raporteve të rregullta mujore në MAPL për të gjitha aktet e miratuara nga KKGjilan si dhe dërgimi i të gjitha akteve të nxjerra nga Kryetari i Komunës, në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së të njëjtave,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha vendimeve, rregulloreve, rekomandimeve e akteve tjera brenda institucioneve komunale, me qëllim të implementimit të tyre.,
- Bashkëpunimit brenda institucioneve komunale dhe me organet qeveritare dhe ministrinë tjera të linjës, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit sa më të mirë të organeve komunale.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 Kuvendi dhe Komitetet e KK-së kanë mbajtur takimet si në vijim:

- Kuvendi ka mbajtur 5 seanca të rregullta dhe 1 seancë të jashtëzakonshme dhe ka miratuar 35 vendime, prej të cilave 4 rregullore komunale, Statutin e Qendrës Kulturore Evropiane dhe Kodin e Etikës në Institucionet Edukativo Arsimore. Po ashtu gjatë kësaj periudhe KK ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar për vitin 2020, Raportin financiar tre mujor për vitin 2021 si dhe Raportin e punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2020 si dhe ka miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Gjilanit 2022-2024.
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 5 mbledhje dhe ka nxjerr 33 Rekomandime për miratim në Kuvend
- Komiteti për Komunitete ka mbajtur 4 takim
- Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit ka mbajtur 2 takime dhe ka nxjerr tri rekomandime

- Komiteti për Arsim ka mbajtur 3 takime dhe ka nxjerr dy rekomandime
- Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka mbajtur 3 takime dhe ka nxjerr 5 rekomandime
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbajtur 2 takime
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Agrikulturë nuk ka mbajtur asnjë takim
- Komiteti për Barazi Gjinore nuk ka mbajtur asnjë takim
- Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitarë nuk ka mbajtur asnjë takim
- KKSBB ka mbajtur 3 takime
- Komiteti Konsultativ i eksperteve të planifikimit hapësinorë ka mbajtur një takim dhe ka nxjerr tri rekomandime
- Komiteti Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara ka mbajtur një takim dhe ka nxjerr një Rekomandim
- Janë mbajtur 7 Debate Publike për rregullore komunale

Po ashtu duhet theksuar se deri te numri i vogël i takimeve të Komiteteve dhe trupave tjerë punues të KK-Gjilan ka ardhur si pasojë e masave për mbrojtje nga COVID-19

Njësia e Kuvendit gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 nga bashkëpunimi që ka pasur me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të akteve të dërguara dhe nuk ka pranuar asnjë konfirmim negativ.

III. NJËSIA E PERSONELIT

Njësia e personelit merret kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore të cilët janë pasuria kryesore e një organizate buxhetore.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i cili tejkalon kufijtë e njësive buxhetore dhe përbëhet nga disa komponente edhe atë:

Planifikimi, punësimi, menaxhimi i performancës, trajnimi dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë.

Po ashtu Njësia e personelit bënë mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, kryesisht nga marrëdhënia e punës dhe procedura administrative, duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet e saj me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë përkatëse, lidhur me zbatimin e përgjegjësisë të Komunës të cilat rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore nga sfera e marrëdhënies së punës dhe pagave të SHC.

Andaj, Njësia e personelit në kuadër të planit të saj punues këtë vit ka kryer aktivitetet punuese si në vijim:

Akt emërimi 4, Kontrata në vepër dhe kontrata tjera 171, ka shpallur 19 konkurse për 19 pozita me gjithsej 73 dokumente, hartimit i 56 vendime të ndryshme, 9 takime pune, 24 vërtetime të ndryshme, 48 pushime mjekësore, pushime vjetore 400, ka hartuar 4 raporte dhe procesverbale, ka hartuar shkresa 12, njoftime 25, përgjigje 5, kërkesa të ndryshme 19, plotësimi i formularëve për MAP 113, 135 konsultime me zyrtarë dhe të tjerë, aktivitete të

ndryshme 35, janë përpunuar, skanuar dhe regjistruar në SIMBNJ 20 dosje, janë skanuar dhe kopjuar 179 dokumente, si dhe 121 shërbime dhe këshilla të ndryshme.

Aktivitetet shitesë:

- Mbajtja e përhershme e evidencës së punëtorëve të Komunës përmes sistemit elektronik;
- Menaxhimi me lista të pagave së Shërbyesve civil;
- Menaxhimi me stafin në aspektin e mbajtjes së trajnimeve të ndryshme;
- Raportimi nivelit qendror; MAPL dhe MAP për numrin e punëtorëve sipas gjinisë, kualifikimit, etnitetit etj;
- Përgatitja e formularëve: për punëtorë të ri, ndryshime, të larguar, retroaktive dhe dërgimi i tyre në Ministrinë e Administratës Publike - Divizioni i pagesave, Prishtinë;
- Ofrimi i të dhënave për auditorin e brendshëm, jashtëm dhe KPMSHCK;
- Përpunimi dhe azhurimi i listës së SHCK;
- Nxjerrja e të dhënave financiare të SHCK për buxhetin 2022;
- Pjesëmarrja në hartimin e buxhetit 2022;
- Bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë komunale sa i përket aspektit të nëpunësit civil;
- Përgatitja e konkurseve, publikimi i tyre dhe zhvillimi i procedurave rekrutuese konform konkurseve;
- Organizimi i punëve të Komisionit disiplinor dhe Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Komunës.
- Shpallja e konkurseve dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit përmes SIMBNJ
- Shfrytëzimi i pushimeve vjetore, mjekësore, vdekjes, lehonisë, etj. përmes SIMBNJ
- Përpunimi i dosjeve të nëpunësve civil dhe futja e dosjeve në SIMBNJ
- Pjesëmarrja në trajnime rreth SIMBNJ, monitorimit të performancës □ Pjesëmarrje në Komisionin për hartimin e akteve normative, etj

IV. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe të cilat i trajton Njësia për të Drejtat e Njeriut si mekanizëm përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal.

Monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të Drejtat e Njeriut në këto Fusha: mundësi të barabarta, mbrojtje nga diskriminimi, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me nevoja të veçanta, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore e tjera.

Koordinatori dhe zyrtaret e NJDNJ gjatë kësaj periudhe 6 mujore kanë monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takime të tjera të organizuara në kuadër të komunës.

Zyrtarët e NJDNJ-së si anëtarë të Komisionit për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale në fushën e të drejtave të njeriut e barazi gjinore gjatë muajit maj kanë mbledhë të dhënat e kërkuara për të punësuarit për vitin 2020 në institucionet komunale të ndara sipas kategorisë duke përfshirë numrin total, strukturën gjinore dhe etnike për të gjithë të punësuarit, të dhëna për pjesëmarrje në takime publike të ndara sipas gjinisë, përbërjen e komisioneve, emërtimet e rrugëve, regjistrimin e pronave, ndarjen e subvencioneve nga drejtoritë komunale, përbërjen e këshillave lokalë etj.

Asambleja komunale e fëmijëve gjatë muajve shkurt dhe mars mori pjesë në sesionet “Fol sh lirë” në kuadër të fushatës “Çdo mendje vlen” të organizuar nga grupi ROR. Sesionet mbaheshin çdo të shtune me temë kryesore kishin shëndetin mendor të fëmijëve.

Në takimin e mbajtur më 9 mars 2021 u bë përzgjedhja e re e kryesisë së Asamblesë komunale të Fëmijëve –Gjilan, në takim ishin prezent zyrtarja për të drejtat e fëmijëve, Asambleja komunale e fëmijëve, përfaqësuesit e ‘Syri Vizionit dhe ‘save the Children’

Ndërsa në takimin e mbajtur më:01.04.2021 nga ZDF, AKF u bë pranim – dorëzimi i detyrës së kryetarit. Po në të njëjtin takim u themeluan komisionet e përhershme të AKF-Gjilan dhe u zgjodhën kryetarët dhe anëtarët e komisioneve nga asambleja e fëmijëve. Komisionet të cilat u formuan janë:

- Komisioni për Arsim dhe bashkëpunim me AKF-të e tjera të Kosovës,
- Komisioni për Kulturë dhe Sport,
- Komisioni për monitorimin e konventës Ndërkombëtare për të drejtat e Fëmijëve,
- Komisioni për Veprim Humanitar dhe
- Komisioni për Shëndetësi

Asambleja e Fëmijëve takimet virtuale të komisioneve veç e veç i mbajtën nga data 12.04.2021 deri më 17.04.2021.

ZDF dhe kryesia e AKF më: 23.04.2021 mbajtën takimin e radhës ku u bë një raport përmblendhës i punës së AKF-së për 5 takimet e mbajtura me komisionet.

Pastaj u ri planifikua Plani i Punës i AKF-së ku u specifikuan pikat e tij për vitin 2021-2023.

Më 1 Qershor NJDNJ, DKRS, Asambleja e Fëmijëve – Zyrtarja për të Drejtat e Fëmijëve në bashkëpunim me Save The Children dhe OJQ “Syri Vizionit” realizuan aktivitetet e parapara për shënimin e kësaj dite:

1. Aktiviteti i parë ishte mbjellja e luleve para kuvendit komunal,

2. Vizita e Asamblesë komunale të Fëmijëve në Stacionin Rajonal Policor të Gjilanit dhe u realizuan vizatime dhe pikturime të ndryshme nga AKF për 1 Qershor.

8 Marsi u shënua me aktivitete nga Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, ku realizuan ekspozitën “Ne jemi pranvera” me nxënësit e shkollës së artit pamor duke u përcjellë me këngë instrumentale dedikuar grave të dëshmorëve të komunës së Gjilanit, për shkak të respektimit të masave anti -covid nuk kishte mundësi për pjesëmarrje edhe të grave të tjera shumë meritore.

Gjithashtu për nder të 8 marsit, u realizua edhe emisioni në radio-star i cili u mbështetë nga OSCE me disa nga gratë udhëheqëse të komunës si shembull i mirë se gratë dinë të menaxhojnë mirë në çfarëdo situatë që ndodhen, siç ishte rasti i fundit me pandeminë. Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me drejtorinë e Kulturës dhe OJQ “Gruaja Hyjnore” shënuan 19-Qershorin “Ditën ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt” me aktivitete senzibilizuese me qëllim për t’i nderuar dhe trajtuar në mënyrën më të mirë dhe më të dinjitetshme gjithë të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikt, të cilat për vite me radhë jetojnë me përjetimet e tmerrshme nga lufta e fundit në vend, si dhe të ngritët vetëdija për ndëshkimin e autorëve të dhunës seksuale në konflikt.

Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje ka mbajt takimet e rregullta për periudhën 6 mujore ku edhe kanë përgatitë planin e veprimit 3 vjeçar 2021-2023 nën mbështetjen e Un-ëomen, ku përveç trajtimit të viktimave të dhunës në familje kemi pa të nevojshme të trajtohen edhe kryerësit e dhunës përmes trajtimit psiko – sociale si pjesë mjaft e ndjeshme dhe shumë e nevojshme për t’u bërë sepse në bazë të informacioneve të të gjithë akterëve është pa se rastet e dhunës në familje janë të përsëritur pra bëhet fjalë për recidivistë. Gjatë kësaj periudhe është shënuar rritje e rasteve dhe krahasuar me vitin paraprak për periudhën e njëjte janë mbi 20 raste më shumë.

Zyrtarët e NJDNJ-së morën pjesë në takime të formës virtuale dhe fizike të organizuara nga DEMOS, MAPL, MAP, OSCE, USAID, për të diskutuar për çështje të ndryshme me qëllim të përmirësimit të punës në vazhdimësi dhe ngritjen e performancës komunale.

Vlen të përmendet se edhe në këtë 6 mujor nuk kemi mundur t’i realizojmë aktivitetet ashtu siç kanë qenë të planifikuara për shkak të situatës së krijuar nga virusi Covid-19.

V. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) punën e vetë e ka bazuar në Planin Strategjik për vitet 2021-2023 dhe Planin Vjetor për vitin 2021. Plane këto të shqyrtuara dhe aprovuara nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.

Në Planin Vjetor të NJAB-së fillimisht janë planifikuar që brenda gjashtëmujorit të parë të këtij viti të kryhen gjashtë auditime, por ashtu si jeni të informuar nga raportimet

paraprake, në vitin 2020 është dashur të kryhet një Pilot auditim i performancës, e për shkak të periudhës pandemike covid 19, përfaqësuesit e Projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID-TEAM) fillimin e këtij pilot auditimi e kanë shtyrë deri në fillim të prillit të këtij viti.

Pra duke mos pasur informata të sakta se kur do të fillon ky Pilot auditim i performancës dhe si dhe sa do të zgjasë, NJAB-ja me rastin e përgatitjes së Planit Vjetor për vitin 2021 (*Plan ky i dorëzuar në fund të muajit Dhjetor 2020*), ka planifikuar që në gjashtëmujorin e parë të kryhen gjashtë auditime. Mirëpo, me që nga muaji Prill 2021 kemi filluar me këtë Pilot auditim, tri auditime që kanë qenë të planifikuara është dashur të pezullohen, sepse në këtë Pilot auditim janë të angazhuar të tre auditorët njëkohësisht dhe se sipas kërkesës dhe agjendës së Projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAIDTEAM), deri sa do jetë në proces zhvillimi i këtij Pilot auditimi nuk do ketë mundësi që njëkohësisht të zhvillohen edhe aktivitete për ndonjë auditim tjetër.

Është e nevojshme të cekët se i gjithë procesi i këtij auditimi është ndihmuar dhe monitoruar nga ekspertë të një Kompanie (KPMG) e nënkontraktuar nga Projekti Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID-TEAM), por ndihma ka qenë vetëm në formë virtuale, çka na ka sjellë mjaftë vështirësi.

Sipas planit të punës është paraparë që ky Pilot auditim të përfundojë deri me 15 Korrik (*nëse nuk del ndonjë pengesë gjatë punës*), ku fillimisht do të lëshohet Draft Raporti, e më pastaj edhe Raporti Final.

Brenda gjashtëmujorit të parë / 2021, NJAB-ja ka kryer këto auditime:

1. Auditimi i Procesit të Shpenzimeve në Administratën Komunale, me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë, ku te këto drejtori kryhen auditime të veçanta (auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të lartë),
2. Auditimi në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë (auditim i vlerësuar me rrezikshmëri të mesme)
3. Pilot auditimi i performancës në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa – Sektori i Tatimit në Pronë (pilot auditimi është në fazën e raportimit).

Në dy auditimet e kryera janë dhënë katër rekomandime (*prej tyre një rekomandim ka qenë i përsëritur nga auditimi i mëparshme, ndërsa tri rekomandime janë dhënë të reja*).

Në auditimin e kryer në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është dhënë vetëm një rekomandim, i cili ka pasur të bëjë me mbajtjen e një evidence (protokolli), ku do të dëshmohej saktë data e pranimit të faturave nga operatorët ekonomik, si dhe është kërkuar të bëhet kryerja e barazimeve mujore të zyrtarit financiar me zyrtarin për të hyra komunale.

Nga verifikimet e bëra ka rezultuar që ky rekomandim ka filluar të zbatohet plotësisht nga muaji Mars i këtij viti.

Kurse tri rekomandimet e dhëna në auditimin e procesit të shpenzimeve ende janë në proces të zbatueshmërisë.

Nga zbatueshmëria e rekomandimeve të dhëna, do të kenë efekte pozitive:

- në fushën e menaxhimit të parasë publike gjatë proceseve të shpenzimeve, racionalizimit të shpenzimeve dhe arsyeshmërisë së shpenzimeve të krijuara,

- në procesin e furnizimeve dhe aplikimit të programit E-Pasuria,
- në raportimin e mënyrës së shpenzimeve të mjeteve të përfituara si subvencion nga gjithë përfituesit e subvencioneve.

Aktivitetet e tjera të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në kuadër të Komunës (shkurtimisht):

- Në fillim të vitit 2021 janë përgatitur dy Raporte të punës së NJAB-së, raporti për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020 dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2020.
- Janë mbajtur tri takime me Komitetit të Auditimit (me 05.02.2021, 24.02.2021 dhe me 26.04.2021) ku është bërë shqyrtimi i Raportit për gjashtëmujorin e dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2020, është shqyrtuar Progresi i zbatueshmerisë së rekomandimeve si dhe është bërë shqyrtimi i aktiviteteve të NJAB për tremujorin e parë të vitit 2021.

- Me Kryetarin e Komunës dhe Këshillin e Drejtorëve janë mbajtur dy takime, kryesisht lidhur me angazhimet dhe aktivitetet e drejtorive për zbatimin e rekomandimeve.
- Drejtori i NJAB-së ka ndihmuar Komisionin për plotësimin e Pyetësorit të vet-vlerësimit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll.

Lidhur me punën e këtij Komisioni dhe rishikimin e Pyetësorit me 12.04.2021 kemi bërë një Informatë për Kryetarin e Komunës dhe Komitetin e Auditimit.

- Gjithashtu, NJAB-ja ka pasur angazhime lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe auditori i brendshëm. Për të gjeturat lidhur me zbatueshmërinë e rekomandimeve janë përgatitur Raporte të cilat i janë dorëzuar Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- Kanë vazhduar angazhimet dhe aktivitetet e ndryshme me përfaqësuesit e Projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (USAID-TEAM), me ç'rast drejtori i NJAB-së, së bashku me këshilltaren për auditim në kuadër të Programit TEAM dhe Komisionin për monitorimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve ka bërë rishikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e Pasqyrave Financiare për vitin 2019, si dhe përgatitjen e komenteve për të gjeturat e dhëna në Draft Raportin e auditimit të ZKA-së për vitin 2020.

Kurse bashkëpunimi kryesor në këtë gjashtë mujor me përfaqësuesit e Projektit TEAM ka qenë fillimi i Pilot auditimit të performancës në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, gjegjësisht në Sektorin e Tatimit në Pronë me temë: *Efikasiteti i sistemit të identifikimit, verifikimit, klasifikimit dhe regjistrimit të pronave në procesin e arkëtimit të të hyrave nga tatimi në pronë.*

- Në muajin Qershor, drejtori i NJAB-së ka marrë pjesë në Tryezën me temë “Ndarja e përvojave në proceset audituese”, tryezë kjo e organizuar nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB) në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, si dhe nga Projekti USAID-TEAM.
- Edhe në këtë gjashtëmujor kemi pasur aktivitete lidhur me ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për disa drejtori Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë.

4. Punët Kryesore në vazhdim:

Mbetet të përfundohet Pilot auditimi, ashtu që deri me 15.07.2021 NJAB-ja duhet t'i dorëzoj Raportin e punës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2021: Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Gjithashtu duhet të bëhet Rishikimi i Planit Vjetor i cili duhet të aprovohet nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit,

Më pastaj të fillohet me auditimet e planifikuara sipas Planit Vjetor të rishikuar për vitin 2021.

VI. ZYRA LIGJORE

Raporti përfshinë aktivitet kryesore si më poshtë:

1. Projekt Rregullore për menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare – Inventari i Pa Përdorshëm
2. Projekt Rregullore për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Gjilanit
3. Projekt Rregullore për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale

Aktivitetet tjera:

1. Projekt - kontratë/marrëveshje mirëkuptimin, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-24
2. Vendime të hartuara, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-56
3. Përgjigje në shkresa/kërkesa/ankesa -2
4. Opinione ligjore-6
5. Konsultime/këshilla ligjore-juridike-4
6. Debate/Dëgjime publike për akte të ndryshme-3

Dokumente të lekturuara:

Në kuadër të Zyrës ligjore janë kontrolluar 275 faqe, gjegjësisht 26 dokumente të ndryshme.

VII. ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim Publik (ZIP) ka komunikuar me qytetarët përmes formave të ndryshme në më shumë se 320 raste në periudhën janar – qershor 2021, edhe atë përmes konferencave për media, komunikatave për media, ftesave për aktivitete publike, njoftimeve etj.

Meqë edhe ky 6-mujor u karakterizua me sfidën e quajtur COVID-19, Zyra për Informim ka komunikuar me publikun mbi baza ditore, përmes konferencave për media e komunikatave, duke i mbajtur të informuar qytetarët për gjendjen pandemike.

Zyra për Informim, një punë të madhe ka bërë në aspektin e Qasjes në Dokumente Publike, ku për këtë periudhë kanë pranuar 34 kërkesa dhe 33 prej tyre kanë marrë përgjigje në kohë reale, ndërsa një kërkesë është në proces.

Një punë tejet të rëndësishme, Zyra për Informim ka bërë në publikimin në ueb faqe të të gjitha akteve komunale në gjuhët zyrtare, sikurse edhe vendimet, procesverbalet, njoftimet e konkurset etj.

Zyra për Informim, për hir të transparencës më të madhe, ka bërë publikimin e kontratave me operatorët, që nga faza e shpalljes së ofertave e deri tek nënshkrimi i kontratave, që është vazhdimësi e partneritetit me USAID në këtë aspekt.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Zyra për Informim Publik ka vazhduar implementimin e projektit shumë të rëndësishëm për avancimin e transparencës “Livestream”, seancat e Kuvendit Komunal të Gjilanit janë transmetuar drejtpërdrejt në kanalin zyrtar të Komunës në Youtube, sikurse edhe nga operatori i kontraktuar nga Komuna, në platformën e tij, në radio e faqen zyrtare.

Pas çdo mbledhje të Kuvendit Komunal të Gjilanit, ZIP u ka përcjellë mediave komunikatë zyrtare me debat ballafaques pozitë-opozitë për pikat e rendit të ditës. Duhet përmendur faktin që Gjilani është komuna e vetme që lanson kumtesë për media të kësaj natyre.

Gjatë kësaj periudhe, ZIP ka mbuluar edhe takimet e trupave të Kuvendit, duke ua përcjellë mediave kumtesën zyrtare për atë se çka është diskutuar e rekomanduar në komitete.

Gjithashtu, Zyra për Informim ka përgatitur, e dizajnuar të gjitha llojet e ftesave e mirënjohjeve, e çmimeve, në kuadër të punës së vitit 2020.

Bashkëpunimi i mirë i Zyrës për Informim Publik e Komunës së Gjilanit me mediat, ka bërë që të gjitha aktivitetet e ekzekutivit dhe legjislativit të mbulohen në mënyrën më të mirë, edhe atë në portale, gazeta online, televizione dhe radio, për çka shprehim falënderim të veçantë

VIII. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Misioni i Zyrës për integritet evropean është që në bashkëpunim me instancat përkatëse lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e standardeve evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për integritet evropian si dhe të koordinojë të gjithë çështjet lokale të procesit të integritetit evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga BE-ja.”

Zyra për integritet evropean gjatë periudhës gjashtëmujore ka zhvilluar një varg aktivitetesh që dalin nga obligimet dhe përgjegjësitë e saja.

Zyra ka përcjellë punën dhe aktivitetet e Komunës;

1. Koordinimin e procesit të integritit evropian;
2. Pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale dhe zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave nga ana e Drejtorive sektoriale, me qëllim të reflektimit të obligimeve përkatëse në lidhje me integritin evropian në kuadër të secilit sektor;
3. Monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale të Kryetari i Komunës dhe autoritetet qendrore, përmes Ministrisë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale;
4. Koordinimin dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të Komunave për të kryer me sukses të gjitha reformat e nevojshme, përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të tyre;
5. Ofrimin e mbështetjes të gjitha strukturave komunale në përmirësimin e konsultimeve dhe dialogun civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në nivelin komunal.
6. Ngritjen e vetëdijes së administratës komunale, shoqërisë civile, mediave, komunitetit të biznesit, si dhe të publikut të gjerë mbi procesin e integritit evropian dhe promovimin e vlerave dhe standardeve evropiane.
7. Përvetësimi i obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara ZKI ka organizuar Javën e Evropës, duke organizuar debate, konferenca dhe aktivitete tjera me qëllim të informimit me strukturat dhe kriteret e BE. Këtë vit për shkak të situatës me Covid 19 nuk kemi pasur mundësi të organizojmë asnjë aktivitet.
9. ZKIE ka raportuar në mënyrë permanente në MAPL.

IX. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Për periudhën Janar – Qershor 2021, një përmbledhje e shkurtër e punës së ZKKK-së.

Për shkak të pandemisë Covid 19 në fillim të vitit 2021, kemi hasur në vështirësi të mëdha, ndërsa në tremujorin e dytë të raportit, situata ka ndryshuar shumë dhe ngadalë po kthehemi në normalitet. Kjo vërehet edhe tek partnerët dhe donatorët tanë, të cilët janë riaktivizuar dhe kanë filluar të punojnë normalisht. Të gjithë partnerët janë shumë të rëndësishëm në procesin e kthimit, riatdhesimit dhe ofrimin e ndihmës në çdo kuptim.

Në periudhën Janar - Qershor 2021, ZKKK kreu aktivitetet e mëposhtme:

Kthimi i qëndrueshëm:

Sa i përket kthimit në periudhën raportuese, kemi pasur katër kërkesa për regjistrim personave të kthyer. Dy kërkesa kanë përmbushur të gjitha kriteret dhe janë regjistruar në bazën e të dhënave, një kërkesë është në procedurë, ndërsa njëra është refuzuar sepse nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në udhëzimin e ministrisë për kthim të qëndrueshëm. Ne kemi punuar me UNHCR-in për të krijuar një profil të fshatrave dhe zonave ku jeton komuniteti serb, si dhe lokacioneve ku është regjistruar interesi më i madh për kthim. Ne patëm disa vizita në terren me UNHCR-in dhe AT. Ne jemi në kontakt të përditshëm me partnerët dhe Ministrinë për komunitet dhe kthim.

Pyetjet e komuniteteve:

- Në periudhën raportuese, një nga gjërat shumë të rëndësishme dhe pozitive në këtë kohë, është ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes nga IOM për qytetarët e komunës së Gjilanit. IOM, gjatë periudhës raportuese, mbështeti pesë (5) familje me projekte për stabilitetin ekonomik në komunitet. Përfituesit e këtyre projekteve janë tre (3) familje nga komuniteti Serb, një (1) familje nga komuniteti Turk dhe një (1) familje nga komuniteti Goran. Këto familje fituan projekte për pajisje me makineri për fillimin dhe forcimin e biznesit familjar.
- Përveç aktiviteteve të mësipërme, IOM është duke përgatitur projekte që në periudhën e ardhshme do të përfshijnë një numër më të madh të përfituesve, nga komuniteti pakicë, për personat që janë përfitues të ndihmës sociale. Me këtë rast, ne patëm disa takime me drejtorin e Qendrës për punë sociale, dhe jemi dakorduar rreth kushteve për zbatimin e mëtejshëm. Në periudhën e ardhshme, ne presim që të fillojmë me realizimin.
- Në bashkëpunim me organizatën turke TIKa, ne kemi bërë një listë për 40 familje të rrezikuara nga komuniteti Rom, për shpërndarjen e pakove ushqimore humanitare që do të shpërndahen këto ditë drejtpërdrejt personave të emërtuar në listë.
- Kemi pasur disa aktivitete me anëtarët e komunitetit Rom dhe Serb në ofrimin e informacioneve, dhe kemi ndihmuar për të shkruar një deklaratë, ankesë dhe kërkesë, të cilat iu drejtuan Qendrës për punë sociale dhe Administratës komunale të shëndetit. Këto aktivitete kishin të bënin me ndihmë financiare për operacion, për ndihmë për njerëzit e prekur nga Covid 19, për furnizimin e ilaçeve, etj.
- Ne kishim pesëmbëdhjetë (15) kërkesa nga Gjykata Themelore për të siguruar informacione mbi vendbanimin, qëndrimin dhe informacione të tjera të dobishme për disa persona nga komuniteti Serb, të cilët kanë pasur procese gjyqësore ose janë në proces të zgjidhjes së tyre në gjykatë.

- Procesi i ri integritetit të personave të riatdhesuar

Në këtë periudhë raportuese, të gjitha aktivitetet në lidhje me procesin e riintegritetit ose riatdhesimit janë në përputhje me Rregulloren aktuale 22/2020 "Të drejtat dhe kriteret e ndihmës" të Ministrisë së Brendshme.

* Në periudhën nga 01.01.2021 deri më 08.06.2021. sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme dhe Data bazës që kemi në dispozicion, figuron se është kthyer një (1) familje me katër (4) anëtarë,

- Janë mbajtur katër (4) takime të komisionit komunal për persona të riatdhesuar. Janë shqyrtuar (5) kërkesa me nevoja të ndryshme dhe pesë (5) janë aprovuar nga komisioni dhe u janë përcjellë institucioneve përkatëse (Bordit për riintegrim të MPB) për hapa të mëtejshëm.
- Në terren, me komisionin e Qendrës për Punë Sociale dhe koordinatorin e Ministrisë së Brendshme kemi vizituar nëntë (9) familje. Qëllimi i vizitës ishte përcaktimi i kushteve të jetës dhe strehimit.
- Përveç aktiviteteve të mësipërme, ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me persona e riatdhesuar, dhe ne u sigurojmë atyre të gjitha shërbimet të parapara me Rregullore.

Në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare GIZ, kemi punuar në ofrimin e ndihmës për personat e kthyer nga programi i riatdhesimit. Një nga kushtet më të rëndësishme për të aplikuar për ndihmë është që personi duhet të jetë i regjistruar në sistemin e Ministrisë së Brendshme dhe kjo vërtetohet me një certifikatë e lëshuar nga zyra jonë për të gjithë personat që ishin të interesuar të aplikojnë.

• Të dhëna statistikore

Të dhënat nga Baza e të Dhënave Qendrore e Ministrisë së Brendshme për personat nga programi i riatdhesimit për periudhën 01.01. -11.06.2021.

Shteti nga cili vjen	Vendi i lindjes	Data e kthimit	Komuna (kërkesa)	Data, muaji dhe viti i daljes	Mënyra e kthimit	Familje	Individual	Mashkull	Femër	Fëmijë
Gjermani	Gjilan	17.02.2021	Gjilani	0/0/2012	Dhunshëm	✓	/	1	1	2

X. ZYRA E AVOKATIT TË KOMUNËS

I. Aktivitetet:

- Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme - 589,
- Padi kundër Komunës -326,

- Përgjigje në padi - 326,
- Fjalë përfundimtare - 10,
- Ankesa - 321,
- Përgjigje në Ankesë - 22,
- Revizione -2 ,
- Përgjigje në revizion - 3,
- Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë - 1,
- Kundërshtime / Prapësime - 4 ,
- Parashtresa - 47,
- Kërkesa - njoftime drejtorive (email) - 132,
- Aktgjykime- aktvendime të gjykatës themelore - 418,
- Aktgjykime - aktvendime të gjykatës së Apelit -79 ,
- Aktgjykime - aktvendime të gjykatës Supreme - 5,
- Pranimi i thirrjeve për seancë - 468, -Propozim për përmbardim nga pala-50, - Precizim të padis - 90.

- Gjithsejtë aktivitete -2,893

Gjykatës Themelore në Gjiçan

- Të refuzuar palës- 12,
- Të aprovuara palës- 320,
- Urdhërohet - 43,
- Konsiderohet e tërhequr- 7,
- Hidhët Poshtë- 1,
- Jo kompetente- 19,
- Korrigjohet- 9,
- Ndërpritet procedura- 1,
- Pezullohet-2
- Plotësues - 1, - Rigjykim - 2,
- Përfundon procesi - 1.

Gjykatës së Apelit në Prishtinë

- Aprovohet palës- 50,
- Të refuzuar palës- 13,
- Në rigjykim - 16,

Gjykatës Supreme

- Aprovohet palës-2, - Hidhet poshtë- 1, - Rigjykim - 1.

II. Detyrimet Kontingjente:

1. 11,017,582.24 Vlera e lëndëve (kërkesëpadive) në shkallë I
2. 2,802,823.59 Vlera e lëndëve (kërkesëpadive) në shkallë II
3. 45,442.60 Shpenzime procedurale (barrë e komunës)

13,865,848.43 Gjithsejtë

XI. ZYRA PËR PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË

Gjatë kësaj periudhe kohore Janar deri në Qershor 2021, Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje në vazhdimësi aktivitetin e saj e ka ushtruar kryesisht me çështjet të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e problemeve të ndryshme për sa i përket qytetareve të ardhur nga Komunitatet e lartshënuara.

Në këtë periudhë kohore, kjo zyre ka arritur t'i trajtoj shumë kërkesa të qytetareve të adresuara për organet komunale dhe njësitë tjera administrative në Komunë, po ashtu sipas nevojës dhe kërkesave specifike.

Kemi bashkëpunuar me të gjitha institucionet komunale me apo pa prezencën e qytetareve për t'i shqyrtuar kërkesat e ndryshme si janë ;

Mospasja me dokumente të identifikimit, vizita tek familjet me probleme shëndetësorë, vizita në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për t'i futur në listë për vaksinimin kundër COVID -19 si dhe në disa takime tjera në lagjet të ndryshme lidhur rregullimin e infrastrukturës rrugore.

Po ashtu, kjo zyre ka mbajtur takime edhe me organizata të huaja jo qeveritare siç është UNCHR me temën "Pasivizimi i adresave të qytetareve të Preshevës Bujanocit dhe Medvegjes" si dhe kërkesa nga Unioni Evropian nga liderët politik të Komunave të lartshënuara që të takohen dhe të bëjnë një vizitë në Serbi që të verifikojnë gjendjen e tyre.

Kjo zyre gjatë kësaj periudhe kohore ka pranuar : 476 kërkesa të ndryshme.